



 **kji** Instituti Gjyqësor i Kosovës  
Kosovo Judicial Institute  
Kosovski Institut za Pravosudje

# JUSTITICIA

*Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor*



Viti III, numri 3/ 2011



# JUSTICIA

Revistë juridike me punime të kandidatëve nga Programi Fillestar për  
Arsimim Ligjor 2010/2011 në Institutin Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë

Viti III, Nr.3/2011

Prishtinë, 2011

**Botues**  
Instituti Gjyqësor i Kosovës

**ANËTARËT E REDAKSISË:**

Nushe Kuka Mekaj  
Bujar Muzaqi  
Mentor Hajraj

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:  
Instituti Gjyqësor i Kosovës

© Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/  
Kosovo Judicial Institute

Publikimi i kësaj reviste u mundësua nga Programi për Zhvillim i  
Kombeve të Bashkuara, UNDP, Zyra në Kosovë



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

Financuar nga: Qeveria e Holandës



## P Ë R M B A J T J A

<b>Lavdim Krasniqi,</b> Parathënie.....	5
<b>Ardita Beqiraj, Sylejman Shumolli, Sebahate Hoxha</b> Mbrojtja e detyruar në procedurë penale.....	7
<b>Besim Susuri</b> Mosrespektimi i afateve dhe efikasiteti i procedurës penale.....	17
<b>Bujar Muzaqi</b> Shpronësimi i pronës së paluajtshme.....	35
<b>Diellza Hoxha &amp; Servet Metaj</b> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.....	43
<b>Franciska Zhitia Ymeri &amp; Saranda Bogaj Sheremeti</b> Tortura.....	53
<b>Mentor Hajraj &amp; Minir Hoti</b> Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.....	61
<b>Musli Gashi &amp; Ilir Rashkaj</b> Kuptimi i pasurisë së përbashkët të bashkësorëve.....	75
<b>Nushe Kuka Mekaj</b> Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale.....	83
<b>Sanije Seferi &amp; Qazim Xharra</b> Matja e denimit, zbatimi dhe qellimi i tij.....	91
<b>Mr.Sc. Visar Musa &amp; Valdet Gashi</b> Dalja në vend të ngjarjes.....	117





Të nderuar lexues,

Revista “Justicia” tashmë ka filluar të bëhet traditë, ngjashëm si edhe Programi Fillestar për Arsimim Ligjor në të cilin hartuesit e saj ndjekin trajnimet.

Ky është numri i tretë i kësaj reviste e cila është rezultat i hulumtimit dhe kreativitetit profesional të kandidatëve të gjeneratës së tretë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.

Në punën e tyre profesionale për hartimin e këtij numri të revistës, kandidatët kanë trajtuar tema nga të gjitha fushat e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, gjë e cila revistën e bën më të kompletuar dhe konkurruese në literaturën juridike në Kosovë.

Gjatë leximit të punimeve vërehet se ato janë hartuar me një gjuhë të pasur juridike dhe kanë strukturë të qartë. Kjo dëshmon se gjatë hartimit kandidatët kanë përdorur metoda të ndryshme studimi duke sjellë një frymë të re në publikimet e fushës juridike në Kosovë.

Nëpërmjet kësaj reviste, po bëhen përpjekje që gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm të Kosovës të krijojnë një praktikë të re të publikimeve nga praktika gjyqësore e prokuroriale në Kosovë.

Shpresojmë se edhe ky numër i revistës “Justicia” do tu shërbej në punën e përditshme profesionale jo vetëm juristëve të rinj, por edhe gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në Kosovë e më gjerë.

Mr.sc. Lavdim Krasniqi  
Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës







Ardita Beqiraj



Sylejman Shumolli



Sebahate Hoxha

## **MBROJTJA E DETYRUAR NË PROCEDURË PENALE**

### **Vështrime të përgjithshme rreth mbrojtjes së të pandehurit në procedurë penale**

#### **1.1 E drejta e të pandehurit në mbrojtje**

E drejta e të pandehurit për mbrojtje konsiderohet si një ndër të drejtat më të rëndësishme në procedurë penale. Këtë të drejtë i pandehuri mund ta realizoj personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit profesional.

Nevoja për konstatimin e drejtë të së vërtetës materiale detyron organet që e zbatojnë procedurën (policinë, prokurorinë, gjykatën) që në mënyrë të saktë dhe të plotë t'i vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.<sup>1</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në nenin 7 par. 2 parasheh se “Sipas dispozitave të parapara me Kod, gjykata, prokurori publik dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje, me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij”. Nga kjo rrjedh se barrën kryesore për vërtetimin e ekzistimit apo mosekzistimit të fajësisë së të pandehurit që procedohet e bartin organet që zbatojnë procedurën dhe se roli i të pandehurit mund jetë

---

1 Dr.Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë 2005, faqe 90.

i ndryshëm varësisht nga zgjedhja e tij. Megjithatë angazhimi i mbrojtësit mund të ndihmoj në kuptim të realizimit të të drejtave në aspektin procedural dhe të eviton pasojat eventuale të cilat mund t'i ketë i pandehuri në mungesë të njohurive juridike. Ekzistimi i mbrojtjes profesionale për të pandehurin është i rëndësishëm edhe për faktin se ai gjatë kohës sa zhvillohet procedurë penale kundër tij, gjendet në një gjendje të posaçme shpirtërore dhe psiko fizike.

Andaj me qëllim të realizimit të mbrojtjes ligji ka paraparë parimin e barazisë së armëve i cili barazon pozitën e tij me atë të paditësit të autorizuar si palë në procedurë përveç kur me Kod parashihet ndryshe (neni 10 paragrafi 1 KPPK). Më tutje KPPK, në mënyrë mjaft të qartë parasheh këtë parim, ashtu që në paragrafin 2 të po këtij neni parasheh se i pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë t'i marr në pyetje ose të kërkoj që të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkoj praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejné për dëshmitarët kundër tij. Pra, parimi i barazisë së armëve nënkupton se të dy palët në një proces gjyqësor duhet të kenë mundësi të barabarta të paraqesin deklaramet rreth çështjes. Si i tillë ky parim duhet të garantohet gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, pa marr parasysh dënimin e paraparë për atë vepër penale. Andaj organet që zbatojnë ligjin, Policia, Prokurori Publik, Gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues përfshirë edhe Gjyqtarin për konfirmim të aktakuzës, kanë për obligim që ta udhëzojnë të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës dhe se mbrojtësi ka të drejtë të marrë pjesë gjatë marrjes së tij në pyetje.

Pra me qëllim të barazimit të të pandehurit me paditësin e autorizuar dhe nga ajo që u cek më lart, rrjedh se i pandehuri gjatë gjithë fazave të procedurës penale mund të ketë mbrojtës dhe se në disa raste te caktuara mbrojtja është e detyrueshme. Në këtë drejtim Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në neni 12 paragrafi 5 parasheh se “Gjykata ose personi tjetër kompetent i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftoj të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të parë, ashtu siç parashihet me këtë Kod.

Andaj bazuar në gjithë atë që u tha më lartë lirisht mund të konkludohet se mbrojtja në procedurë penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mund të jetë:

- Mbrojtje fakultative dhe
- Mbrojtje e detyrueshme, e cila do të jetë objekt i studimit të mëtutjeshëm të këtij punimi.

## **1.2. Caktimi i mbrojtësit, heqja dorë dhe pamundësia për heqje dorë nga mbrojtja**

I pandehuri është i lirë për caktimin e mbrojtësit, sipas zgjedhjes së tij. Nëse ai nuk angazhon mbrojtës, përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe ushqyesi, mund të angazhojnë mbrojtës për të, por jo kundër vullnetit të tij, neni 69 paragrafi 6 i KPPK-së. I pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.<sup>2</sup> Mbrojtës mund të jetë vetëm avokati i regjistruar në Odën e Avokatëve dhe nën kushte të caktuara me ligj mund ta zëvendësoj edhe praktikanti, ky i fundit nuk mund të paraqitet si mbrojtës pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa për çështjet penale që kanë të bëjnë me veprat penale që parashihet dënimi me të paktën pesë vjet burgim, praktikanti i avokatit mund ta zëvendësoj vetëm nëse e ka të kryer provimin e jurisprudencës.

Nga e drejta në mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar (neni 73 i KPPK-së), nëse heqja dorë bëhet qartë, në mënyrë të informuar dhe vullnetarisht. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari ose i pandehuri dhe nga organi që zbaton procedurën ose të bëhet gojarisht në audio a videotrakë, autenticiteti i të cilit verifikohet nga gjykata.

Personat nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës me pëlqimin e prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit nga qendra për punë sociale përveç rasteve të dhunës në familje në të cilin

---

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 71 paragrafi 2, faqe 264,

është përfshirë prindi ose kujdestari tek të cilët prindi ose kujdestari nuk mund të jep pëlqimin për heqjen dorë nga kjo e drejtë.

Personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve mendore ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit.

Kur i dyshuari ose i pandehuri i cili ka hequr dorë nga e drejta në mbrojtës kërkon sërish këtë të drejtë, ai këtë të drejtë mund ta ushtroj menjëherë.

## **2. MBROJTJA E DETYRUAR**

### **2.1 Në përgjithësi rreth mbrojtjes së detyruar**

Mbrojtja e detyruar nënkupton rrethanat me ekzistimin e të cilave procedura penale ndaj të pandehurit nuk mund të zbatohet pa mbrojtës. Këto rrethana janë të përcaktuara në mënyrë decitive nga dispozitat e KPPK dhe parashihen në lidhmëri me vetitë fizike dhe psikofizike të të pandehurit në procedurë, me veprën penale apo sanksionin e paraparë si dhe kur i pandehuri nuk mund t'i përballoj shpenzimet e mbrojtjes.

Sipas nenit 73 paragrafi 1 të KPPK-së, mbrojtja është e detyruar, pra i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste:

- Nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vet me sukses,
- Gjatë marrjes në pyetje në paraburgim dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim,
- Nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me të paktën tetë vjet burgim dhe
- Në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimeve, të paaftësisë mendore ose i është shqiptuar dënim me burgim afatgjatë.

Në këto raste i pandehuri duhet të ketë mbrojtës pa marrë parasysh vullnetin e tij, edhe pse praktikisht kjo mund të vihet në pikëpyetje në raste të caktuara, respektivisht kur i pandehuri merret në pyetje në paraburgim apo nga ngritja e aktakuzës kundër tij për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me të paktën tetë vjet burgim dhe në mënyrë të vazhdueshme kundërshton prezencën e cilitdo mbrojtës që mund t'i caktohet. Me siguri qëllimi i ligjdhënësit në rastin konkret ka qenë ofrimi i sigurisë më të madhe dhe garancive procedurale për respektimin e të drejtave të të pandehurit.

Po ashtu nëse i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush në pajtim me nenin 69, paragrafi 6 të këtij Kodi, kryetari i gjykatës ose organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake cakton mbrojtës sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike. Kur mbrojtësi caktohet sipas detyrës zyrtare pasi të jetë ngritur aktakuza, i pandehuri njoftohet për këtë me rastin e dorëzimit të aktakuzës.<sup>3</sup> Sipas nenit 127 paragrafi 3 i KPPK-së, gjithashtu ekziston mbrojtja e detyruar kur të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës duhet t'i dorëzohet aktgjykimi me të cilin i është shqiptuar dënim me burgim, kurse aktgjykimi nuk mund t'i dërgohet në adresën e mëparshme. Në situatë të tillë gjykata ia cakton mbrojtësin i cili e ushtron këtë detyrë derisa të gjendet adresa e të pandehurit. Mbrojtësit i lihet një afat i nevojshëm për t'u njoftuar me shkresat e pastaj i dorëzohet aktgjykimi dhe vazhdon procedura.

Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar si në rastet e lartcekura, të pandehurit konform nenit 74 paragrafit 1 të KPPK-së, i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij ose të personave të afërm të tij (neni 69 paragrafi 6 i KPPK), por jo edhe kundër vullnetit të të pandehurit kur:

- Procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me të paktën tetë vjet burgim ose
- Kur i pandehuri nuk mund të paguaj shpenzimet e mbrojtjes dhe nëse gjykata apo organi kompetent që zbaton procedurën në fazën paraprake vlerëson se caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike është në interes të drejtësisë.

Kjo mbrojtje dallohet nga mbrojtja e detyruar konform nenit 73 të KPPK-së, ngase nuk mund të zbatohet në kundërshtim me vullnetin e të pandehurit

---

3 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 73 paragrafi 2, faqe 264,

qoftë në kuptim të përgjithshëm të mbrojtjes apo mbrojtësit të caktuar dhe se e njëjta mbrojtje i referohet veprës penale të dënueshme me të paktën tetë vjet burgim ose kur i pandehuri nuk mund të paguaj shpenzimet e mbrojtjes dhe gjykata vlerëson se është në interes të drejtësisë caktimi i mbrojtësit. Pra sipas kushteve të parapara me këtë Kod, të pandehurit i cili nuk mund t'i paguaj shpenzimet e mbrojtjes dhe për këtë arsye nuk mund të angazhoj mbrojtës të pavarur me përvojë dhe me kompetencë konform me llojin e veprës penale, me kërkesë të tij i caktohet një mbrojtës i pavarur që paguhet nga mjetet e buxhetit kur kjo është në favor të drejtësisë (neni 12 paragrafi 4 i KPPK-së). Kjo formë e mbrojtjes në teorinë e procedurës penale njihet edhe si mbrojtje për të varfër. Megjithatë angazhimi i mbrojtësit sipas detyrës zyrtare në këto raste e sidomos prej hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nga viti 2004, e tutje ka qenë mjaftë shpesh e kritikuar nga monitoruesit e zbatimit të ligjit, ngase e njëjta shpesh është ofruar vetëm sa për të përmbush kërkesat procedurale ligjore dhe se në aspektin përmbajtësor nuk ka qenë e kënaqshme, rrethanë e cila e ka sjell të pandehurin në situatë të pavolitshme dhe ka dëmtuar të drejtat e tij.

Është konstatuar se përfaqësimi ligjor nga avokatët mbrojtës në çështjen penale shpesh është nën standarde dhe jo efektive. Kjo mund të shkel kornizën ligjore në Kosovë, Kodin e Etikës profesionale të avokateve dhe ligjin ndërkombëtar<sup>4</sup>. Këtu përfshihen si mbrojtësit e angazhuar me autorizim nga të pandehurit ose familjarët e tyre po ashtu edhe ata të caktuar sipas detyrës zyrtare.

Asnjë provë e marrë me rastin e marrjes në pyetje të të pandehurit nuk është provë e pranueshme në procedurë nëse në procesverbal nuk është shënuar udhëzimi në të drejtën për angazhimin e mbrojtësit dhe deklarinimin e të dyshuarit ose të pandehurit lidhur me udhëzimin. Gjithashtu provë e pa pranueshme në procedurë penale konsiderohet edhe kur marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni 231 paragrafi 2 dhe 3 i KPPK-së, e ku përfshihen edhe të drejtat e të pandehurit për ndihmën e mbrojtësit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje.

---

4 Përfaqësimi ligjor jo-efektiv, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Sistemi për monitorimin e Sistemit Juridik/OSBE

## 2.2 Mbrojtja e të dëmtuarit (përfaqësuesi i autorizuar)

Sipas nenit 82 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i dëmtuari ka përfaqësues të autorizuar nga fillimi i procedurës penale kur:

- Është fëmijë,
- Është në marrëdhënie familjare me të pandehurin,
- Procedura zbatohet për vepra penale nga neni 139 i Kodit Penal të Kosovës ose për vepra penale kundër integritetit seksual nga kapitulli XIX i Kodit Penal, përveç veprave nga neni 203 i Kodit Penal të Kosovës,
- I dëmtuari ka çrregullime ose paaftësi mendore ose
- Gjykata çmon se i dëmtuari është i pazoti për t'u mbrojtur dhe i nevojitet ndihma e përfaqësuesit të autorizuar.

Cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar në këto raste e ushtrojnë mbrojtësit profesional ligjor (avokatët), me qëllim të mbrojtjes së interesit të të dëmtuarve në procedurën penale. Caktimi i përfaqësuesit ligjor në këto raste është paraparë si e detyrueshme duke pasur parasysh qoftë natyrën e veprave penale me të cilat janë të dëmtuara (viktimat e trafikimit dhe viktimat e veprave penale të integritetit seksual) ose duke pasur parasysh shkallën e zhvillimit psiko-fizik të të dëmtuarve siç janë fëmijët dhe personat me çrregullime ose paaftësi mendore.

## 2.3 Mbrojtja e detyruar në procedurën penale ndaj të miturve

Kur flasim për institutin e mbrojtjes së detyruar padyshim se me interesim të veçantë duhet trajtuar edhe rastet e mbrojtjes së detyruar tek të miturit në procedurë penale. Nëse hedhim një vështrim të legjislacionit penal vendor, respektivisht Ligjit Penal për të mitur para plotësimeve vlen të përmendet se Ligji Penal për të Mitur i Kosovës në nenin 40, përcaktonte se: “i mituri ka të drejtë në mbrojtje në rastet e mbrojtjes së detyrueshme”, çka nënkupton se të miturit i caktohej mbrojtja vetëm në rastet e mbrojtjes së detyrueshme të përcaktuara sipas KPPK-së e që janë elaboruar me herët në këtë punim.

Ndërkaq pas plotësimeve që iu bënë Ligjit Penal për të Mitur ku edhe nga emërtimi Ligj Penal për të mitur mori emrin Kod i Drejtësisë për të Mitur, ky Kod në nenin 43, përcakton se: i mituri duhet të ketë mbrojtës që nga

fillimi e deri në përfundim të procedurës<sup>5</sup>. Kjo risi paraqet një rëndësi të madhe sa i përket garancisë për mbrojtje ligjore profesionale të të miturit në procedurën penale ndaj tij.

Edhe pse leximi i vëmendshëm i këtij neni të vë para dilemave, ngase në paragrafin e katërt (4) të po këtij neni përcaktohet se me kërkesën e të miturit, të përfaqësuesit ligjor ose të anëtarit të familjes së tij emërohet mbrojtës me shpenzime publike, nëse ai nuk mund t'i paguaj shpenzimet për mbrojtjen e vet, por jo kundër dëshirës së të miturit. Ky fakt mund të të vë në mëdyshje nëse është e obligueshme ose jo mbrojtja në procedurën penale ndaj të miturve. Mirëpo duke marrë për bazë interesin me të mirë të të miturit, gjithmonë mbrojtësi duhet të angazhohet edhe në rastet kur i mituri refuzon një gjë të tillë.

Përveç akteve ligjore vendore edhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, respektivisht Konventa Evropiane e të drejtave të Fëmijëve, neni 40, par. 2 pika b e kësaj Konvente, përcakton garancitë minimale ligjore për të miturit në procedurën penale dhe atë përpos që respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë ndër të drejtat tjera që garantohen është pikërisht obligimi që të miturit t'i ofrohet mbështetje ligjore në përgatitjen dhe prezantimin e mbrojtjes efikase në procedurën penale ndaj tij.

Kjo nënkupton se shtetet ratifikuese të kësaj konvente duhet të ndërmarrin masa për të krijuar kushte në drejtim të respektimit të të drejtave minimale në procedurën penale ndaj të miturve ku edhe ka paraparë ofrimin e ndihmës profesionale për shkak të interesit më të mirë të të miturit gjatë procesit penal. Më tutje mosofrimi i ndihmës ligjore nga një mbrojtës profesional do të paraqiste shkelje të të drejtave të fëmijëve ashtu siç përcaktohet në këtë dokument të rëndësishëm ndërkombëtar.

Kur jemi tek instrumentet ndërkombëtare ngjashëm edhe Neni 6 (3) (c) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), i jep personit të drejtën “për ta mbrojtur veten personalisht apo përmes ndihmës ligjore të zgjedhur vet ose po që se nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar ndihmën ligjore, kjo t'i jepet falas kur interesat e drejtësisë kërkojnë një gjë të tillë”<sup>6</sup>.

<sup>5</sup> Neni 43, par. 1 të KDM

<sup>6</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Neni 6



Ky nen i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore lidh të drejtën për mbrojtje aty ku është e nevojshme, dhënien e ndihmës ligjore falas për kërkesat e interesit të drejtësisë, që në masë të madhe përkojnë me respektimin e parimit të barazisë së mjeteve siç u cek me lart.

## **Përfundim**

Në përgjithësi ofrimi i mbrojtjes së detyruar nga mbrojtësit profesional ligjor, konsiderohet si një e arritur e madhe për sistemin e drejtësisë dhe poashtu një garanci për zhvillimin e drejtë të procedurës penale ndaj të pandehurit. Edhe pse e drejta e të dyshuarit ose të pandehurit për mbrojtje ligjore konsiderohet si njëra ndër të drejtat më të rëndësishme të të pandehurit në aspektin procedural dhe njëra ndër standardet elementare që përcakton mundësinë e respektimit të të drejtave të njeriut, po aq e rëndësishme është që përfaqësimi ligjor me anë të mbrojtjes të jetë praktik dhe efektiv e që fatkeqësisht nuk është në nivelin e duhur në Kosovë.

Ky fenomen njëherit ka qenë objekt i kritikave të shpeshta nga monitoruesit ndërkombëtar të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Arritja e një standardi më të lartë në këtë drejtim duhet të jetë objektiv primar i zbatuesve të ligjit në Kosovë dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi.

## **LITERATURA:**

- E drejta e procedurës penale, Dr. Ejup Sahiti, Prishtinë 2005,
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës,
- Ligji Penal për të Mitur,
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur,
- Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut,
- Konventa ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve – Rregullat e Pekinit,
- Përfaqësimi ligjor jo-efektiv, raporti OSBE-së.





Besim Susuri

## MOSRESPEKTIMI I AFATEVE DHE EFIKASITETI I PROCEDURËS PENALE

### Parathënie

*“Ligjet vlejnë aq sa vlejnë njerëzit të cilët i zbatojnë ato”*

*Enriko Feri*

Duke u bazuar në parimin e së drejtës së procedurës penale, se ai është sistem i rregullave juridike përmes të cilit përcaktohen subjektet e procedurës penale dhe me të rregullohen marrëdhëniet e tyre në procedurën penale me ndërmarrjen e veprimeve proceduralo-penale, e gjithë kjo me qëllim të ndriçimit dhe zgjidhjes së çështjes penale si lëndë dhe detyrë e të drejtës procedurale penale<sup>7</sup>. Kështu në bazë të dispozitës të nenit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),<sup>8</sup> përcaktohen rregullat që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa fajtorit do t’i shqiptohet dënimi ose sanksioni tjetër përkatës i merituar, sipas kushteve të parapara në Kodin Penal të Kosovës (KPK) në bazë të procedurës së paraparë ligjore. Nga e gjithë kjo rrjedh se procedura penale i ka funksionet e shumëfishta.<sup>9</sup>

Kështu nga njëra anë, procedura penale është mjet efikas për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, ngase gjatë procedurës penale zgjidhen çështje të rëndësishme sikurse:

7 Prof. dr Stanko Bejatović: Krivično procesno pravo-Opšti deo- Kultura Beograd, 1995 strana 25.

8 “Gazeta zyrtare RSFJ”, nr. 4/77, 14/85, 36/77, 74/87 dhe 3/99.

9 Dr. Đorđe Lazin: Efiksnost krivičnog postupka i zaštita sloboda i prava građana zagarantovana međunarodnim paktom o građanskim i političkim pravima: JRK i KP 1985 strana 117.

- 1) Se me të vërtet a është kryer një veprë penale,
- 2) Se nëse vepra penale është kryer, kush është kryesi i saj,
- 3) Se ndaj personit për të cilin është vërtetuar gjatë hetimeve si dhe në shqyrtimin kryesor, se i pandehuri e ka kryer veprën penale, në kuptim të dispozitave të drejtës penale materiale do t'i shqiptohet dënimi i përcaktuar ligjor.<sup>10</sup>

Nga ana tjetër procedura penale është mjet mbrojtës i të drejtave të qytetarit i cili është nën dyshimin e kryerjes së veprës penale.

Procedura penale është ndërtuar në bazë të dy tendencave. Të parës, asaj klasike, me qëllim që shoqëria në mënyrë efikase të mbrohet nga kriminaliteti dhe së dytës, asaj civilizuese që në masën më të madhe që është e mundur të mbrohen të drejtat e qytetarit. Mirëpo në esencë, këto tendenca janë kundërthënëse.

Është e logjikshme që rregullimi i procedurës penale duhet të jetë i bazuar në kompromis të kuptueshëm.

Kështu Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, deri diku i'a ka arrit pajtueshmërisë me tendenca më lartë të theksuara sepse përmes zgjidhjeve të shumta origjinale ka krijuar kushte ligjore origjinale për rregullimin e procedurës penale dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarit.

## 1. PARIMI I EFIKASITETIT TË PROCEDURËS PENALE

Fjala efikasitet rrjedh nga shprehja latine *efficacilis* që do të thotë suksesshmëri, mirëpo efikasiteti i procedurës penale është çështje më e gjerë dhe komplekse, e cila është e kushtëzuar nga shumë rrethana. Në teori nuk ekziston një term gjithëpërfshirës për kuptimin e efikasitetit të procedurës penale. Qëllimi i këtij punimi nuk është çështja e definimit duke dhënë përgjigje në këtë çështje por paraqitja e parimeve bazë të efikasitetit të procedurës penale në kontekst me afatet në procedurën penale.

Është e pa kontestueshme në këtë çështje se me efikasitet të procedurës penale nënkuptohet shpejtësia e zhvillimit të procedurës penale, përkatësisht

---

10 Dr. Vladimir Bayer: JKPP, knjiga prva, Zagreb 1960 strana 4.

përfundimi i saj në kohë sa ma të shkurtër për të mbërritur deri tek aktgjykimi përtuarës gjyqësor apo deri tek aktvendimi përkatës për pushimin e saj. Efikasiteti i procedurës penale mund të definohet edhe si shpejtësia me të cilën veprojnë subjektet e procedurës penale në kontekst të zgjidhjes së ngjarjes juridike – penale, përkatësisht të çështjes konkrete penale të iniciuar nga subjektet e autorizuar për iniciimin e çështjes penale në bazë të Kodit të Procedurës Penale. Shpejtësia e zhvillimit të procedurës penale si një ndër faktorët e efikasitetit, mund të arsyetohet me arsyet e politikës kriminale por vetëm deri në atë masë, deri sa e njëjta nuk ndikon në ligjshmërinë e zhvillimit të procedurës penale dhe marrjen e vendimit ligjor dhe të drejtë gjyqësor. Duhet pasur parasysh se shpejtësia e zhvillimit të procedurës penale dhe ligjshmëria janë dy marrëdhënie korelative të cilat është shumë vështirë për t'i harmonizuar.<sup>11</sup>

Bazuar në këtë, me efikasitet të procedurës penale nënkuptojmë nivelin e shpejtë të veprimit i cili siguron ligjshmëri në zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale të cilin edhe e bën efikas. Përkundër kësaj, shpesh flitet për jo efikasitet të procedurës penale e cila gjithsesi kushtëzohet nga mangësitë dhe lëshimet e shumta në punë dhe gjatë punës së subjekteve kryesore të procedurës penale, e që në radhë të parë në këtë bëjnë pjesë të rëndësisë primare mosrespektimi i afateve ligjore të cilët kushtëzojnë të tërë procedurën e mosefikasitetit të saj.

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit.<sup>12</sup>

## **2. AFATET NË PROCEDURËN PENALE**

### **2.1. Kuptimi dhe qëllimet e afateve në procedurën penale**

Me qëllim të zbatimit të procedurës penale në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, të domosdoshme janë respektimi sa më preciz i rregullave ligjore

---

11 O. Cvijović: Uticaj medjusobnih odnosa glavnih procesnih subjekata na efikasnost krivičnog postupka . JRK i KP 1995 strana 70.

12 Neni 6 paragrafi 1, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

përkitazi me përiudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale penale.

Në pikëpamje të afateve në procedurën penale Kodi i Procedurës Penale i Kosovës e përcakton kohën e domosdoshme për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale dhe atë në dy mënyra, së pari duke e përcaktuar këtë me përcaktimin në normë me shprehjen të përgjithshme si *”pa vonesë”* (neni 199 § 3 i KPPK-së).

Në këtë drejtim Kodi i Procedurës përcakton poashtu se nëse kallëzimi penal me të cilin iniciohet procedura penale, i është paraqitur policisë ose prokurorit jo kompetent, i njëjtë duhet të pranohet dhe pa vonesë t’i dërgohet prokurorit kompetent, (neni 254 § 2 i KPPK-së). Poashtu prokurori bën këqyrjen e vendit të ngjarjes, (neni 210, 211 KPPK), ndërsa personi i privuar nga liria pa vonesë duhet t’i dërgohet gjyqtarit të procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin, (neni 213 § 1 i KPPK-së), pastaj personi njoftohet për të drejtën e tij në ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit sipas zgjedhjes së tij, (neni 281 § 1 i KPPK-së), dhe se gjykatësi i procedurës paraprake, përkatësisht gjykata mund ta caktoj paraburgimin ose ta liroj personin e dyshuar nga caktimi i paraburgimit, (neni 212 § 1,2 KPPK), ose nga arrestimi dhe ndalimi nga policia e autorizuar nga prokurori, (neni 306 par. 2 KPPK), si dhe që pas pranimit të aktakuzës gjyqtari për konfirmim të aktakuzës verifikon se a është përpiluar aktakuza në pajtim me nenin 305, (neni 392 par. 1 KPPK) dhe se a mund të konfirmohet e njëjta apo jo, pastaj shpallja e aktgjykimit, (neni 395 § 1 i KPPK-së), si dhe faza e përpilimit të aktgjykimit në afatin e caktuar ligjor.

Koha e nevojshme për ndërmarrjen e veprimeve procedurale rregullohet edhe me shprehje të përgjithshme si *“pa vonesë”* (neni 211 KPPK), kështu që policia mund ta privoj personin e dyshuar nga liria kur për këtë ekzistojnë arsyet për ndalim nga neni 281 par 1 i KPPK-së, por që detyrohet pa vonesë ta sjell te gjyqtari i procedurës paraprake në mënyrë që ai të vendos për paraburgimi, ose neni 409 § 1 i KPPK-së, kur shkresat e lëndës sipas ankesës i arrijnë gjykatës së shkallës së dytë, gjyqtari raportues ia dërgon lëndën prokurorit kompetent i cili e shqyrton dhe pa vonesë me mendimin e dhënë ia kthen gjykatës për vendosje.

Koha për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, e përcakton kohën e saktë lidhur me afatin brenda të cilit duhet ndërmarr veprimi procedural. Afatet e caktuara janë paraparë sipas situatave të ndryshme procedurale dhe atë prej 6, 24 dhe 48 orësh; 3, 8, 15 ditë; 1, 2, 3, 5 e 6 muaj dhe 1, 2 ose 3 vjet, kështuqë afatet llogariten në orë, ditë muaj dhe vite.

Kodi i Procedurës Penale nuk e përcakton kuptimin e domethënies së afateve. Mirëpo në teorinë e të drejtës së procedurës penale hasim në definicione të ndryshme lidhur me afatet.

Afati është periudha kohore e caktuar brenda të cilit veprimi proceduralo - penal duhet, mund ose nuk guxon të ndërmerret<sup>13</sup> dhe se sipas të gjitha elementeve, sidomos të drejtave dhe detyrimeve, ky definicion është më i plotë. Disa definicione tjera nuk i përfshijnë të gjitha elementet e definimit të afatit përkatësisht të afateve në procedurën penale.

Ndërkaq disa autor të cilët në të drejtën e procedurës penale i trajtojnë afatet si shkencë, me afat nënkuptojnë: së pari momentin, ditën, orën e saktë të caktuar kur duhet të ndërmerret veprimi procedural ose kohën kur duhet filluar ndërmarrjen e atij veprimi; së dyti distancën kohore me të cilën veprimi duhet ndërmarrë apo i njëjti nuk guxon të ndërmerret.<sup>14</sup> Në rastin e parë flitet për seancë, ndërsa në të dytin për afatin në kuptimin juridik.<sup>15</sup>

Mirëpo pa marrë parasysh definicionin paraprak, nga domethënia afat duhet dalluar domethënien seancë (term). Nga shumë seanca të procedurës penale, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, posaçërisht e ka rregulluar seancën e shqyrtimit kryesor, të cilën seancë e fton-cakton gjykata. Lëshimi i seancës mund të ketë pasoja procedurale gjë që varet nga rasti i paraparë me ligj dhe vendim të gjykatës. Në këtë kuptim, kështu për shembull nëse rregullisht janë ftuar palët e procedurës së caktuar penale por nuk vijnë në shqyrtim kryesor: i pandehuri mund të sillet për seancën vijuese forcërisht apo edhe të paraburgoset (neni 341 KPPK); dëshmitari ose eksperti mund të sillet po ashtu forcërisht dhe të dënohet me gjobë (neni 336 KPPK)

13 Kodi i Procedures Penale i Kosovës 2004.

14 Dr. Ejup Sahiti. E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005.

Dr. Davor Krapac. Ligji i Procedurës Penale, ribotim i IV, Zagreb 2006.

15 Dr. Dragoljub V Dimitrijević: Krivično procesno Pravo 1965 strana 219.

ndërsa paditësi privat, nën kushte të caktuara mund ta humbas të drejtën në ndjekje penale (neni 54 KPPK).

Qëllimi i përbashkët i procedurës penale, përkatësisht i respektimit të afateve dhe i efikasitetit të saj është që të arrihet zbatimi sa më konsekuent i parimit të ekonomizimit dhe krijimit të kushteve për një proces penal, të shpejtë dhe sa më efikas. Mirëpo poashtu qëllim i respektimit të afateve dhe i efikasitetit në procedurë penale që të mbrohen të drejtat e qytetarit, p.sh. lehtësimi i situatave procedurale të cilat janë të rënda sidomos për të paraburgosurit ndaj dhe paraburgimi duhet të vihet në suaza sa më të shkurta kohore në mënyrë që i njëjti qytetar i dyshuar të mos i shndërrohet në vuajtje të dënimit.

Rregullat e procedurës penale i rregullojnë afatet procedurale, përkatësisht afatet e zbatimit të të tëra procedurave të përcaktuara penale ndërsa ligji penal i rregullon afatet materiale. Kështuqë në esencë këto afate dallojnë. Derisa afatet procedurale janë distancë kohore e caktuar brenda së cilës veprimi procedural duhet, mund ose guxon të ndërmerret, ndërkaq afatet materiale kanë të bëjnë me institucionet e të drejtës penale materiale p.sh. parashkrimi i ndjekjes penale (neni 90 KPK), parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve (neni 92 KPK) të cilat janë bazë për shuarje të së drejtës, në këtë rast të ndjekjes penale përkatësisht të ekzekutimit të dënimit.

## 2.2 Llojet e afateve në procedurën penale

Klasifikimi i afateve në procedurën penale bëhet sipas kriterëve të caktuara ndërsa ndarja më e rëndësishme e afateve është ajo *ligjore dhe gjyqësore*.

**Afatet ligjore**, janë afate, kohëzgjatja e të cilave drejtpërsëdrejti është përcaktuar me ligj p.sh. afati i paraqitjes së ankesës në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë (neni 400 par. 1 KPPK). Sipas rregullit këto afate janë prekluziv, që do të thotë nuk mund të vazhdohen, përveç në rastet kur këtë shprehimisht e parasheh ligji (neni 94 KPPK), për shembull zgjatja e afatit për ndryshimin e aktakuzës (neni 306 par. 2 KPPK), me të cilën përcaktohet se menjëherë pas pranimit të aktakuzës, gjyqtari i cili e zbaton procedurën e konfirmimit të aktakuzës verifikon se e njëjta a është përpiluar në harmoni me nenin 305 të KPPK-së dhe se kur e çmon se e njëjta nuk është përpiluar në harmoni me dispozitën e nenit 305, ai atë i'a kthen



prokurorit për ta ndryshuar në afatin e paraparë ligjor prej 3 ditësh. Mirëpo këtë afat 3 ditor në rastet kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, gjyqtari me propozim të prokurorit këtë afat mund ta zgjasë. Ndërsa nëse paditësi subsidiar ose paditësi privat, nuk e respekton afatin e përcaktuar ligjor, në këto raste konsiderohet se paditësi privat - subsidiar ka heq dorë nga ndjekja penale dhe procedura penale pushon.

**Afatet ligjore** sipas mënyrës me të cilën janë rregulluar ndahen në afate të kohëzgjatjes së caktuar, p.sh. 8 ditë dhe në afate të kohëzgjatjes e cila nuk është e kufizuar por është e lidhur për një moment të caktuar procedural (p.sh. të dëmtuarit mund ti kufizohet e drejta e shikimit të shkresave të lëndës neni 80 KPPK), atij mund ti kufizohet përkohësisht shikimi i shkresave nëse për këtë ekzistojnë arsyet të posaçme që kanë të bëjnë me sigurinë e vendit apo diç të ngjashme.

**Afatet gjyqësore** janë ato afate kohëzgjatjen e të cilave e cakton gjykata, në bazë të autorizimit ligjor. Afatet gjyqësore ndahen në afate të drejta dhe jo të drejta. Për afatet e drejta, caktimin e këtyre afateve gjyqësore i është lënë që për to të vendosi gjykata. Në këto raste kemi të bëjmë me të drejtën diskrecionale të gjykatësit, pa kurrfarë kufiri ligjor të caktuar, gjatë të cilës gjykatësi merret me rrethanat e rastit të caktuar, p.sh. afati me të cilin eksperti rishitazi do ta jep mendimin-konstatimin. Në qoftë se të dhënat nga konstatimi i ekspertëve thelbësisht ndryshojnë ose kur konstatimet e ekspertëve janë të paqarta, jo të plota apo në kundërshtim me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara, e në rast se këto të meta nuk mund të mënjahohen me marrjen e serishme në pyetje të ekspertëve, në këto situata ekspertimi përsëritet me ekspertët e njëjtë ose me ekspert tjerë (neni 184 KPPK), apo te afati për paraqitje të aktakuzës së re (neni 376 par.2 KPPK).

Te afatet gjyqësore në kuptim jo të drejtë të fjalës gjykata e cakton afatin brenda kufijve të caktuar me ligj, dhe bazohet në kriteret e caktuara gjatë të cilës gjykatësi e cakton afatin konform ligjit.<sup>16</sup>

Sipas **veprimit të afatit** për ndërmarrje të veprimit procedural, afatet ndahen në **diletore** dhe **premtore**.

<sup>16</sup> KPPK 2004 Prishtinë, LPP i B. e H. 2003 Sarajevë, komentari i LPP të Malit të Zi 2006 Podgoricë.

*Afatet diletore* janë afate në përiudhën e të cilit është i ndaluar realizimi i aktiviteteve të caktuara procedurale, e cila juridikisht është e mundur vetëm pas kalimit të përiudhës së caktuar kohore.

*Afatet premtore*, janë afate të atilla në kuadër të të cilëve mundet, dhe ndërmerren veprime të caktuara procedurale, nga se me kalimin e afatit mund të humbet e drejta e ndërmarrjes së të njëjtit.

Afatet në mes tyre dallojnë, duke marrë parasysh veprimet penalo-procedurale për të cilat ato edhe janë caktuar. Kështu nisur nga kjo dallojmë *veprimet e gjykatës, veprimet e palëve dhe veprimet e personave të tretë*. Ky dallim i afateve është interesant për shkak të pasojave të cilat paraqiten me rastin e lëshimit të afateve. Pasoja e lëshimit të afatit, varet nga ajo se lëshimin e afatit kush e ka bërë, gjykata apo pala. Kur lëshimi i afatit bëhet nga gjykata, në këto raste nuk ka pasoja të dëmshme. Mirëpo, nëse afati lëshohet nga palët, sipas rregullit ky lëshim ka ndikim prekluziv, do të thotë se veprimi i caktuar më nuk mund të ndërmerret. Për prokurorinë si palë kjo vlen në raste të afatit për paraqitje të ankesës.

Sipas **kriterit të shkaktimit të pasojës** e cila pason me lëshimin e afatit, afatet ndahen në afate *prekluzive* dhe afate *instruktive* (udhëzuese).

Afatet *prekluzive* janë ato afate lëshimi i të cilave për pasojë ka humbjen e ndërmarrjes së veprimit penalo-procedurale, me këtë humbet edhe e drejta e cila realizohet me ndërmarrjen e atij veprimi, që do të thotë se kemi të bëjmë me ato afate, me lëshimin e të cilave pasojnë pasoja juridike, veprimet penalo-procedurale më nuk mund të ndërmerren. Kundruall afateve prekluzive, afatet *instruktive* (udhëzuese), janë ato afate me lëshimin e të cilave nuk kanë për pasojë humbjen e të drejtës për ndërmarrje të veprimit penalo-procedural, që do të thotë se kemi të bëjmë me afate, lëshimi i të cilave nuk prodhon pasoja juridike por vetëm (gjykatësi ose prokurori) ka detyra të pa sanksionuara.<sup>17</sup>

Në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, për veprime të caktuara të gjykatës ose të prokurorit janë paraparë afate instruktive.

---

17 Mr. V. Pjanović JRKK 1997, Rokovi u krivičnom Postupku

Afatet instruktive sipas KPPK-së janë paraparë me shprehje si “*menjëherë*” (neni 210 ) ose “*pa vonesë*” ( neni 221 par 1).<sup>18</sup>

### 2.3 Llogaritja e afateve në procedurë penale

Afatet llogariten me orë, me ditë me muaj dhe vite (neni 95 par 1 KPPK).<sup>19</sup>

Për caktim e afateve të rëndësishme është caktimi i momentit të fillimit dhe ai i përfundimit të afatit. Afati fillon të rrjedhë nga momenti i paraparë sipas ligjit, ose nga momenti i caktuar nga gjykata.<sup>20</sup>

Te afatet e caktuara në orë ose ditë, ora ose dita kur është bërë dorëzim njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora apo dita e parë vijuese. Për një ditë llogaritet njëzet e katër orë, kurse muaji llogaritet sipas kalendarit (neni 95 par 2 KPPK).

Afatet e caktuara në muaj apo vite kalojnë në muajin ose vitin e fundit, në fund të ditës së njëjtë të muajit kur ka filluar afati. Nëse një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit afati kalon në ditën e fundit të atij muaji (neni 95 par 3 KPPK).

Kur dita e fundit e afatit bie në ditë festë zyrtare, të shtunën ose të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës (neni 95 par 4 KPPK).

Kjo mënyrë e llogaritjes së afateve, subjektit penalo-procedural të cilit i është dhënë afati në orë ose ditë, i siguron njësi të plotë të kohës e cila i është dhënë kohë të caktuar në orë ose ditë. Ora ose dita kur është dorëzuar parashtrësia nuk llogaritet në afat por merret ora e parë pasuese, përkatësisht dita e ardhshme. Te afatet në muaj dhe vite, mënyra e llogaritjes sjell deri te rezultati se pala ka në dispozicion muajin e plotë përkatësisht vitin.

---

18 KPPK.

19 KPPK 2004 Prishtinë, Dr. Ejup Sahiti, e Drejta e Procedurës Penale Prishtinë 2005, Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, Krapac Davor, Kazneno Procesno Pravo II izmenjeno i dopunjeno izdanje, prva knjiga, Zagreb 2003.

20 Hoxha, Artan, Islam, Halim, Panda Ilir, Procedura Penale Tiranë 2007.

Afatet e caktuara në orë, për aktivitetet e organeve shtetërore, rrjedhin pa marrë parasysh orarin e punës, festat apo ditët pasuese, sepse këtu kemi të bëjmë me veprime të ngutshme (urgjente), të cilat në procedurën penale, në çdo kohë duhet të ndërmerren. Nëse afati i caktuar në orë rrjedh në dobi të palës dhe kalon në ditën e festës ose ditën e ardhshme, ky afat nuk vazhdohet.

Kur deklarata është e lidhur me afat, konsiderohet se e njëjta është dhënë në afat, nëse para kalimit të afatit i është dorëzuar atij i cili është i autorizuar që ta pranoj, (neni 94 § 2 KPPK).

Kur deklarata dërgohet përmes postës, postës rekomande ose me ndonjë mjet tjetër (teleks, faks ose mjet tjetër të ngjashëm), dita e postimit rekomande ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Dërguesi i deklaratës konsiderohet se nuk e ka lëshuar afatin, kur personit të cilit tentohet t'i dërgohet deklarata, të njëjtën nuk e ka marrë me kohë për shkak të gabimeve në mjetet e dërgimit për të cilat dërguesi nuk ka qenë në dijeni (neni 94 § 3 KPPK).<sup>21</sup>

I pandehuri i cili gjendet në paraburgim mund të jap deklaratë që është e lidhur me afat, duke përfshirë atë në procesverbalin e gjykatës që e zbaton procedurën ose duke e dërguar në Drejtorinë e burgut-institucionit, dhe konsiderohet si ditë e dorëzimit organit kompetent për pranimin e të njëjtës (nenin 94 §.4 të KPPK).

Kur parashtrë, dorëzimi i të cilës është i lidhur me afat, për arsye të mosdijes ose të gabimit të qartë të dërguesit, i është dërguar gjykatës jo kompetente arrin pas kalimit të afatit të paraparë, do të konsiderohet se është dorëzuar me kohë (nenin 94 § 5 të KPPK).

Dorëzimi ose dhënia e deklaratës pas kalimit të afatit nuk ka efekt juridik, gjë që është në funksion të parimit të ligjshmërisë dhe efikasitetit të procedurës penale.

#### **2.4. Kthimi në gjendjen e mëparshme-(Restitutio in integrum)**

Me qëllim të efikasitetit të procedurës penale dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarit, procedura penale duhet zhvilluar shpejtë. Për këtë arsye, për

---

21 KPPK Prishtinë 2004, Dr. Ejup Sahiti, e Drejta e Procedurës Penale ,Prishtinë 2005.

ndërmarrje të veprimeve penalo-procedurale parashihen afatet, të cilat sipas rregullit janë të shkurta. Mirëpo sa është kjo e mirë, po aq mund të jetë edhe e rrezikshme. Nëse lëshohet afati do të mund të pasojnë pasoja të dëmshme për palët në procedurë sepse lëshimi i afatit, mund të pasojë edhe pa fajin e subjektit të procedurës penale, andaj pasojat e dëmshme do të ishin të padrejta. Në këto situata ligji përcakton mundësinë për lëshimin e afatit për palën e cila me atë është goditur dhe në këtë kuptim i njëjti nga gjykata mund të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme. Nga ana tjetër, sado që ky institut të jetë në interes të parimit të së vërtetës materiale poashtu është mjet i përshtatshëm për zgjatje të procedurës penale. Nga këto arsye, kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është institut i përgjithshëm por është i paraparë vetëm për raste të caktuara me ligj, kështu është paraparë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës se kthimi në gjendjen e mëparshme, në rastet e caktuara mund, të parapara me dispozitat e KPPK-së, ta shfrytëzojnë: i pandehuri, paditësi privat, i dëmtuari si paditës privat dhe i dëmtuari i cili nuk është ftuar me rregull në shqyrtim kryesor në të cilin është marrë aktgjykim refuzues për shkak të heqjes dorë nga ndjekja penale e prokurorit. Kështu p.sh. të pandehurit i cili për shkaqe të arsyeshme ka lëshuar afatin për paraqitje të ankesës kundër aktgjykimit, gjykata do të ia lejojë kthimin në gjendje të mëparshme, për paraqitje të ankesës në afat prej 8 (tetë) ditësh.

Nëse paditësi privat nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor edhe përkundër thirrjes së rregullt, ose thirrja nuk ka mundur t'i dorëzohet, për shkak se paditësi privat paraprakisht nuk e ka njoftuar gjykatën, edhe pse ka qenë i detyruar që ta njoftojë për çfarëdo ndërrimi të adresës ose të vendqëndrimit të tij, në këtë situatë, kryetari i trupit gjykues do të konsiderojë se i dëmtuari është tërhequr nga e drejta e tij ligjore në padi.

Kryetari i trupit gjykues, pas paraqitjes së lutjes për kthim në gjendje të mëparshme nga paditësi privat, e lejon një gjë të tillë, vetëm në rastet kur paditësi privat për shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur të paraqitet në shqyrtimin gjyqësor ose në raste të ndërrimit të adresës apo të vendqëndrimit, për këtë nuk ka mundur me kohë ta njoftojë gjykatën, ashtu që ftesa nuk ka mundur t'i dorëzohet. Në këtë situatë, i dëmtuari-paditësi privat në afat prej tetë ditësh nga dita e heqjes së pengesës është i detyruar të paraqesë lutje për kthim në gjendje të mëparshme, përkatësisht në situatën pas marrjes së

aktgjykimit të paraqet lutje për kthim në gjendje të mëparshme gjithashtu, në afatin e paraparë ligjor prej tetë ditësh, në të cilën paditësi privat deklaron se e vazhdon ndjekjen penale. Në këtë rast sërish caktohet shqyrtimi gjyqësor dhe me aktgjykimin e marrë në bazë të shqyrtimit të ri gjyqësor anulohet aktgjykimi i mëparshëm.

Nëse paditësi privat i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtimin e ri gjyqësor, në këtë rast aktgjykimi i mëparshëm mbetet në fuqi. Lutja për kthim në gjendjen e mëparshme mund të paraqitet brenda afatit prej tre muajve, pas kalimit të këtij afati nga dita e lëshimit të njëjtit dhe se nuk mund të paraqitet lutje për kthim në gjendje të mëparshme ngase është lëshuar afati ligjor i paraparë për këtë (neni 60 deri 68 KPPK).<sup>22</sup>

Kundër vendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, nuk është e lejuar ankesa.

Lutja për kthim në gjendjen e mëparshme sipas rregullit nuk e ndalon ekzekutimin e aktgjykimit.

### **3. MOSRESPEKTIMI I AFATEVE DHE EFIKASITETI I PROCEDURËS PENALE**

Efikasiteti i procedurës penale është çështje komplekse, as në teori nuk ekziston pajtueshmëri lidhur me këtë se çka nënkuptojmë me efikasitet të procedurës penale. E pakontestueshme është se me efikasitet të procedurës penale nënkuptojmë shpejtësinë e zhvillimit të procedurës, dhe se shpejtësia e procedurës penale mund të arsyetohet deri në atë masë, e cila nuk ndikon në ligjshmërinë e udhëheqjes së procedurës penale dhe shkeljen e të drejtës së qytetarit. Gjithë këto veprime duhet rregulluar me dispozita të cilat duhet harmonizuar tendencat kundërthënëse: efikasitetin e procedurës penale dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarit.

Ligji i procedurës penale i vitit 1953 dhe ndryshimet e shumta të bëra me vonë, të cilat kanë çuar drejt harmonizimit dhe avancimit të dispozitave ligjore, kur në vitin 1967 është paraqit nevoja për efikasitet të shtuar të gjyqësorit, që nga atëherë është kërkesë e shtuar për garanci më të mëdha

---

22 Nenet 60 gjer 68 të KPPK

procedurale të të pandehurit, me orientim të caktuar në periudhat e viteve të mëvonshme me tendenca që kjo marrëdhënie diç të përmirësohet në të mirë të efikasitetit më të madh duke mbajtur në vete të gjitha garancitë në dobi të të pandehurit.<sup>23</sup>

Nga kjo rrjedh se në efikasitetin e procedurës penale ndikon rregullimi ligjor.

Që një procedurë penale të zhvillohet drejtë dhe me efikasitet e domosdoshme është që për këtë qëllim duhet paraparë dhe caktuar afatet për ndërmarrjen e veprimeve penalo-procedurale, kështu në parim mund të thuhet se respektimi i afateve të caktuara për ndërmarrjen e veprimeve penalo-procedurale kanë ndikim në efikasitetin e procedurës penale. Ky është parim i përgjithshëm dhe para së gjithash ka të bëjë me afatet ligjore, kohëzgjatja e të cilave është e rregulluar me ligj dhe se këto afate nuk mund t'i ndryshoj gjykata e as palët sipas marrëveshjes së tyre, përpos kur një gjë e tillë është e rregulluar me ligj.

Dispozitat ligjore mbi afatet, të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtës së qytetarit mund ta ngadalësojnë procedurën p.sh. kur dita e fundit e afatit bie në festë zyrtare, të shtunën ose të dielën, ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës (neni 95 par 4 KPPK), disa nga dispozitat për dërgim të shkresave dhe shikim të shkresave të lëndës, në parim shkresat dërgohen me postë. Dërgesa mund të bëhet edhe përmes organit kompetent komunal, zyrtarit të organit që ka marrë vendim ose drejtpërsëdrejti përmes atij organi. Shkresat, dorëzimi i të cilave duhet bërë personalisht, i jepet direkt personit të cilit i është adresuar. Të pandehurit personalisht i dorëzohet ftesa për marrje në pyetje në procedurë paraprake, para gjyqtarit të procedurës paraprake, në seancë për konfirmim të aktakuzës dhe për shqyrtim gjyqësor. Marrësi dhe dërguesi e nënshkruajnë fletëdërgesën me qëllim të vërtetimit të dorëzimit, dhe se marrësi në fletëdërgesë shënon personalisht ditën e pranimit si dhe orën e cila me rëndësi është për fillimin e llogaritjes së rrjedhës së afatit të caktuar (nenet 124-134 KPPK).

Afatet ligjore kohëzgjatja e të cilave nuk është e kufizuar në kohë por është e lidhur për momentin e caktuar procedural, sikurse për të drejtën e paditësit

23 Dr. Jovan Buturović, Najnovije izmene ZKP'a i njihov značaj za efikasnost krivičnog Postupka JRKK 1985.

subsidiar dhe të atij privat që t'i shikojnë procesverbalet, shkresat dhe sendet që shërbejnë si provë (neni 61 par. 3 KPPK), mirëpo si veprim procedural me rëndësi i cili ka ndikim në efikasitetin e procedurës penale

Afatet gjyqësore gjithashtu mund ta ngadalësojnë procedurën penale, posaçërisht afatet e vërteta gjyqësore, p.sh. afati brenda të cilit (pas kthimit të aktakuzës nga gjykata) prokurori duhet ta përgatis dhe ta paraqes aktakuzën e re. Kur paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshoj aktakuzën gojarisht, dhe mund të propozoj që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re. Me rastin e ndërprerjes së shqyrtimit gjyqësor për përgatitje të aktakuzës së re nga ana e paditësit, me atë rast caktohet afati kur paditësi detyrohet ta paraqes aktakuzën (neni 376 KPPK).

Në zgjatje të procedurës penale ndikojnë të ashtuquajturat afate instruktive, edhe pse ato janë rregulluar me qëllim të shpejtimit të procedurës. Rrezik të veçantë paraqesin këto norma-afate nga se janë të shumta dhe u janë dedikuar veprimeve të rëndësishme dhe urgjente procedurale. Kështu, hetimi nga vet natyra është urgjent dhe afatin e saj ligji nuk e ka caktuar, por ligji e ka paraparë afatin instruktiv: nëse hetimi nuk përfundon brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, prokurori publik i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake, bashkë me arsyet për mos përfundimin e hetimit dhe kërkon mundësimin e zgjatjes së hetimit (neni 225 KPPK).

Pas përfundimit të hetimeve, prokurori është i obliguar që në afat sa më të shkurtër të merr vendim, ta ngris aktin akuzues, të cilin ia dërgon gjykatës kompetente për konfirmim të aktakuzës, ku pas pranimit të aktakuzës, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës, është i detyruar që ta bëjë kontrollimin formal të aktakuzës, ta konfirmojë atë ose ta refuzoj për disa ose për të gjitha pikat e aktakuzës.

Nëse aktakuza nuk i përmban të gjitha elementet obliguese, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës ka për detyrë që të njëjtën t'ia kthej prokurorit konformë nenit 306 par 2 të KPPK-së, dhe me këtë bëhet kontrollimi formal i aktakuzës.



Në qoftë se prokurori, gjykatës nuk i paraqet propozimet me kohë ose veprimet tjera, në procedurë i ndërmerr me vonesa të mëdha dhe me këtë shkakton zvarritje të procedurës, në këto situatë, për këtë njoftohet prokurori më i lartë (neni 146 par 3 KPPK).

Për përgatitje të shqyrtimit kryesor, dhe caktimin e shqyrtimit kryesor është dhënë afati instruktiv prej tridhjetë ditësh, pas pranimit të aktakuzës, brenda të cilit afat trupi gjykues, nëse nuk e cakton shqyrtimin gjyqësor, kryetari i trupit gjykues është i detyruar që për këtë ta njoftoj kryetarin e gjykatës për shkaqet e mos caktimit të shqyrtimit, i cili nëse është e nevojshme, ndërmerr masa për caktimin e shqyrtimit gjyqësor (neni 319 par. 1 KPPK).

Afatet instruktive janë paraparë edhe për përpilimin e aktgjykimit me shkrim, në procedurë të rregullt, dhe atë në afat prej pesëmbëdhjetë dite kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë dite në raste tjera. Kur aktgjykimi nuk përpilohet brenda këtij afati, kryetari i trupit gjykues e informon kryetarin e gjykatës për arsyet e mos përpilimit. Në këto raste kryetari i gjykatës ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për përpilimin sa më të shpejtë të aktgjykimit, por jo më vonë se tridhjetë ditë nga shpallja e aktgjykimit, nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim dhe dyzet e pesë ditë në raste tjera (neni 395 par 1 KPPK).

Gjyqtari për të mitur është i detyruar ta caktoj shqyrtimin kryesor apo seancën e kolegjit në afat prej tetë ditë, pas pranimit të propozimit të prokurorit ose nga dita e përfundimit të procedurës përgatitore, ose nga dita kur në seance të kolegjit është vendos të mbahet shqyrtimi kryesor. Për çdo zgjatje të këtij afati gjyqtari për të mitur duhet ta ketë pëlqimin e kryetarit të gjykatës (neni 69 par 1 KDPM i Kosovës).

Instruktive-udhëzuese janë të gjitha afatet të cilat në vete kanë shprehjen e përgjithshme “*menjëherë*” ose “*pa vonesë*”.

Afatet instruktive janë afate ligjore, me lëshimin-përkatësisht mos respektimin e tyre nuk prodhojnë pasoja juridike. Për subjektet e lëshimit të këtyre afateve është paraparë vetëm detyrim zyrtar i cili nuk sanksionohet. Nga këto arsye dhe shumë të tjera të natyrës objektive apo asaj subjektive, afatet instruktive kryesisht nuk respektohen, gjë që drejtpërsëdrejti ndikon në zvarritjen e procedurës penale.

Mosrespektimi i afateve ka karakter absolut, procedura penale zgjat shumë dhe nuk është efikase.

Afatet instruktive janë në interes të të drejtave të qytetarit, të cilat kufizojnë kohëzgjatjen e veprimeve të caktuara procedurale. Mosrespektimi i afateve në procedurën penale reflekton negativisht në zhvillimin e rrjedhës së procedurës penale.

Duke pas parasysh se të gjitha afatet instruktive janë paraparë me qëllim të efikasitetit të procedurës penale poashtu edhe në mbrojtjen e të drejtave të qytetarit, të cilët janë nën dyshimin se kanë kryer veprë penale dhe se kryesisht nuk respektohen dhe mosrespektimi nuk prodhon pasoja juridike, do të kishte bazë logjike dhe juridike se mosrespektimi i tyre në procedurën penale parashihet si shkelje e ligjit.

Afatet në procedurën penale, para së gjithash janë në funksion të efikasitetit të procedurës penale. Disa nga dispozitat ligjore mbi afatet në procedurë penale (p.sh. dispozitat mbi kalimin e afatit, për afatet e dorëzimit të shkresave, pastaj dispozitat për zgjatjen e afateve, të afateve ligjore kohëzgjatja e të cilave nuk është kufizuar në kohë dhe ngjashëm), mund ta ngadalësojnë efikasitetin e procedurës penale. Gjithashtu, mosrespektimi i afateve ndikon në efikasitetin e procedurës penale, e veçantë është në mosrespektimin e afateve të ashtuquajtura instruktive.<sup>24</sup>

Vetëm procedura penale efikase, që do të thotë zbulimi i shpejtë i veprës penale dhe kryesit të saj, ndërmarrja e ndjekjes penale dhe shqiptimi i sanksionit penal mund të jetë në shërbim të luftimit të kriminalitetit, përkatësisht do të ishte përgjigje e qëllimeve të preventivës speciale dhe të përgjithshme.

Në të kundërtën zvarritja dhe joefikasiteti janë kurajë për kryesit potencial të veprave penale, nga se me zvarritje të procedurës penale forcohet ndërdija se koha (do ta bëjë të veten) është e mjaftueshme që të anojë posaçërisht të personat e rinjë e të paformuar.

Përiudha e tranzicionit dhe e krizave nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon qytetari i shtetit të Kosovës, po bëhet teren i përshtatshëm për zhvillim dhe

---

24 Nenet 60 gjer 68 të KPPK

përfeksionim të kriminalitetit klasik, dhe pikëpamjeve të reja të kriminalitetit. Për luftimin e kësaj dukurie e cila është duke u luftuar por pa sukses të përmasave të duhura, domosdoshmëri e cila paraqitet përpara organeve përkatëse shtetërore dhe atyre gjyqësore, është domosdoshmëria që procedura penale të zhvillohet shpejtë, pa vonesë dhe me efikasitet.

Maksima e vjetër për zvarritjen dhe arritjen e drejtësisë thotë: "Sa është drejtësia e arritshme nëse procedura penale zgjat shumë dhe me atë rast vie deri te zhvlerësimi i të gjithë asaj që përmes efikasitetit do të fitohej, në çka me të drejtë aludohet në shtetin ku sundon e drejta".

Ajo çka mund të bëhet në përmirësimin dhe ngritjen e efikasitetit në pikëpamje kuantitative dhe kualitative, pa vonesë, është e domosdoshme që autoriteti i ligjit të ngritet në nivel më të lartë. Në rend të parë nënkupton se zbatimi i ligjit nuk varet nga çmimi dhe vlerësimi i partive politike, aq më pak nga individ. Që të përgjigjen të gjithë ata që bien ndesh me ligjin gjithashtu edhe ata të cilët nuk e zbatojnë ligjin, ndaj shkelësve të normave ligjore. Më tej duhet siguruar praktikën unike gjyqësore për tërë territorin e Republikës së Kosovës, kur kemi të bëjmë me zbatimin e ligjit në tërë territorin e shtetit.

Ajo që mund të bëhet menjëherë, duke mos pritur ndryshimin e ligjit dhe kuadrin me të cilin disponojmë (kur flasim për problemin e natyrës kadrovike, para së gjithash mendohet në tejngarkesën e gjykatave, pamjaftueshmërinë e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kushtet jo të mira për kryerje të këtyre funksioneve, edukimi dhe arsimimi i pamjaftueshëm juridik dhe ngjashëm), duhet doemos që në mënyrë sa më precize të respektohen të gjitha afatet e përcaktuara sipas KPPK-së, posaçërisht atyre të natyrës instruktive, sepse shumica e shkaqeve të zvarritjes së procedurës penale qëndrojnë tek këto afate.

Kështu që Ligjin duhet harmonizuar me realitetin tonë, që të jetë i aplikueshëm dhe në interes të palëve në procedurë duke u liruar nga romantizmi i normave.

**LITERATURA:**

- Prof. dr Stanko Bejatović: Krivično procesno pravo-Opšti deo- Kultura Beograd, 1995,
- Dr. Đorđe Lazin: Efikasnost krivičnog postupka i zaštita sloboda i prava građana zagarantovana međunarodnim paktom o građanskim i političkim pravima: JRK i KP 1985,
- Dr. Vladimir Bayer: JKPP, knjiga prva, Zagreb 1960,
- O. Cvijović: Uticaj međusobnih odnosa glavnih procesnih subjekata na efikasnost krivičnog postupka . JRK i KP 1995,
- Kodi i Procedures Penale i Kosovës 2004.
- Dr. Ejup Sahiti. E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005.
- Dr. Davor Krapac. Ligji i Procedurës Penale, ribotim i IV, Zagreb 2006.
- Dr. Dragoljub V Dimitrijević: Krivično procesno Pravo 1965,
- Mr. V. Pjanović JRKK 1997, Rokovi u krivičnom Postupku
- Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, Krapac Davor, Kazнено Procesno Pravo II izmenjeno i dopunjeno izdanje, prva knjiga, Zagreb 2003.
- Dr. Jovan Buturović, Najnovije izmene ZKP'a i njihov značaj za efikasnost krivičnog Postupka JRKK 1985.



Bujar Muzaqi

## SHPRONËSIMI I PRONËS SË PALUAJTSHME

### 1. HYRJE

Me shpronësim nënkuptojmë se pasuria e paluajtshme mund të shpronësohet kur kjo paluajtshmëri është e nevojshme me qëllim të ndërtimit të objekteve ekonomike, banimi, komunale, shëndetësore, kulturore dhe objekteve tjera me interes të përgjithshëm.

Pasuria e paluajtshme mund të shpronësohet edhe kur kjo është e nevojshme me qëllim zhvillimi të punimeve tjera me interes të përgjithshëm.

### 2. OBJEKT SHPRONËSIMI DHE ORGANI SHPRONËSUES;

Objekt shpronësimi sipas Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr.03/L-139 të Republikës së Kosovës,<sup>25</sup> mund të jenë të drejtat private pronësore ose të drejtat tjera private në një pronë të paluajtshme, me përjashtim të të drejtave në pronën e paluajtshme të cilat janë pjesë e një kategorie të pronës e cila në bazë të Kushtetutës ose Propozimit Gjithëpërfshirës shprehimisht janë përcaktuar se nuk mund të jenë objekt shpronësimi.

Pasuria e paluajtshme mund të shpronësohet për këto arsye:

- ndërtimin e hekurudhave, rrugëve, urave, aeroporteve, kanaleve;

---

25 Në nenin 4 par.1, dhe 2 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës, është e paraparë Organi shpronësues, dhe Objektet e shpronësimit;

- ngritjen e vendbanimeve, rrugëve, parqeve, shesheve;
- ndërtimin e ujësjellësve, dhe objekteve tjera Komunale;
- ndërtimin e shkollave, muzeumeve, galerive të artit, dhe objekteve tjera për qëllime arsimore e kulture;
- ndërtimin e spitaleve dhe objekteve tjera për qëllime shëndetësore e sociale;
- ndërtimin e objekteve për kulturë fizike dhe sport;
- kërkimin e pasurive xeherore dhe pasurive tjera në brendinë e tokës;

Organi shpronësues (Qeveria, Komuna) është e autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së këtyre kushteve: shpronësimi bëhet për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij; qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit; përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikojnë negativisht nga shpronësimi; dhe prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk ka ndonjë qëllim tjetër ose synim diskriminues.

### **3. KOMPENSIMI DHE PAGESA E KOMPENSIMIT<sup>26</sup>;**

Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës.

Kompensimi për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar paguhet në Euro<sup>27</sup>.

Nëse një person refuzon pranimin e këtij kompensimi, mjetet do të depozitohen në një xhirollogari mirëbesimi në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në emër të personit në fjalë.

Të gjitha mjetet e depozituara në një xhirollogari mirëbesimi konsiderohen se janë “paguar” për qëllime të parapara në Ligjin mbi Shpronësimin e Paluajtshmeve, të Republikës së Kosovës.

---

<sup>26</sup> Në nenin 15 par. 1 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës, është e paraparë kompensimi për Objektin e shpronësuar;

<sup>27</sup> Në nenin 16 par. 1, 2, 3 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës, është e paraparë pagesa e kompensimit për Objektin e shpronësuar.

Sa i përket vlerësimit të pronës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave themelohet një zyrë për vlerësimin e pronës së paluajtshme, e cila është Autoriteti kompetent publik për vlerësimin e të gjitha pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i procedurës së shpronësimit nga cilido Organ Shpronësues.

Zyra për vlerësimin e Pronës së paluajtshme do të nxjerrë aktin përfundimtarë të vlerësimit brenda njëqindpesëdhjetë (150) ditëve nga data e pranimit të kërkesës nga Organi Shpronësues.

Akti i vlerësimit me shkrim duhet të përmbajë : vlerën e përgjithshme të pronës e cila është objekt i shpronësimit, një vlerësim të të gjitha dëmeve-nëse ka- të cilat duhet të paguhet sipas këtij ligji, të dhënat e personave të cilëve do t'u paguhet kompensimi; shuma e kompensimit e cila do t'i paguhet secilit, dhe të dhënat e personave të cilët kanë kërkuar kompensim, mirëpo është vendosur se nuk kanë të drejtë në të.

#### **4. MJETET JURIDIKE DHE MBROJTJA E PRONËS;**

Ligji nr.03/L-007,<sup>28</sup> i Republikës së Kosovës për procedurën jokontestimore mënyrën e përdorimit të mjeteve juridike e rregullon në këtë mënyrë: në qoftë se palët në procedurën e shpronësimit nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e paluajtshmërisë, Organi kompetent administrativë ia dërgon aktvendimin për shpronësim që ka marrë formën e prerë, bashkë me të gjitha shkresat, Gjykatës Kompetente në të cilën ndodhet paluajtshmëria e shpronësuar, për caktimin e kompensimit.

Në qoftë se Organi administrativ, nuk ia dërgon Gjykatës Kompetente, Aktvendimin për shpronësim, atëherë ish pronari ka të drejtë ti paraqitet drejtpërsëdrejti Gjykatës Kompetente me kërkesë, për caktimin e kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar.

Procedura pranë Gjykatës Kompetente duhet të përfundohet sa më parë, e më së voni brenda afatit prej 60 ditësh, nga dita e paraqitjes së propozimit në Gjykatën Kompetente.

---

<sup>28</sup> Në nenin 215, neni 216 par. 1, 2, 3, dhe nenin 217 par.2 të Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, të Republikës së Kosovës, është paraparë caktimi i kompensimit nga Gjykata Kompetente për paluajtshmërinë e shpronësuar;

Ndërsa, Ligji nr.03/L-139<sup>29</sup>, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të R. së Kosovës e rregullon në këtë mënyrë: Personi i cili nuk është i kënaqur me vendimin e Organit shpronësues, ka të drejt Ankese pranë Gjykatës Komunale Kompetente.

Ne qoftë se Qeveria shpronëson atëherë ankesa paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ankesa duhet të paraqitet 30 ditë pas hyrjes në fuqi të Vendimit mbi shpronësimin e paluajtshmërisë.

Gjykata Ankesën e paraqitur nga parashtruesi i ankesës e trajton në mënyrë urgjente.

Mbrojtja e Pronës është e paraparë edhe në nenin 17 par.2 e Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut e cila ndër të tjera thotë se:

***“Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga prona e tij”***

Mbrojtja e pronës mbrohet edhe në bazë të Protokollit nr.1 të Konventës<sup>30</sup> për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore e cila ndër të tjera thotë se:

- ***Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij;***
- ***Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.***

Mbrojtjen e pronës e garanton edhe Kushtetuta<sup>31</sup> e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 46 par. 3 thotë se:

***“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj,***

---

29 Në nenin 35 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës, janë të parapara mjetet juridike;

30 Shif Protokollin nr. 1 të Konventes për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore;

31 Shif Kushtetuten e Republikës së Kosovës Neni 46 par. 1, 3;



*është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet”.*

## **5. KALIMI I PRONËSISË NË EMËR TË ORGANIT SHPRONËSUES;**

Pasi që vendimi mbi shpronësimin e paluajtshmërisë të merr formën e prerë, dhe pas pagesës së kompensimit, zyra përkatëse kadastrale e regjistron pronën në emër të:

- Komunës përkatëse, kur Organ shpronësues është Komuna;
- Republikës së Kosovës, kur Organ Shpronësues është Qeveria.

## **6. KTHIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR DHE AFATET LIGJORE;**

Fillimisht citojmë nenin 22 par. 4 të Ligjit mbi eksproprium të Kosovës “Fl. Zyrtare KSAK” 25/73 <sup>32</sup> i cili përcakton se:

*“ Vendimi i plotfuqishëm mbi eksproprium mund të anulohet edhe në bazë të kërkesës së ish pronarit, nëse shfrytëzuesi i ekspropriumit në afatin prej tri vitesh pasi që Aktvendimi mbi eksproprium ka marrë formën e prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime qenësore në ndërtimin e atij objekti”*

Të njëjtën gjë në të njëjtën mënyrë e rregullon edhe Ligji mbi eksproprium të KSAK i vitit 1978-neni 21 par.4; Ligji mbi eksproprium të vitit 1986-neni 21 par.4; si dhe ai i vitit 1989.

Ndërsa me Ligjin nr.03/L-139 i vitit 2009,<sup>33</sup> për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës, thuhet se: Personi të drejtat pronësore të të cilit në pronën e paluajtshme janë shpronësuar, ka të drejtën për paraqitjen e ankesës pranë gjykatës kompetente dhe të kërkojë nga

32 Shif nenin 22 par. 4 të Ligjit mbi eksproprium të Kosovës “Fl. Zyrtare KSAK” 25/73.

33 Shif nenin 27 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës.

Gjykata lëshimin e një urdhri për rivendosjen e të drejtës pronësore në pronën përkatëse. Të drejtën e Ankesës mund të ushtrohet vetëm brenda 10 viteve pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar.

Kjo Ankesë pranë Gjykatës kompetente mund të paraqitet për këto arsye:

- Prona e cila është shpronësuar nga Qeveria nuk është shpronësuar për një qëllim të ligjshëm publik;
- Prona e shpronësuar, është shfrytëzuar nga Organi shpronësues në mënyrë aktive për një periudhë prej 3 (tri) viteve, për një qëllim jo të ligjshëm publik dhe;
- Gjatë periudhës tetë vjeçare paluajtshmëria e shpronësuar nuk është shfrytëzuar për asnjë qëllim;
- Ish pronari pajtohet ta kthejë kompensimin të paguar ose siguruar për shpronësimin e paluajtshmërisë, nëse kompensimi është bërë në para të gatshme, të paguaj interes.

### **Konkluzion:**

Në bazë të neneve, protokolleve të parapara në Ligjet e lartpërmendura, Konventës Evropiane, Kushtetutës së Kosovës, Deklaratës së përgjithshme për të drejtat e njeriut, vijmë në përfundim se mbrojtja e të drejtave pronësore është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës, ligjet e Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane, dhe Deklaratës së përgjithshme për të drejtat e njeriut, dhe se pasuria e paluajtshme private mund të shpronësohet duke i zbatuar ligjet në fuqi, dhe vetëm kur kjo është e nevojshme me qëllim zhvillimi të punimeve me interes të përgjithshëm shoqëror, dhe përmbushjes së disa kushteve si : shpronësimi bëhet për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik; prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk ka ndonjë qëllim tjetër ose synim diskriminues, dhe Kompensimi duhet të bëhet në mënyrë të drejtë, dhe në bazë të vlerës së tregut të pronës së paluajtshme që shpronësohet.

Ligjet të cilat janë përmendur, dhe nuk janë në fuqi në Republikën e Kosovës janë përmendur me arsye se, në nenin 40 të Ligjit nr.03/L-139, Për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës thuhet se:

***“Lidhur me procedurat e shpronësimit të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në ditën e fillimit të tyre”.***

Duke i zbatuar në mënyrë të drejtë të gjitha nenet e parapara në ligjet e lartpërmendura, Republika e Kosovës do ta ketë shumë ma lehtë lidhur me të drejtat pronësore gjatë antarsimit në Organizatat Ndërkombëtare.

#### **LITERATURA:**

- Ligji nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të Republikës së Kosovës
- Ligji nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, të Republikës së Kosovës;
- Ligji mbi eksproprimin të Kosovës “Fl. Zyrtare KSAK”25/73;
- Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Konventa Evropiane për Mbrojtën e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut.





Diellza Hoxha



Servet Metaj

## **1. KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE**

### **Historik i shkurtër**

#### **Hyrje**

Duke pasur parasysh Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 10 dhjetor 1948.

Duke pasur parasysh se kjo Deklaratë ka për qëllim të siguroj njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të përcaktuara në të .

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës i cili është i përbërë prej 47 shteteve anëtare është që të realizoj një bashkim me te ngushtë midis anëtare të saj dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave dhe lirive themelore te njeriut .

Duke theksuar edhe një herë përkushtimin e tyre të thellë ndaj këtyre lirive themelore që përbëjnë vet themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë dhe ruajtja e te cilave mbështetet kryesisht në një reagim politik me te vërtetë demokratik nga njëra anë dhe nga ana tjetër në një koncept dhe një respekt të përbashkët të të drejtave të njeriut që ato kanë marr përsipër të mbrojnë

Duke qenë si qeveri te shteteve evropiane të shtyra nga e njëjta frymë dhe me një pasuri idealesh e traditash politike të përbashkëta të respektit të lirisë

dhe të shtetit ligjor të vendosura të marrin masat e para të përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të një numri të drejtash të përmendura në Deklaratën e Përgjithshme janë marr vesh si vijon

Palët kontraktuese i njohin çdo njeriu që ndodhet nën juridiksionin e tyre të drejtat dhe lirit e përcaktuara në pjesën e parë të Konventës .

**Konventa u miratua me 4 nëntor 1950 në Romë .Konventa ka hyrë në fuqi me 3 shtator 1953.**

Pjesa parë e Konventës ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut –

**Neni 2 – e drejta për jetën**

**Neni 3 – ndalimi i torturës**

**Neni 4 - ndalimi i skllavërisë dhe i punës se detyruar**

**Neni 5 - e drejta për liri dhe siguri**

**Neni 6 - e drejta për një proces të rregullt**

**Neni 7 - nuk ka dënim pa ligj**

**Neni 8 – e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

**Neni 9 - liria e mendimit e ndërgjegjes dhe fesë**

**Neni 10 – liria shprehjes**

**Neni 11 - liria e tubimit dhe e organizimit**

**Neni 12 – e drejta për martesë**

**Neni 13 - e drejta për ankim efektiv**

**Neni 14 - ndalimi i diskriminimit**

Këto të drejta janë të ndara në absolute , kualifikuara dhe të kufizuara

**Nenet 2, 3 , 4 (1) dhe neni 7 janë të drejta absolute**

**Nenet 5, 6 dhe 12 janë të drejta te kufizuara**

**Nenet 8, 9, 10 dhe 11 janë të drejta të kualifikuara**

Pjesa e dytë e Konventës

Me qëllim që të sigurohet respektimi i angazhimeve që rezultojnë për palët kontraktuese të kësaj Konvente krijohet:

## **Komisioni Evropian i Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.**

Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut selinë e ka në Strasburg të Francës. Kjo Gjykatë vepron me iniciativën e individit ose palëve kontraktuese të Konventës dmth Shtetit.

Gjykata përbëhet nga numri i barabartë me numrin e shteteve anëtare 47 gjyqtar që i zgjedh Asambleja Parlamentare. Gjykata shqyrton kërkesat individuale dhe shtetërore.

Gjykata gjykon;

- Në komitete prej **3 gjyqtaresh**
- Dhoma prej **7 Gjyqtaresh**
- Dhoma e Madhe prej **17 Gjyqtaresh**

Procedura Para Gjykatës Evropiane fillon me paraqitjen e kërkesës ndërsa vazhdimi i saj varet nga fakti se a do të pranohet kjo kërkesë.

Kërkesa çdo pale e lartë kontraktuese mund të referoj Gjykatës çdo shkelje të konventës dhe protokolleve të saj nga një palë tjetër e lartë kontraktuese.

Një person fizik , organizatë joqeveritare ose grup individësh që janë viktima të shkeljes nga një prej palëve të larta kontraktuese.

Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut është gjykatë e precedentit dhe bazohet në vendimet e veta lidhur me rastet e ngjashme.

## **2. NENI 8 DHE NENI 12 I KONVENTËS**

### **2.1 Neni 8 - E Drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

Neni 8 është i ndarë në dy pjesë:

**Paragrafi 1** i këtij neni parashtron të drejtat e sakta që i garantohen një individit nga shteti – të drejtën e jetës private atë familjare banesës dhe korrespondencës.

**Paragrafi 2** i këtij neni qartëson faktin që këto të drejta nuk janë absolute në kuadrin që i bën ato të pranueshme për autoritetet publike që të ndërhyjnë në të e drejtat e nenit 8 në rrethana të caktuara, rrethanat në të cilat autoritetet publike mund të ndërhyjnë në mënyrë ligjore në të drejtat nën paragrafin 1: vetëm ndërhyrjet në një shoqëri demokratike në ndjekje të një ose me shumë synimeve legjitime të renditura në paragrafin 2 do të konsiderohen si kufizime të pranueshme nga shteti për të drejtat e individit sipas nenit 8.

### **2.1.1. Kuptimi i konceptit të jetës private**

Sipas Gjykatës jeta private përbën koncept të gjer i cili nuk mund të ketë një përcaktim të sakte, mirëpo nocioni i jetës private do të ishte mjaft ngushtë që të kufizohej në një rreth të ngushtë në të cilin individit do të mund të jetonte jetën e tij personale sipas zgjedhjes së tij dhe të përjashtonte çdo gjë dilte jashtë nocionit që përfshin ai rreth i ngushtë. Respektimi për jetën private duhet të përmbaje gjithashtu deri në njëfarë shkalle të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore, edhe me botën e jashtme .

### **2.1.2 Jeta e familjes**

Koncepti i jetës së familjes është zhvilluar në mënyrë të ngadaltë gjatë jetëgjatësisë së Konventës dhe vazhdon të zhvillohet që të marrë parasysh ndryshimet sociale dhe ligjore.

Gjykata ashtu si për konceptin e jetës private mban të njëjtin qëndrim të ekuilibruar në interpretimin e jetës së familjes duke pasur parasysh diversitetin e problemeve të familjes moderne, çështjet e divorcit dhe përparimet në mjekësi. Në këtë nen jeta e familjes është pozicionuar direkt në përkatësinë e sferës private ku ka të drejtën për të vepruar pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit.

Çfarë përbën jetën familjare

Familja e bazuar në marrëdhënie martesore.

Mbrojtja që sigurohet nga neni 2 gjithmonë shtrihet në marrëdhëniet



martesore që mund të shfaqen si të ligjshme dhe të vërteta. Ato që kanë mungesa dhe ekzistojnë formalisht si p.sh. një martesë fiktive që ka hyrë në fuqi me qëllim që të shmang rregullat e imigrimit ose që të merret nënshpëtim mund të mos i përkasin qëllimit të nenit 8.

Një fëmijë i lindur nga prindërit që janë të martuar ligjërisht me të vërtetë do të jetë nga vet fakti pjesë e asaj marrëdhënie që nga momenti dhe fakti i lindjes së tij.

Neni 8 zbatohet automatikisht në marrëdhëniet midis një nëne dhe fëmijës së saj pavarësisht nga statusi i saj martesor.

Çiftet e pamartuar që jetojnë së bashku me fëmijët e tyre normalisht do të konsiderohen se gëzojnë jetën familjare.

A është bashkëjetesa e mjaftueshme për të gëzuar jetën familjare?

Bashkëjetesa nuk është një kusht i domosdoshëm i jetës familjare pavarësisht nga statusi martesor i prindërve kështu anëtarët e familjes që nuk jetojnë së bashku për shkak të divorcit apo ndarjes ose me marrëveshje gjithsesi mund të gëzojnë mbrojtje nga neni 8.

Jeta familjare mund të ekzistojë midis fëmijëve dhe gjyshërve të tyre, lidhjet farefisnore, marrëdhëniet midis xhaxhait ose tezes me nipin apo mbesën e tij apo te saj, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve jashtëmartesor, prindërve adoptues dhe fëmijëve .

### **2.1.3 Vendbanimi**

Vendbanimi është vendi ku një person banon ose ku ky person vendos bazat e veta e ne kuadër të gjitha vendet e banimit përbejnë vendbanesën brenda kuptimit të nenit 8 par.1.

### **2.1.4 Korrespondenca**

E drejta për ta respektuar korrespondencën e një personi është një e drejtë që ka lidhje me komunikimet e pandërprera e të pacensuruara me të tjerët.

Kuptimi i korrespondencës përfshin materialet që nisen me poste por edhe ky koncept do të trajtohet si në vazhdimësi duke u interpretuar hap pas hapi krahas zhvillimeve teknologjike të cilat mund të sjellin metoda të reja të komunikimit p.sh. e-mail, brenda sferës së mbrojtjes që garanton neni 8.

Identiteti si i dërguesit ose marrësit të korrespondencës do të luaj një rol të rëndësishëm në përcaktimin e asaj që kërkohet nga neni 8. Gjykata e beri të qartë faktin se mbrojtja e ofruar për korrespondencë të tillë si letra e të tjera si këto që shkëmbehen midis avokatëve dhe klientëve të tyre veçanërisht te burgosurve është mjaft e larte.

**Neni 8 par. 2** thotë se autoriteti publik ndërhyt në rastet kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interesat e sigurimit kombëtar sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit për parandalimin e çrregullimeve ose krimit për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

### **Çfarë përbën ndërhyrja?**<sup>34</sup>

Ndërhyrja përfshin:

- Marrja e fëmijëve nga prindërit e tyre dhe dërgimi i tyre në qendrat publike të përkujdesit.
- Ndalimi i korrespondencës së të burgosurve
- Kontrolli në shtëpinë e personave
- Mbledhja dhe ruajtja e informacioneve në një arkiv sekret të policisë.

Nëse ka ndodhur ndërhyrja në një të drejtë të nenit 8 shtrohet pyetja?

1. A është ndërhyrja në pajtim me ligjin?
2. A ndjek ndërhyrja një synim legjitim ?
3. A është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike ?

### **Kuptimi në pajtim me ligjin**

Ndërhyrja duhet të ketë baze ligjore dhe ligji në fjale duhet të jetë mjaft i saktë dhe të përmbajë një mase mbrojtjeje kundrejt arbitraritetit nga ana e shtetit.

---

<sup>34</sup> Udhezuesi për zbatimin e Konventës Evropiane-manuali I drejtave të njeriut

Ndërhyrja duhet të ketë një bazë ligjore masat do të hapin probleme në këtë kuadër kur ato nuk janë të autorizuar specifikisht nga një shtet dhe rregulluar nga praktika administrative ose nga udhëzues të tjerë me fuqi detyruese.

Shembull: Çështja Malone kundër Anglisë; Gjykata konsideroi faktin nëse kompetenca për të kontrolluar bisedat telefonike kishte pasur bazë ligjore.

Në atë kohe përgjimi i telefonave ishte rregulluar nga praktika administrative detajet e së cilës nuk ishin botuar dhe nuk ishte dhënë autorizimi statutor specifik, andaj gjykata tha se nuk kishte qartësi të mjaftueshme mbi qëllimin ose mënyrën në të cilën ishte ushtruar liria e autoriteteve për të përgjuar në sekret bisedat telefonike për shkak se kjo përbente praktike administrative dhe ajo mund të ndryshonte në çdo kohe dhe kjo përbente shkelje të nenit 8.

Me qëllim që të përmbush kushtin ligjor të nenit 8 cilësia e ligjit duhet të jetë e formuluar me saktësi të mjaftueshme për të mundësuar që personat nëse nevojitet edhe me këshillim të parashikohen deri në njëfarë mase se sa kanë qene të arsyeshme masat në baze të rrethanave, pasojat e të cilave kanë shkaktuar një veprim të dhënë, ky njihet si kushte i parashikueshmerise.

### **A ndjek ndërhyrja një synim legjitim**

Në momentin kur një ndërhyrje del se është në përputhje me ligjin gjykata do të vazhdojë për të shqyrtuar nëse ajo ndjek një synim legjitim sipas nenit 8 par.2 përmban listën e synimeve mbi të cilat shteti mund të kërkojë të mbështetet në këtë kuadër: Shteti mund të argumentojë se :

- Mbledhja dhe ruajtja e informacionit rreth individëve është në interes të sigurimit kombëtar.
- Kontrollimi i korrespondencës së të burgosurve kërkon të parandalojë çrregullimet dhe krimin.
- Heqja e fëmijëve nga një shtëpi abuzuese ose mohimi i kujdestarisë së një çifti ose kontakti me qëllimin për të mbrojtur shëndetin apo moralin ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
- Urdhri i dëbimit ose zhvendosjes i shërben interesave të mirëqenies ekonomike të vendit.

## **A është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike ?**

Ne kontekstin e neni 8 u theksua rëndësia e shtetit ligjor në një shoqëri demokratike dhe nevoja për te parandaluar ndërhyrjet arbitrare në të drejtat e Konventës .Konventa është hartuar për të ruajtur e nxitur idealet dhe vlerat e një shoqërie demokratike .Ne përgjithësi ajo që është e nevojshme për një shoqëri demokratike për qëllimet e nenit 8 përcaktohet nga referenca me ekuilibrin e përfituar midis te drejtave të individit dhe interesit publik nëpërmjet zbatimit të parimit te proporcionalitetit.

Parimi i proporcionalitetit njih faktin se të drejtat e njeriut nuk janë absolute dhe se ushtrimi i të drejtave të një individi gjithmonë duhet te kontrollohet nga një interes më i gjerë i publikut.

I gjithëqenësishëm në të gjithë Konventën është kërkimi për krijimin e një ekuilibri të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kushteve të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.

### **Liria e vlerësimit**

Gjykata i jep Shtetit liri vlerësimi kur merr vendime nëse një ndërhyrje me një të drejtë të nenit 8 justifikohet sipas paragrafit 2 të kësaj dispozitë. Liria e vlerësimit qe i jepet autoriteteve kompetente vendase do të varirojë ne bazë të rrethanave, subjektit të çështjes dhe historikut te saj.

## **2.2 Neni 12 – E drejta për tu martuar**

Burri dhe gruaja nga mbushja e moshës se martesës kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj drejte .<sup>35</sup>

Te drejtat themelore janë te drejta që një shtet ua garanton qytetarëve të vet dhe që janë të shënuara në Kushtetutën e tij. Zbatimin e tyre qytetari mund të kërkojë para gjykatës. Ndërsa të drejtat e njeriut përbejnë idenë themelore prapa këtyre te drejtave themelore.

---

35 Neni 12 I Konventes evropiane per drejtet dhe lirit themelore te njeriut

Në kuadër të drejtave themelore të njeriut bën pjese edhe e drejta për t'u martuar. Mirëpo duhet pasur parasysh që neni 12 i Konventës mbron veprime të njëhershme – martesë, kurse neni 8 mbron një gjendje të vazhdueshme. Ky dallim shprehet më së miri në faktin se shtetet nuk mund t'u ndalojnë të burgosurve të martohen por mund të ndalojnë të burgosurve të martuar të bashkëjetojnë.

Neni 12 garanton barazinë ligjore mes gruas dhe burrit në gëzimin e kësaj të drejtë. Por neni 12 nuk përcakton te drejtën për të zgjidhur martesën (divorcin) por edhe as perspektivën për t'u rimartuar (rasti Johnston e të tjerë kundër Irlandës 1986). Por ja vlen të përmendet se neni 5 i protokollit nr.7 parashikon barazinë e bashkëshortëve si brenda martesës ashtu edhe në rastin e zgjidhjes së saj, dmth e drejta në privatësi dhe familje neni 8 e drejta për tu martuar neni 12 dhe barazia ndërmjet bashkëshortëve protokollit 7 neni 5 janë të lidhura mes veti dhe si rrjedhim së bashku mbrojnë një gamë të drejtash që mbivendosen dhe ndërthuren.

## **Përfundim**

Republika e Kosovës ka prioritet anëtarësimin ne OKB dhe Këshillin e Evropës duke marr mbi vete obligimin për zbatimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut, të gjitha të drejtat e garantuara me Konventë garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht te drejtat e garantuara nga neni 8 dhe 12 janë të garantuara në nenin 36 dhe 37 të Kushtetutës;<sup>36</sup>

---

36 Neni 36 dhe neni 37 i Kushtetutes se Republikes se Kosoves





Franciska Zhitia Ymeri



Saranda Bogaj Sheremeti

## TORTURA

### 1. Nocioni i torturës

Tortura është një akt ç'njerëzor, poshtërues e degradues, e ndërmarr nga personi zyrtar, një veprim i kryer me dashje, me qëllim që nga ai person të merren informata, ose pohime të ndryshme për veprime të cilat i ka kryer apo dyshohet se i ka kryer.

Tortura si një trajtim mizorë, rrënjët e veta i ka që nga historia e hershme, por që po praktikohet nga shumë shtete edhe në ditët e sotme.

Që të mund të kuptojmë më mirë trajtimin e temës që kemi zgjedhur, fillimisht duhet të kuptojmë dhe shtjellojmë atë se çka kuptojmë me torturë.

Torturë do të thotë “dhunë e rëndë trupore apo mundim me mjete e mënyra të ndryshme, që i bëhet dikujt për ta detyruar të flasë, të tregojë të fshehtat, të nënshtrohet, të zbulojë fajin dhe bashkëfajtorët etj.; rrahjet, lënia pa ngrënë, pa ujë e pa gjumë, ngacmimi i plagëve etj.

Ndërsa, sipas normës juridike ndërkombëtare, nocioni i torturës është përkufizuar në kuptim edhe më të gjerë: ”torturë do të thotë çdo veprim që i bëhet një personi, me qëllim që t’i shkaktohen dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore për ta detyruar atë ose ndonjë person të tretë që të japë informacione ose pohime për ta dënuar veprën, të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër, të

bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhimbjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky nocion nuk përfshin vuajtjet dhe dhimbjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.”

Tortura është përdorur qysh në fillimet e shoqërisënjerëzore. Në Evropë, ajo arriti kulmin, në përiudhën e inkuizicionit. Tortura u përdor si mjet kryesor terrori në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera komuniste të Evropës Lindore. Sipas konventës së OKB-së, datë 26 Qershor 1987, tortura përcaktohet: "Torturë quhet çdo veprim, me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore, me synimin për të marr informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet e ka kryer, për të frikësuar ose për të bërë presion, ose për çdo motiv tjetër"

Karakteristikat që i përmban kjo veprë penale janë:

1. Lidhur me përgjegjësinë penale, kjo veprë penale mund të kryhet **vetëm me dashje**,
2. Këtë veprë penale mund ta kryej **vetëm personi zyrtarë** dhe atë vetëm nëse veprën e kryen gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.
3. Për tu konsideruar se është kryer kjo veprë penale kërkohet edhe **qëllimi i caktuar** ku personi zyrtar e përdor forcën me qëllim të nxjerrjes së deklaratës nga i dyshuari.

## **2. RREGULLIMI NË ASPEKTIN NDËRKOMBËTAR, KOMBËTAR**

Shumë kush mund të bëjë pyetjen se: Ç’lidhje kanë të drejtat e njeriut me zhvillimin e një vendi apo me çështje të tjera që lidhen me të?. Cili është roli dhe funksioni që ato luajnë në ndërtimin dhe prosperitetin ekonomik, social dhe moral të një vendi? Përgjigjen më të mirë të kësaj pyetjeje ja dhanë burrat e Shtetit të Evropës pas shkatërrimeve të Luftës së Dytë Botërore. Ata vendosën të ndërtojnë një Evropë të mbështetur në themele më të gjëra sesa vetëm në zhvillimin ekonomik, tregjet e lira. U mendua se ishte e nevojshme të rindërtohej kontinenti mbi bazën e respektit për vlera



të veçanta, të drejtat dhe liritë të cilat përcaktojnë konceptin e shtetit të së drejtës dhe që përbëjnë shtyllën kryesore të shoqërive demokratike. Ata pra vendosën që një shoqëri nuk mund të ndërtohet pa e vendosur individin, respektin për dinjitetin e tij dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej tij në qendër të vëmendjes.

Këshilli i Evropës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut lindën nga kjo nevojë dhe nga këto bindje.

Së bashku me Magna Kartën dhe Deklaratën Franceze të të Drejtave të Njeriut, Billi i të Drejtave i Shteteve të Bashkuara shërbeu si një model për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila thekson se: "...është e nevojshme që të drejtat elementare të njeriut të mbrohen me dispozitat juridike të shtetit, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes". Gjithashtu, ndër parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, është edhe Neni 5 i kësaj Deklarate, ku thuhet: "Kurrkush nuk guxon t'i nënshtrohet dhunës ose aktit të dënimit brutal, johuman ose poshtëruës"; Gjithashtu, edhe sipas nenit 7 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat qytetare e politike, parashikohet ndalimi i formave dhe të mjeteve të tjera të torturës; "Çdo njeri ka të drejtë në respektimin dhe në mbrojtjen e integritetit të tij fizik dhe mendor. Askush nuk guxon t'iu nënshtrohet vuajtjeve dhe dënimit johuman dhe poshtëruës", sepse këto forma të ushtrimit të torturës janë të ndaluara, edhe me Kartën mbi të drejtat themelore në BE (Kreu I, nenet 3 dhe 4), të miratuar në Nicë, më 17.12.2000).

Gjithashtu, sipas dispozitave të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, neni 3, thuhet se "Askush nuk guxon t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve e trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese" (Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Romë, 4.11.1950 hyrë në fuqi, më 3.09.1953; Konventa Evropiane për parandalimin e torturës, të dënimeve dhe të trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, Strasburg, 26.11.1987 hyrë në fuqi më 1 shkurt 1989, paragrafët 3 dhe 4.

## **2.1 Tortura sipas Kodi Penal të Kosovës**

Ky kod torturën si vepër penale e ka futur tek Veprat Penale kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut-neni 165.

Sipas KPK: personi zyrtar ose personi i cili vepron me qellim të shtytjes ose me pëlqim apo pranim të personit zyrtar, i cili kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej 5-15 vjet.

Ky kod është aprovuar në vitin 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi tek në vitin 2004, deri në këtë vit ka ekzistuar Ligji Penal i Serbisë, i cili po të krahasohej me Kodin e Tashëm Penal të Kosovës ka një dallim të madh sidomos në shqiptimin e dënimit.

Ish Jugosllavia njihet si një ndër vendet që më së paku i ka zbatuar ligjet në fuqi, ligjet të cilat i kanë nxjerr organet e saj, por edhe për zbatimin e marrëveshjeve, konventave, të cilat i kanë nënshkruar dhe janë shtete palë të tyre.

Në ende jemi duke i vuajtur pasojat e asaj gjendje anarkie, në burgjet e Kosovës edhe sot e kësaj dite nuk po praktikohen sa duhet të drejtat e të burgosurve, ku shumë shpesh po hasemi në protesta të ndryshme nga ana e të burgosurve.

Sipas Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në vitin 2006 janë regjistruar 500 viktima të torturës.

### **3. KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Askush nuk vihet nën torturë, trajtim ose ndëshkim ç'njerëzor ose poshtëruës.

Të drejtat e mbrojtura nga neni 3 I Konventës lidhen drejtpërdrejt me integritetin personal dhe dinjitetin njerëzor të individit. Kështu, liria nga tortura, ndëshkimi dhe trajtimi ç'njerëzor ose poshtëruës janë të drejta me rëndësi të jashtëzakonshme. Në të njëjtën kohë rregullat që lejojnë të përcaktohet nëse një shtet ka shkelur ndonjë nga këto të drejta janë, në një masë të madhe, subjektive. Këto dy elemente kanë bërë që Komisioni dhe Gjykata të interpretojnë dispozitat e Nenit 3 në mënyrë strikte, në shumicën e rrethanave.

Kështu që, Gjykata dhe Komisioni idallojnë të tre nocionet e Nenit 3 në përputhje me shkallën e ashpërsisë së trajtimit ose ndëshkimit të veçantë. Për secilin nocion ata kanë përcaktuar standardet e shkallëve të sjelljes së ndaluar si vijon:

- Tortura-trajtim ç'njerëzor që bëhet me dashje e që shkakton vuajtje shumë të rënda e mizore.
- Trajtim ose ndëshkim ç'njerëzor- të shkaktuarit e një vuajtje intensive fizike dhe mendore.
- Trajtim poshtërues-keqtrajtim që synon të krijoj tek viktimat ndjenja frike ankthi e inferioriteti të afta për ta poshtëruar e përlulur ato dhe që mundësisht të thyejnëqëndresën e tyre fizike e morale.

Ja vlen të shënohet lidhur me këtë se ndonëse janë bërë shumë ankime për shkelje të nenit 3 nga të burgosur individual, Komisioni dhe Gjykata rrallë kanë gjetur shkelje në këto çështje. Gjykata gjeti shkelje të nenit 3 aty ku individët paraqitën dokumentacionin me kohë për dëmtimet që ata pretendonin se kishin pësuar ndërkohë që ishin në mbajtje nga policia dhe ku qeveria nuk ofroi shpjegime alternative të besueshme lidhur me shkakun e atyre dëmtimeve.

Gjykata ka gjetur një shkelje të Nenit 3 në çështjen Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar (1989), në të cilën një i ri gjerman, ekstradimi i të cilit kërkohet nga SHBA për vrasje e cila ndëshkohej me vdekje, do të përballej me mundësin e një burgimi të gjatë në "radhën e vdekjes". Megjithëse e pranoi se dënimi me vdekje ishte i ligjshëm në SHBA, Gjykata deklaroi se t'ia nënshtroje aplikuesin fenomenit të radhës së vdekjes ishte në kundërshtim me të drejtat që i garanton neni 3 dhe se Mbretëria e Bashkuar do të ishte përgjegjëse për këtë sipas Konventës.

Në një rast tjetër Gjykata konstatoi një shkelje aty ku mungesa e mbështetjes financiare ose emocionale dhe cilësia e ulët e kujdesit shëndetësor në vendin e kthimit ishin të papërshtatshme për të plotësuar nevojat e një individi në fazat e fundit të AIDS-it (D kundër Mbretërisë së Bashkuar (1997)).

## 4. GJYKATA E STRASBURGUT

Asnjë organ, as institucion shtetëror nuk ka të drejtë të ushtrojë përndjekje, arrestime, persekutime, burgosje, torturë dhe terror ndaj asnjë personi që kërkon realizimin e të drejtave dhe lirive të tij, sepse këto akte të shëmtuara antihumane dhe antinjerëzore të botës së qytetëruar janë të ndaluara dhe të dënueshme sipas normave dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe të rendit juridik pozitiv ndërkombëtar përbëjnë krim, përkatësisht vepër penale, e cila sanksionohet rreptësisht sipas Gjykatës Ndërkombëtare të OKB-së dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ngritja e Gjykatës me një juridiksion unik në botë dëshmon dëshirën për të siguruar që kjo Konventë duhet të jetë më tepër sesa vetëm një deklaratë tjetër.

Që nga krijimi, veprimtaria e Këshillit të Evropës është përqendruar për të mbështetur respektin më të madh për këto vlera në ligj dhe në praktikë në shtetet e tij anëtare. Në këtë kontekst Gjykata luan një rol thelbësor për transformimin e të drejtave në realitet për qindra dhe mijëra persona të cilët e kanë gjetur zgjidhjen e të drejtës së tyre në Strasburg, ndërsa vendimet e saj kanë rezultuar në ndryshime të pallogaritshme në ligjin dhe praktikën e shteteve anëtare në përfitim të të gjithëve.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e KEDNJ sigurisht qëndron në autoritetet kombëtare. Gjykata e Strasburgut është një opsion i fundit dhe siguron zgjidhjen vetëm për një numër të vogël individësh. Me qëllim që gjykatësit dhe prokurorët të jenë në gjendje të përmbushin këtë rol të rëndësishëm ata duhet të trajnohen siç duhet. Këshilli i Evropës mirëpret përpjekjet e autoriteteve shqiptare mbi të gjitha në fushën e trajnimit në shkollën e Magjistraturës. Sa më shumë çështje të zgjidhen në gjykatat kombëtare, aq me pak njerëz do të detyrohen të sjellin aplikimet e tyre në Strasburg.

### 4.1 Si t'i drejtoheni Gjykatës së Strasburgut

Nëse mendoni se arsyet e ankimit tuaj kanë të bëjnë me shkeljen e një prej të drejtave të garantuara nga Konventa, ose nga njëri prej Protokolleve,

dërgoni më parë te sekretari i Gjykatës së Strasburgut një letër që përmban të dhënat e radhitura me poshtë. Kjo letër duhet t'i adresohet: Le Greffier de la Cour européenne des Droits de l'Homme Conseil de l'Europe F-67075 STRASBOURG CEDEX FRANCE. Letra juaj mund të shkruhet në gjuhën shqipe ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj dhe duhet të përmbajë: Një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të ankimit tuaj, si dhe citimin e së drejtës ose të të drejtave të garantuara nga Konventa dhe që i vlerësoni se janë shkelur. Këtë do ta bëni pasi të keni lexuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të gjeni nenin përkatës, p.sh. ndalimi i torturës (neni 3), e drejta për një proces të rregullt (neni 6), ndalimi i diskriminimit për shkak të origjinës kombëtare, fesë (neni 14) etj. Ankesat që keni bërë p.sh. në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë.

Listën e vendimeve të dhëna për çështjen tuaj nga një autoritet publik, duke saktësuar për çdo vendim: datën, përmbajtjen e tij të përmbledhur dhe organin që e ka dhenë. Bashkëngjitiniletrës tuaj një kopje të këtyre vendimeve. (Këto dokumente nuk do t'ju kthehen. Si rrjedhim, është në interesin tuaj të dërgoni vetëm kopje dhe jo origjinale). Ankesa mund të bëhet nga ju personalisht ose avokati i autorizuar prej jush, ose çdo person tjetër i autorizuar me shkrim prej jush. Sekretari i Gjykatës do t'ju përgjigjet. Do t'ju kërkohen ndoshta dokumente, të dhëna ose shpjegime plotësuese lidhur me ankimin tuaj. Mund t'ju informojnë mbi mënyrën se si është interpretuar Konventa në raste të ngjashme. Në rastin kur pranimi i ankesave tuaja ka ndonjë pengesë evidente, do t'ju bëhet e njohur. Nëse nga korrespondenca juaj me sekretarin del që ankesa juaj mund të regjistrohet si një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut dhe nëse ju dëshironi që ajo të jetë e tillë, sekretari do t'ju dërgojë formularët që përdoren për të paraqitur formalisht kërkesën tuaj. Pasi t'i keni plotësuar dhe drejtuar ato sekretarit, kërkesa juaj do t'ju paraqitet Gjykatës. Ju do të viheni në dijeni të ecurisë së procedurës nga sekretari. Kjo procedurë, të paktën në fillim, zhvillohet me shkrim. Kështu që, ju apo personi i autorizuar nga ju, nuk ka pse të paraqitet në selinë e Gjykatës. Nëse është e mundur, është më mirë që të ngarkoni një avokat të paraqesë kërkesën tuaj. Më vonë, gjatë procedurës, nëse duhet, ju mund të merrni ndihmë gjyqësore, në qoftë se nuk dispononi mjetet për të shpërblyer një avokat. Por kjo ndihmë nuk mund të jepet që në momentin e paraqitjes së kërkesës, por pasi ankesa të jetë pranuar për shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut.

## Konkluzioni

Pra, çdo veprim torture ose çdo dënim a trajtim tjetër mizor, ç' njerëzor ose degradues është një fyerje e dinjitetit njerëzor dhe duhet dënuar si një mohim i qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe si një dhunim i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Ndonëse i ndaluar me të drejtën ndërkombëtare dhe i dënuar nga një numër i konventave ndërkombëtare, tortura vazhdon të jetë realitet predominant dhe mjaft i përhapur në kohën tonë. Tortura dhe keqtrajtimi vazhdojnë të praktikohen në shumë shtete, përfshirë shtetet nënshkruese të Konventës kundër Torturës. Presioni ndërkombëtar mund t'i detyrojë këto qeveri që të përdorin pushtetin e tyre për parandalimin e torturës, duke na dhënë një fije shpresë, se një ditë tortura do të jetë vetëm histori.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara tortura është prezente në shumë shtete, megjithë dënimin e saj nga komuniteti ndërkombëtar, ende është pjesë e sistemit të drejtësisë. Tortura është një krim, dhe ndalimi i saj është themelor dhe i padiskutueshëm rreth 50 shtete, përfshirë Iranin, Birmaninë dhe Vietnamin, nuk e kanë nënshkruar konventën ndërkombëtare të OKB-së kundër torturës të vitit 1987 andaj u bëhet thirrje këtyre shteteve të nënshkruajnë marrëveshjen dhe të hapin burgjet e tyre për kontroll nga ana e OKB-së. Organizata për të drejtat e njeriut, Amnesty International ka paralajmëruar se do të bëhen përpjekje në mënyrë që të ndalohet tortura në këto shtete.

Tortura shkatërron meshkuj, gra e fëmijë, familje e komunitete. Tortura pamundëson zhvillimin njerëzor dhe ekonomik të shoqërisë, që është një ndër të drejtat e të gjithë njerëzve.


Ekzistojnë katastrofa që nuk mund të parandalohen, si tsunami. Megjithatë, tortura është një fatkeqësi e shkaktuar nga vetë njeriu. Ju mund të pengoni torturën dhe t'i shëroni viktimat e prekura nga ajo.

## Literatura:

- Fjalori i gjuhës shqipe „Rilindja“ Prishtinë 1976 f.569.
- Deklarata universale e të drejtave të njeriut e vitit 1948 .
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës.
- E drejta penale pjesa e posaçme Prof,Dr. Ismet Salihu.



Minir Hoti



Mentor Hajraj

## ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

*“Instituti procedural i ankimit ka lindur në kuadër të procedurës inkuizitore. Ai bazohej në të drejtën e perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të tij. Lutja që i bëhet perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të varur prej tij quhej apellatio, kësisoj apeli kuptonte të drejtën e subjektit procedural për të goditur vendimin e një gjyqtarit më të ulët përpara gjyqtarëve më të lartë. Më tutje çdo gjykatë më e lartë kishte të drejt ta rishikonte çështjen duke dhënë një vendim të ri, veprimi procedural i gjykimit në dy shkallë i bazuar jo në varësinë e gjyqtarit më të ulët nga ai me i lart sepse gjyqtarët varen vetëm nga ligji, por në dhënien e vendimeve sa më të mira ”.<sup>37</sup>*

Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe procedura e paraparë për paraqitjen e saj është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nga neni 398 deri në nenin 429.

Në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është paraparë e drejta për ankimim efektiv, ku çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare<sup>38</sup>.

<sup>37</sup> E drejta e Procedures Penale prof. Ejup Sahiti Prishtinë 2005

<sup>38</sup> KEDNJ Neni 13

Përkundër garancive procedurale të parashikuara në procedurë të cilat kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës, për kundër faktit se me aktgjykim synohet vërtetimi i gjendjes faktike ashtu siç është zhvilluar ngjarja me rastin e kryerjes së veprës penale, nuk përjashtohet mundësia që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë për shkaqe të ndryshme të jetë jo i drejt ose me atë të jetë shkelur ndonjë dispozitë ligjore.

## **1. PERSONAT E AUTORIZUAR PËR PARAQITJEN E ANKESËS**

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa e paraqitur në afat e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit-karakterit suspenziv i ankesës.

Në bazë të nenit 399 ankesë mund të paraqesin palët, mbrojtësi i të pandehurit, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari, por vetëm për vendimet e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale <sup>39</sup>

Të drejtën më të plotë për paraqitjen e ankesës e ka prokurori publik, për faktin se ai mund të paraqes ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si në dëm po ashtu edhe në dobi të të akuzuarit, ngase prokurori e mbron interesin e përgjithshëm publik qëçështja penale të gjykohet drejt dhe jo në secilin rast të arrihet dënimi i të pandehurit.

Prokurori publik mund të paraqes ankesë në dobi të pandehurit edhe përkundër vullnetit të tij ngase punon në mënyrë të pavarur dhe mbron interesat e përgjithshme.

I pandehuri si palë në procedurë e ka të drejtën e paraqitjes së ankesës sipas të gjitha bazave ankimore nën kushtet dhe procedurën e paraparë me KPP.

Kodi i Procedurës Penale nuk përmban asnjë dispozitë të veçantë mbi mundësinë që i pandehuri të paraqes ankesë kundër aktgjykimit lirues, një ankesë të tillë ligji nuk e ndalon shprehimisht, por kjo varet nga interesi

---

39 KPPK.



juridik i të pandehurit për paraqitjen e ankesës. E drejta e të pandehurit në ankesë ndaj aktgjykimit lirues nuk nënkupton se ai do të ankohet në dëm të vetin, por ekzistojnë raste kur interesi juridik i tij është që ai të lirohet sipas bazës faktike e jo sipas asaj juridike.

I dëmtuari në bazë të nenit 399 par.3 mund të ushtroj ankesë ndaj aktgjykimit vetëm lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, integritetit seksual dhe të sigurimit të trafikut publik, mirëpo nëse në atë çështje i dëmtuari ka vepruar si paditës subsidiar, i dëmtuari mund të paraqes ankesë për të gjitha bazat e atakimit të ankesës.

I dëmtuari nuk mund të paraqesë ankesë për shkak të shkeljeve ligjore, qofshin ato shkelje procedurale ose materiale e as për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Mbrojtësi e ka të pavarur të drejtën e paraqitjes së ankesës nga i pandehuri pra krahas ankesës të cilën e ka paraqitur vet i pandehuri edhe mbrojtësi mund të paraqes ankesë çka do të thotë se njëra ankesë nuk e përjashton ankesën tjetër, mirëpo mbrojtësi nuk mund të paraqes ankesë në dëm të pandehurit.

Në bazë të nenit 399 par.5 të KPP, mbrojtësi mund të paraqes ankesë edhe pa autorizim të posaçëm të të akuzuarit, por jo edhe kundër vullnetit të tij, këtu kemi përjashtim vetëm në rastet kur i pandehuri dënohet me burgim afatgjatë, si edhe në procedurën penale ndaj të miturve neni 77 par.2 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur <sup>40</sup>.

Të drejtën për paraqitjen e ankesës e kanë edhe personat pasuria e të cilëve është konfiskuar, ose personat nga të cilët është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale, gjithashtu të drejtën e paraqitjes së ankesës e kanë edhe personat juridik pasuria e të cilëve është konfiskuar.

Të gjithë personat të cilët në bazë të ligjit janë të thirrur për paraqitjen e ankesës janë të detyruar për paralajmërimin e ankesës dhe atë më së voni 8 (tetë) ditë pas shpalljes së aktgjykimit.

---

40 Kodi i Drejtësisë për të Mitur neni 77 par.2.

Kur askush nga personat me të drejtë ankese nuk e paralajmëron ankesën brenda afatit ligjor konsiderohet se ata kanë hequr dorë nga kjo e drejtë dhe në këto raste nuk është e nevojshme që aktgjykimi i përpiluar me shkrim të përfshijë pjesën e arsytimit dhe as përshtkrimi i audioincizimit të shqyrtimit gjyqësor, përjashtim ka rasti kur i akuzuari dënohet me burgim efektiv.

## 2. PËRMBAJTJA E ANKESËS

Përmbajtja e ankesës është e përcaktuar në nenin 401 të KPP, sipas kësaj dispozite ankesa duhet të përmbaj:

- Të dhënat mbi aktgjykimin i cili ankimohet,
- Arsyet e kundërshtimit të aktgjykimit,
- Arsyetimin e ankesës,
- Propozimin për anulim të tërësishëm apo të pjesërishtëm të aktgjykimit ose për ndryshimin e tij dhe
- Nënshkrimin e ankesës.

Nëse ankesa e paraqitur nuk i përmban të dhënat e cekura si më lartë, dhe ajo është e paraqitur nga i akuzuari, i dëmtuari, paditësi subsidiar ose paditësi privat të cilët nuk kanë përfaqësues të autorizuar, atëherë gjykata e shkallës së parë kërkon nga ankuesi që në afatin e caktuar ta ndryshojë ankesën me parashtrësë apo me gojë të cilën duhet shënuar në procesverbalin e gjykatës.

Kur në ankesë nuk ceken të dhënat për aktgjykimin ndaj të cilit paraqitet ankesa, gjykata e hudhë ankesën vetëm nëse kur nuk mund të konstatojë se cilit aktgjykim i referohet. Kur ankesa nuk i përmban të dhënat nga neni 401 par.1 nënparagrafët 2, 3 dhe 5 të KPP gjykata e hudhë ankesën.

Kur ankesën e paraqesin i dëmtuari paditësi subsidiar apo paditësi privat të cilët kanë përfaqësues të autorizuar, apo paraqitës i ankesës është prokurori publik dhe ankesa nuk i përmban të dhënat nga neni 401 par. 1 nënp. 2, 3 dhe 5 ose kur ankesa nuk i përmban të dhënat nga paragrafi 1 nënparagrafi 1 i këtij neni, dhe nuk mund të konstatohet se cilit aktgjykim i referohet ankesa, atëherë gjykata e hudhë ankesën e tillë.

Në ankesë lejohet paraqitja e provave të reja të cilat nuk janë shqyrtuar në procedurën e cila është zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë, por në këto raste ankuesi e ka për obligim të jap arsye pse ato prova nuk i ka paraqitur më herët.

Kur ankuesi thirret në fakte të reja ai detyrohet të paraqes prova me të cilat këto fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja, detyrohet të paraqes fakte që ai synon t'i vërtetoj me to.

### 3. ARSYET E USHTRIMIT TË ANKESËS NDAJ AKTGJYKIMIT TË GJYKATË SË SHKALLËS SË PARË

Ankesa kundër aktgjykimit mund të paraqitet për shkak të metave reale ose juridike deri të cilat është arritur për shkak të lëshimeve dhe gabimeve të subjekteve procedurale, në rend të parë shkak i lëshimeve dhe shkeljeve të cilat i ka bërë gjykata.

Në bazë të nenit 402 paragrafi 1 i KPP ankesa ndaj aktgjykimit mund të ushtrohet për këto arsye:

- Për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Për shkak të shkeljes së ligjit penal
- Për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike
- Për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale.

Kur ankuesi pretendon se gjykata me aktgjykim ka bërë shkelje të ligjit **error in iure**, në këtë rast ankuesi pretendimin e vet duhet ta mbështes në ndonjë prej shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale apo në shkelje të ligjit penal, ndërkaq kur ankuesi pretendon se gjykata me aktgjykim ka bërë lëshim të natyrës faktike **error in faktis**, atëherë ankuesi do ta përdorë vërtetimin e gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike si bazë për paraqitjen e ankesës<sup>41</sup>.

---

41 E drejta e Procedurës Penale Prof Ejup Sahiti 2005

Shkeljet esenciale ndahen në shkelje absolute dhe në shkelje relative.

Shkelje esenciale absolute të dispozitave të procedurës penale konsiderohet kur:

- Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari ose gjyqtari laik i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;
- Në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari ose gjyqtari laik i cili është dashur të përjashtohet.
- Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit mbrojtësit, paditësit subsidiar ose paditësit privat, pavarësisht nga kërkesat e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtimin gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij.
- Publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;
- Gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuzë e paditësit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;
- Aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes ose kur gjykata ka refuzuar akuzën për shkak të moskompetencës lëndore;
- Gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;
- Aktgjykimi bazohet në prove të pa pranueshme;
- I akuzuari i thirrur të deklarojë mbi fajësinë e tij nuk e ka pranuar fajësinë për të akuzuarin ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave;
- Aktgjykimi ka tejkalluar akuzën (neni 386, paragrafi 1 i këtij Kodi);
- Me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 417 të këtij Kodi, pra kjo ka të bëjë me ato raste kur ankesa është paraqitur në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi përse i përket vlerësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal nuk

mund të ndryshohet në dëm të tij pra këto vjen në shprehje parimi *reformation in peius*- mos keqësimi i pozitës së të pandehurit.

- Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, kur arsyet janë plotësisht të paqarta ose kundërthënëse në masë të konsiderueshme, kur për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që është paraqitur në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbale për deklarime të dhëna në procedurë dhe vet këtyre shkresave dhe procesverbaleve.

Shkeljet esenciale relative:

Shkeljet të cilat janë paraparë në nenin 403 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës, janë shkelje esenciale relative, të cilat gjykata gjatë kohës së përgatitjes së shqyrtimit gjyqësorë, duke përfshi procedurën paraprake, gjykatën prokurorin publik dhe policin nëse;

- Nuk është zbatuar ndonjë dispozitë e Kodit Penal të Kosovës ose është zbatuar gabimisht ose
- Janë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mund të ndikoj në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.

#### **4. SHKELJET E LIGJIT PENAL**

Grupin e dytë të bazave për ankesë e përbejnë shkeljet e ligjit penal, ose ndonjë dispozitë tjetër penale të cilat kanë të bëjnë me moszbatimin ose zbatimin e gabuar të ndonjë dispozite lidhur me ekzistimin e veprës penale, me përgjegjësinë penale ose me sanksionin penale.

Në bazë të nenit 404 të KP, shkelje e ligjit penal ekziston kur ligji penal është shkelur nëçështjet;

- Nëse vepra për të cilën i akuzuari ndiqet është vepër penale
- Nëse ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësin penale

- Nëse ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë a faljes, ose me pare është gjykuar me aktgjykim të formës së prere;
- Nëse lidhur me veprën e gjykuar penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet.
- Nëse në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternative, vërejtje gjyqësore ose marrje e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore ose
- Nëse janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të vuajtur.

## **5. VËRTETIMI I GABUESHËM OSE JO I PLOTË I GJENDJES FAKTIKE**

Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me të metat e aktgjykimit lidhur me gjendjen faktike – error in faktis.

Në bazë të nenit 405 paragrafi 2 i KPP, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose incizimit teknik vënë në pikëpyetje saktësinë ose besnikërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme,

Vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike ekziston atëherë kur gjykata në bazë të fakteve dhe provave të caktuara ka vërtetuar gjendjen faktike, por me rastin e vlerësimit të provave dhe përfundimit mbi të vërtetën e tyre ka gabuar, pra vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston kur gjykata ka lëshuar të vërtetojë të gjitha faktet relevante dhe provat e duhura për marrjen e vendimit të duhur.

Në ankesë të paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike mund të paraqiten edhe prova të reja – Beneficium novorum, por në bazë të nenit 401 paragrafi 4 i KPP, nëse ankuesi në ankesë paraqet

fakte dhe prova të reja, ai detyrohet të arsyetoj përse ato nuk i ka paraqitur me parë, kur ankuesi thirret në fakte të reja ai detyrohet të paraqes prova me të cilat këto fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja detyrohet të paraqesë faktet që ai synon t'i vërtetoj me to.

Në nenin 406 të KPP, janë paraparë edhe grupi tjetër i arsyeve për paraqitjen e ankesës kështu në paragrafin 1 të këtij neni ankesa mund të paraqitet lidhur me vendimin mbi shqiptimin e dënimit ose vërejtjes gjyqësore kur gjykata duke marrë parasysh rrethanat që ndikojnë në vërejtjen gjyqësore ose në lartësinë e dënimit përkundër mos tejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt dënimit ose vërejtjes gjyqësore, pra kur gjykata nuk e ka peshuar mirë dënimin.

Në paragrafin 2 të nenit 406 të KPP, është paraparë mundësia e paraqitjes së ankesës ndaj vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të personave të varur nga droga ose alkooli ose përkonfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, edhe përkundër faktit se gjykata nuk ka bërë shkelje të nenit 404 nënparagrafi 5 i Kodit Penal, ka marr vendim jo të drejt ose nuk e ka shqiptuar masën rehabilitimit të detyrueshëm për personat e varur nga droga ose alkooli ose masën për konfiskim e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, përkundër ekzistimit të bazës ligjore për këtë.

Ndaj vendimit mbi shpenzimet e procedurës mund të ushtrohet ankesë kur gjykata për shpenzimet e tilla ka vendosur në mënyrë jo të drejt ose në kundërshtim me dispozitat e KPP.

Gjithashtu ankesa mund të ushtrohet edhe kundër vendimit mbi kërkesën pasurore juridike dhe kundër vendimit mbi shpalljen e aktgjykimit nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit kur gjykata përçështjet e tilla ka marr vendim në kundërshtim me dispozitat e KPP.

## **6. PROCEDURA LIDHUR ME ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

Procedura lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë zhvillohet në dy pjesë, në gjykatë të shkallës së parë dhe në gjykatë të shkallës së dytë.

## **6.1 Procedura lidhur me anekese ne gjykatën e shkallës se pare**

Në nenin 407 dhe 408 të KPP, është paraparë procedura e cila zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë lidhur me ankesën e paraqitur.

Ankesa i paraqitet gjykatës së shkallës së parë e cila e ka marr aktgjykimin për gjykatën e shkallës së dytë në kopje të mjaftueshme për gjykatën, për palën kundërshtare dhe për mbrojtësin për të dhënë përgjigje në ankesë.

Në gjykatë të shkallës së parë ankesën e pranon kryetari i trupit gjykues i cili e ka dhënë aktgjykimin, ai e kontrollon ankesën a është e afatshme, a është e paraqitur nga personi i autorizuar, dhe ai i përmban elementet sipas të cilave mund të vendoset lidhur me të.

Ankesa e paraqitur jashtë afatit ligjor, ose ankesa e palejueshme me aktvendim hudhet nga kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë, kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në gjykatë të shkallës së dytë.

Ankesën e afatshme, të lejuar dhe të plotë kryetari i trupit gjykues ia dërgon palës kundërshtare, e cila në afat prej tetë ditësh ka të drejt të paraqes përgjigje në ankesë. Gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë ankesën, përgjigjen në ankesë nëse ka dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.

## **6.2 Procedura lidhur me ankesën në gjykatën e shkallës së dytë**

Kur gjykata e shkallës së dytë pranon lëndën me ankesë atë ia dorëzon gjyqtarit raportues të caktuar sipas orarit të gjykatës, gjyqtari raportues ka për detyrë të studioj lëndën, veçanërisht parashtrimet e ankuesit në ankesë.

Kur është fjala për veprën penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare gjyqtari raportues ia dërgon lëndën prokurorit publik kompetent, i cili e shqyrton ankesën dhe pa vonesë ia kthen gjykatës, me këtë raste mund të paraqes propozim ose të deklaroje se propozimin do ta paraqes në seancën e kolegjit, pasi prokurori publik e kthen lëndën, kryetari i kolegjit e cakton seancën e kolegjit.



Për seancën e kolegjit njoftohet prokurori publik, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, mosardhja e palëve të thirrur me rregull nuk e pengon mbajtjen e seancës së kolegjit.

Seanca e kolegjit fillon me raportimin e gjyqtarit raportues mbi faktet. Gjykata e shkallës së dytë në seancë të kolegjit vendos nëse do ta mbajë shqyrtimin, shqyrtimi mbahet vetëm kur është e nevojshme që për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra me parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës së shkallës së parë në gjykim të serishëm.

Nëse gjykata e shkallës së dytë vendos që ta mbajë shqyrtimin, atëherë shqyrtimi fillon me raportimin e gjyqtarit raportues i cili e paraqet gjendjen faktike por pa e dhënë mendimin e tij për bazueshmerinë e ankesës.

Pjesa e aktgjykimit ndaj të cilit është paraqitur ankesa dhe sipas nevojës edhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor lexohet me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, pas kësaj thirret ankuesi ta arsyetojë ankesën dhe pastaj pala kundërshtarë që t'i përgjigjet, palët dhe mbrojtësi gjatë shqyrtimit mund të paraqesin prova dhe fakte të reja, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij gjithmonë e kanë fjalën të fundit.

Në bazë të rezultatit të shqyrtimit paditësi mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga aktakuza ose ta ndryshoj atë në dobi të të akuzuarit, kur prokurori tërhiqet nga aktakuza në tërësi, i dëmtuari i gëzon të drejtat nga neni 63 i Kodit të Procedurës Penale.

### **6.3 Kufijtë e shqyrtimit të ankesës**

Pas paraqitjes së ankesës gjykata e shkallës së dytë e shqyrton aktgjykimin në pjesët për të cilat është ushtruar ankesa, por çdo herë sipas detyrës zyrtare shqyrton:

- Nëse ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave penale nga neni 403 paragrafi 1, nënparagrafi 1,2,6 dhe 8 deri në 12 të KPP;<sup>42</sup>

---

42 Neni 403 i KPPK.

- Nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur ne mungesë të të akuzuarit në kundërshtim me dispozitat e KPP;
- Nëse nëçështjen e mbrojtjes së detyrueshme është mbajtur shqyrtimi gjyqësor pa praninë e mbrojtësit dhe
- Nëse në dëm të të akuzuarit është shkëlur ligji penal.

Në qoftëse është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit aktgjykimi përse i përket vlerësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

## **7. VENDIMET E GJYKATËS SË SHKALLËS SË DYTË LIDHUR ME ANKESËN**

Duke vepruar sipas ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji penal i gjykatës së shkallës së dytë në seancën e kolegjit ose në shqyrtim mundet:

- Ta hudhe ankesën si të pa afatshme ose të palejuar
- Ta refuzojë ankesën si të pabazëdhe të vërtetë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë;
- Ta anulojë aktgjykimin dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje ose
- Ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë me aktvendim e hedh ankesën si të paafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, gjithashtu me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, ose kur ankesa është tërhequr.

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim e refuzon ankesën si të pa bazë dhe e vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kur vërteton se nuk ekzistojnë shkaqe për shkaqet për të cilat është ushtruar ankesa ndaj aktgjykimit dhe nuk ka shkelje të ligjit sipas nenit 415 paragrafi 1 i KPP, ndërsa me aktvendim e anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim kur vërteton se ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Duke vepruar sipas ankesës apo sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me aktgjykim, kur vërteton se faktet vendimtare në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar drejt porse duke marrë parasysh gjendjen e vërtetuar faktike sipas zbatimit të drejtë të ligjit është dashur të merret aktgjykim tjetër.

### **Përfundimi**

Në këtë punim objekt studimi ishte ankesa e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës, përmbajtjen e ankesës, shkaqet dhe bazat e ankesës, procedurën e cila zhvillohet pranë gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë përkitazi me ankesën e paraqitur dhe për llojet e vendimeve të cilat i merr gjykata e shkallës së dytë në bazë të ankesës së paraqitur.

### **LITERATURA:**

- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës;
- Kodi Penal i Kosovës;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur ;
- E Drejta e Procedurës Penale –Ejup Sahiti Prishtine 2005
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut





Musli Gashi



Ilir Rashkaj

## PASURIA E PËRBASHKËT E BASHKËSHORTËVE

### Hyrje

Në këtë punim jemi munduar ta trajtojmë temën „Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve“ e cila është mjaftë aktuale në Evropë e poashtu edhe në vendin tonë.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është e lidhur ngushtë me familjen dhe martesën, transformimet të cilat i kanë pësuar këto dy institute të së drejtës kanë reflektuar edhe në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve.

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve përbëjnë pjesën më të rëndësishme të së drejtës martesore, sepse me to rregullohet pasuria e bashkëshortëve, si çështje mjaft e ndjeshme në marrëdhëniet martesore.

Gjatë punimit të këtij seminari, temën e lartpërmendur e kemi trajtuar sipas kësaj renditje: kuptimi, natyra juridike, administrimi, disponimi dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

### Kuptimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

Marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve rregullohen me norma juridike të Ligjit mbi Familjen. Duke jetuar në bashkësi martesore, burri me gruan bashkërisht krijojnë të mira materiale për plotësimin e nevojave të veta dhe sigurimin e ekzistencës. Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjimi pasuror martesor.

LFK-ja legjitimon dy regjime pasurore martesore:

- a. Regjimi ligjor dhe
- b. Regjimi kontraktues.

Varësisht nga përkatësia e pasurisë dhe mënyra e fitimit të saj, bashkëshortët mund të kenë:

1. Pasuri tëveçantë;
2. Pasuri të përbashkët

## 1. PASURIA E VEÇANTË E BASHKËSHORTËVE

Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në momentin e lidhjes së martesës mbetet pasuri e veçantë e tij neni 46 LFK<sup>43</sup>. „Poashtu pasuri e veçantë është edhe ajo pasuri të cilën bashkëshorti e ka fituar gjatë bashkësisë martesore në çfarëdo mënyre të lejuar ligjore (trashëgim, dhurim, lojëra të fatit etj.) por jo me punë. Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit që e ka krijuar“<sup>44</sup>.

## 2. PASURIA E PËRBASHKËT E BASHKËSHORTËVE

Kur është fjala për pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve situata juridike dallon nga pasuria e veçantë. Pasuri e përbashkët bashkëshortore është pasuria e fituar me punë gjatë vazhimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë (neni 47 par.1 LFK)<sup>45</sup>. „Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve. Poashtu edhe pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë tëbarabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh“<sup>46</sup>. Për ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve duhet të plotësohen dy kushte:

---

43 Neni 46 LFK

44 Po aty

45 Neni 47 par.1 LFK

46 Po aty

1. Ekzistimi i bashkësisë martesore dhe
2. Puna e përbashkët e bashkëshortëve.

### 3. EKZISTIMI I BASHKËSISË MARTESTORE

Kusht për ekzistimin e pasurisë së përbashkët është ekzistimi i martesës jo vetëm formalisht por edhe realisht. Pa ekzistimin e bashkësisë martesore nuk mund të flitet për ekzistimin e pasurisë së përbashkët, sepse asaj do ti mungonte baza juridike mbi të cilën lind pasuria e përbashkët. Pasuria që bashkëshortët e fitojnë gjatë kohës sa zgjatë ndërprerja e jetës së përbashkët bashkëshortore nuk është pasuri e përbashkët e tyre, por pasuri e veçantë, pavarësisht që martesa ende nuk ka pushuar.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të krijohet në dy mënyra:

1. Punë të drejtpërdrejtë dhe
2. Punë të tërthortë.

Mënyra e drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur bashkëshorti martesor kryen veprimtari e cila drejtpërsëdrejti sjell të ardhura, qoftë në të holla apo në natyrë. Ndërsa mënyra e tërthortë dallon nga ajo e drejtpërdrejtë sepse bashkëshorti martesor kryen veprimtari të tjera si: punët shtëpiake, kujdesi për fëmijët etj., të cilat nuk sjellin të ardhura, mirëpo e ndihmon bashkëshortin tjetër dhe në mënyrë të tërthortë i kontribuon realizimit të të ardhurave.

Puna e bashkëshortëve martesorë paraqet kusht tjetër për ekzistimin e pasurisë së përbashkët. Puna duhet të kuptohet si aktivitet dhe kontribut për plotësimin e nevojave të bashkësisë martesore dhe familjare. Puna e bashkëshortëve mund të jetë e përbashkët apo individuale. Puna e përbashkët ekziston kur të dy bashkëshortët kanë të njëjtin profesion dhe punojnë të njëjtën punë, kurse puna individuale ekziston kur bashkëshortët nuk e kanë të njëjtën punë dhe nuk janë të profesionit të njëjtë. Objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve janë të drejtat mbi sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme, të drejtat reale si servitutet, e drejta e pengut etj.

#### 4. NATYRA JURIDIKE

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve rregullohet me norma urdhëruese.

Vlera e hiseve të titullarëve në pasurinë e përbashkët nuk dihet, por që të dy bashkëshortët së bashku janë titullar të një të drejte reale, fjala vjen të pronësisë mbi një send, por nuk dihet se mbi cilën pjesë të atij sendi është pronar secili prej tyre apo që të dy bashkëshortët janë kreditor të ndonjë të drejte kërkesore, p.sh. te kontrata e shitblerjes së sendit dy bashkëshortët janë titullar të së drejtës së pasurisë së përbashkët, çmimit të shitjes së sendit, por edhe me këtë rast nuk dihet vlera e hiseve të tyre në atë çmim, sepse ajo mbetet e papërcaktuar deri sa të behët pjesëtimi i pasurisë së përbashkët.

Mosrespektimi i vlerës së hiseve të titullarëve të së drejtës së pasurisë së përbashkët është karakteristikë tjetër që pasuria e përbashkët dallon nga bashkëpronësia. Kur flitet për bashkëpronësinë, duhet thënë se dihet qartë vlera e secilës hise dhe titullari i saj. Çdo bashkëpronar ka pjesën e caktuar alikuote (1/2, 1/3, 30% etj.), ndryshe nga pronarët e përbashkët, ku hiset e tyre në të drejtën e pasurisë në sendet e njëjta nuk dihen dhe nuk janë të përcaktuara as në mënyrë ideale e as reale.

Midis këtyre dy institucioneve ekzistojnë dallime edhe sa i përket rregullave që vlejnë për regjistrimin e sendeve të paluajtshme në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme. Andaj të drejtat e bashkëshortëve mbi sendet e paluajtshme, që janë objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të pacaktuara (neni 50 par.1 LFK)<sup>47</sup>. „Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Në rastet kur të dy bashkëshortët janë regjistruar në regjistrin publik të paluajtshmërive si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, konsiderohet se ata në këtë mënyrë e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët“<sup>48</sup>.

---

47 Neni 50 par.1 LFK

48 Neni 50 par.1 LFK



Ndërsa, të drejtat e bashkëpronarëve mbi sendet e paluajtshme, që janë objekt i bashkëpronësisë, regjistrohen në emër të secilit bashkëshort.

## **5. ADMINISTRIMI DHE DISPONIMI I PASURISË SË PËRBASHKËT**

Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje (neni 49 LFK).

Disponimi i pasurisë së përbashkët përfshin edhe marrjen e masave dhe të veprimeve që kanë të bëjnë me tjetërsimin, ngarkimin dhe vërtetimin e së drejtës së pasurisë së përbashkët.

Bashkëshortët gjatë jetës bashkëshortore nuk mund të heqin dorë nga e drejta e pjesëmarrjes në administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët, por ata mund të lidhin marrëveshje kontaktuese për posedim dhe administrim, pra bashkëshortët mund të kontraktojnë që administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët, në tërësi ose pjesë të saj, të bëhet nga njëri prej bashkëshortëve (neni 51 par.1 LFK)<sup>49</sup>. “Poashtu kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim apo vetëm në disponim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të rregullta”<sup>48</sup>

## **6. PJESËTIMI I PASURISË SË PËRBASHKËT**

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetesës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj. Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij (neni 52). LFK në nenin 53 par.1 ka paraparë se bashkëshortët , në çdo kohë, mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje dhe po ashtu ka paraparë që marrëveshja duhet të bëhet me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për arritjen e marrëveshjeve të tilla. Sipas LFK-së të drejtë të kërkojnë pjesëtimin e

---

49 Neni 51 par.1 LFK

pasurisë së përbashkët kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur i vdekur dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesën e vet nuk mund ta realizojë nga pasuria e veçantë e atij bashkëshorti.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në të shumtën e rasteve bëhet me marrëveshje. Mirëpo në rastet kur janë kontestuese hiset e bashkëshortëve ose kur të drejtat dhe sendet e caktuara nuk dihet nëse bëjnë pjesë në objektin e pasurisë së përbashkët, atëherë gjykata vendos në procedurë civile (kontestimore) pranë gjykatës kompetente (komunale).

Ndërsa kur këto çështje nuk janë kontestuese midis bashkëshortëve, pjesëtimin e pasurisë gjykata e bën në procedurë jashtëkontestimore. (Nga momenti i pjesëtimit të pasurisë së përbashkët hiseja që i përket çdo bashkëshorti është pronësi e veçantë).

Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si: kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët (neni 54 par.1 i LFK).

Pjesëtimi konkret bëhet duke caktuar se cilat janë sendet që shërbejnë ekskluzivisht për përdorim personal të bashkëshortëve dhe sendet që shërbejnë për kryerjen e zëjës së profesionit. Me kërkesën e bashkëshortit nga masa pasurore do të veçohen sendet që shërbejnë ekskluzivisht për përdorim personal të bashkëshortit dhe do të dorëzohen atij për përdorim të mëtejshëm.

Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat tjera në

pasurinë e përbashkët, dhe bashkëshorti për fitimin e atij sendi dhe të drejte ka marrë pjesë me të hyrat nga pasuria e tij e veçantë (neni 55 LFK).

## **7. PASURIA E PËRBASHKËT E BASHKËSHORTËVE JASHTËMARTESOR**

Marrëdhëniet pasurore shfaqen edhe në bashkësi jashtëmartesore dhe pasuria e fituar nga puna e përbashkët e burrit dhe gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët (neni 58 i LFK).

Sipas kësaj dispozite ligjore, për administrimin, disponimin, pjesëtimin etj., të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve jashtëmartesor aplikohen të njëjtat rregulla ligjore, të cilat aplikohen edhe për pasurinë e bashkëshortëve martesorë.

## **L I T E R A T U R A**

- Ligji mbi familjen i Kosovës nr.2004/32, Janar 2006
- LMMF i Kosovës i dt.28.03.1984,
- E drejta familjare, mr.Gani Oruqi,
- E drejta familjare, Dr.Sc.Hamdi Podvorica
- Kodi i familjes i R. së Shqipërisë
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.





Nushe Kuka Mekaj

## **BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE**

### **1. KUPTIMI I BASHKËPUNIMIT DHE FORMAT E TIJ**

Nuk janë të rralla rastet kur në kryerjen e një vepre penale marrin pjesë më shumë persona. Praktika tregon se në raste të tilla ekzistojnë shumë forma të ndryshme të veprimit të përbashkët dhe shkallë e ndryshme e kontributit të pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale. Ekzistojnë bashkimet kriminale të organizuara mirë dhe me strukturë udhëheqëse që merren me kriminalitet si një lloj i veprimtarisë së përhershme, por ekzistojnë edhe forma tjera të veprimtarisë së përbashkët kriminale me shkallë më të ulët të organizimit. Këtu më së shpeshti bëhet fjalë për lidhjen momentale të më shumë personave për kryerjen e një vepre penale.

Jo vetëm teoria e të drejtës penale, por edhe ligji dhe praktika gjithmonë i kanë kushtuar kujdes të posaçëm rasteve kur në kryerjen e një vepre penale marrin pjesë më shumë persona. Kjo për arsye se në akumulimin e energjisë kriminale shihet me rrezikshmëri më të madhe shoqërore sesa në rastin kur një vepër penale është kryer nga një kryerës i vetëm.

Jo rrallë, në situatat e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale shprehet krimi i organizuar që për çdo shtet dhe për mbarë njerëzimin paraqet formën më të rrezikshme të kriminalitetit.<sup>50</sup> Trafiqet e ndryshme, terrorizmi, vrasjet me motive politike etj, janë disa nga veprat penale që zakonisht kryhen në bashkëpunim.

<sup>50</sup> I. Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005, fq.372; Petar Novoselac, Opći dio kaznenog prava, Zagreb, 2007, fq.318.-

Bashkëpunimi në të drejtën penale bashkëkohore konsiderohet si institut që rregullohet me pjesën e përgjithshme të kodit penal. Për shkak të rrezikshmërisë që paraqet bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, në Kodin tonë penal janë paraparë inkriminime të posaçme si forma më të rënda të veprave penale themelore, nëse kryerësi vepron si anëtar i grupit.

Për të ekzistuar bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale nuk mjafton vetëm pjesëmarrja e dy apo më shumë personave, por duhet të ekzistojë lidhja objektive dhe subjektive midis bashkëpunuesve. Kjo për arsye se është e mundur situata kur dy ose më shumë persona kryejnë veprën penale të vjedhjes, mirëpo veprimtaria e tyre ka qenë e pavarur. Kështu, p.sh. një e thyen xhamin e një shitore dhe, me qëllim të përvetësimit i merr disa artikuj, e në ndërkohë atypari kalon edhe personi tjetër, i cili po ashtu me qëllim të përvetësimit, i merr disa artikuj.

**Lidhja objektive** te bashkëpunimi qëndron në atë se secili bashkëpunues duhet të ndërmerr ndonjë veprim me të cilin kontribuon në kryerjen e veprës penale, me qëllim që të shkaktohet pasoja e caktuar si rezultat i përbashkët i veprimeve të bashkëpunuesve.

**Lidhja subjektive** qëndron në atë se të gjithë bashkëpunuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se veprojnë në mënyra të ndryshme me qëllim të përbashkët, me ç'rast nuk është e domosdoshme që ata të njihen mes veti.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KPRSH) bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.<sup>51</sup>

## 2. FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale janë përcaktuar në dispozitat e neneve 23, 24, 25 dhe 26 të Kodit Penal të Kosovës si bashkëkryerje, shtytje, ndihmë dhe bashkim kriminal. Këto katër forma të bashkëpunimit, për shkak të veçorive të tyre të rëndësishme, në shkencën e të drejtës penale ndahen në bashkëpunim në kuptimin e gjerë, ku bëjnë

---

51 I. Elezi etj., Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006, fq.176.

pjesë të gjitha format e bashkëpunimit: bashkëkryerja, shtytja, ndihma dhe bashkimi kriminal dhe në bashkëpunim në kuptimin e ngushtë, ku bëjnë pjesë vetëm shtytja, ndihma dhe bashkimi kriminal.<sup>52</sup>

## 2.1 Bashkëkryerja

Bashkëkryerja ekziston nëse dy apo më shumë persona kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në veprimin e kryerjes.<sup>53</sup> Sipas KPRSH bashkekzekutorë janë personat që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejtë për realizimin e veprës penale.<sup>54</sup> Për shembull, dy apo më shumë persona shtien me armë në drejtim të personit tjetër dhe i shkaktojnë vdekjen. Ndodh që të jetë i vështirë dallimi midis bashkëkryerjes dhe formave tjera të bashkëpunimit, prandaj është me rëndësi të bëhet dallimi i saktë midis tyre. Për ta bërë dallimin midis bashkëkryerjes, si formë më e rëndë dhe formave tjera të bashkëpunimit, ekzistojnë tri teori: **Teoria formale-objektive; teoria subjektive dhe teoria e ndarjes së veprimit (rolit).**

**Teoria formale-objektive** si bashkëkryerës e konsideron personin që ka ndërmarr veprimin e kryerjes apo një pjesë të veprimit të kryerjes. Pra, kjo teori i merr për bazë vetëm elementet objektive të veprës penale dhe si bashkëkryerës e konsideron vetëm personin që ka ndërmarrë veprimin e kryerjes, duke mos i marrë parasysh mënyrat tjera të kontributit në kryerjen e veprës penale, siç kishte me qenë shefi i bandës kriminale i cili në vendin e ngjarjes udhëheq operacionin e plaçkitjes së bankës.

**Teoria subjektive** si bashkëkryerës e konsideron të gjithë pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale. Kjo teori përfaqëson konceptin ekstensiv të nocionit të kryerësit, sipas të cilit edhe shtytësi edhe ndihmësi konsiderohen kryerës (bashkëkryerës) të veprës penale, me dallim se kanë trajtim të posaçëm me rastin e ndëshkimit. Sipas teorisë subjektive bashkëkryerës konsiderohet çdo person që e ka dëshiruar pasojën dhe veprën e ka konsideruar si të vetën apo që **vepron cum animo auctoris**. Teoria subjektive nuk e merr parasysh në masë të mjaftueshme kontributin objektiv, duke e minimizuar efektin e këtij kontributi.

---

52 Po aty, fq.374.-

53 Po aty, fq.375.-

54 I.Elezi etj., vep.cit. fq.182.-

**Teoria e ndarjes së veprimeve (rolit)** si bashkëkryerës e konsideron personin i cili së bashku me tjetrin, në bazë të marrëveshjes për ndarjen e veprimeve, realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale, me ç'rast veprën e dëshiron si të vetën dhe si të përbashkët. Kjo teori e bën bashkëkryerës cilindo pjesëmarrës që veprimin e ka ndërmarrë në suaza të marrëveshjes paraprake me personat tjerë dhe nëse e ka dëshiruar kryerjen e asaj vepre penale. Të themi se praktika jonë gjyqësore kryesisht e ka përvetësuar teorinë e ndarjes së roleve.

Në teorinë bashkëkohore të së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore, është përvetësuar teoria objektivo-subjektive apo sinteza e këtyre dy teorive për përcaktimin e nocionit të bashkëkryerësit dhe formave tjera të bashkëpunimit. Kjo për arsye se veprimi në esencën tij është një tërësi e pandashme e elementeve objektive dhe subjektive.

Në kuadër të bashkëkryerjes duhet dalluar bashkëkryerjen e domosdoshme. Në rastet kur vepra penale mund të kryhet nga një person, por në kryerjen e saj marrin pjesë dy apo më shumë persona, bëhet fjalë për bashkëkryerje fakultative. Mirëpo, janë disa vepra penale të cilat për shkak të natyrës së tyre mund të kryhen vetëm nëse në veprimin e kryerjes marrin pjesë më shumë persona. Kjo formë e bashkëkryerjes njihet si bashkëkryerje e domosdoshme. Nga bashkëkryerja e domosdoshme duhet dalluar bashkëkryerjen fiktive, e cila ekziston kur dy apo më shumë persona marrin pjesë në kryerjen e veprës penale por që nuk kanë vepruar me vetëdije e as që e kanë dëshiruar apo pranuar pasojën. Veprat penale të kryera në bashkëkryerje të domosdoshme klasifikohen në veprat penale konvergjente dhe veprat penale divergjente. Veprat penale konvergjente ekziston kur bashkëkryerësit kanë qëllim të përbashkët, ndërkaq vepra penale divergjente ekziston kur bashkëkryerja është e domosdoshme, por bashkëkryerësit nuk kanë qëllim të përbashkët, apo kanë interesa të kundërta. Të tilla janë bashkëkryerja sukcesive, bashkëkryerja të veprat penale të përbëra dhe bashkëkryerja të veprat penale me mosveprim.

Sipas nenit 23 të KPK, secili bashkëkryerës ndëshkohet me dënimin e parashikuar për veprën penale të kryer dhe brenda kufijve të dashjes apo pakujdesisë, që nënkupton se bashkëkryerësi nuk përgjigjet për veprën penale ekscesive.



## 2.2 Shtytja

Shtytja është njëra nga format e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë.

Në teori dhe në praktikë shtytja përkufizohet ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat të personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer veprë penale.<sup>55</sup> Sipas KPRSH shtytës konsiderohet personi që nxit bashkëpunëtorët tjerë për kryerjen e veprës penale.<sup>56</sup> Shtytja është ndikim psikik në kryerësin kryesor në marrjen e vendimit për kryerjen e veprës penale.

Rrjedhimisht del se për të ekzistuar shtytja, është e nevojshme që kryerësi të mos ketë pasur ndërmend të kryej veprën penale, ose të mos e ketë marrë vendimin për kryerjen e veprës penale, por shtytësi me veprimet e veta ndikon në forcimin e vendimit që ai të kryej veprën penale.

Shtytja mund të kryhet vetëm me dashje, që do të thotë se shtytësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me veprimin e tij e shtytë tjetrin në kryerjen e veprës së caktuar penale. Shtytja mund të bëhet edhe nga pakujdesia, por kjo formë e shtytjes nuk është e ndëshkueshme.

Sipas nenit 24 të KPK shtytësi dënohet për çdo lloj veprë penale sikur ta kishte kryer vet, me kusht që ajo veprë penale të jetë kryer nën ndikimin e tij.

Shtytja është paraparë edhe si veprë penale e posaçme në pjesën e posaçme të KPK, siç është rasti me nxitjen e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit nacional, racor, fetar ose etnik (neni 115), pastaj shtytja për luftë agresive (neni 130) etj.

Shtytja e pasuksesshme ekziston atëherë kur personi i shtytur ka hequr dorë nga kryerja e veprës penale për të cilën është shtytur, ka qenë i penguar nga rrethanat objektive për ta kryer veprën penale për të cilën është shtytur, kur personi i shtytur i ka ndërmarrë vetëm veprimet përgatitore për kryerjen e veprës penale, e ato veprime përgatitore nuk janë të ndëshkueshme, kur personi i shtytur e ka pas vendimin për të kryer veprën penale edhe pa

---

<sup>55</sup> Po aty, fq.389.- P.Novoselac, vep.cit. fq.346.-

<sup>56</sup> I. Elezi, I Elezi etj. vep. cit. fq.183.-

ndikimin e shtytësit, si dhe kur personi i shtytur kryen krejtësisht veprën tjetër nga ajo për të cilën ka qenë i shtytur.

### 2.3 Ndhima

Ndhima është forma e dytë e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë.

Ndhima është ndërmarrje e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryej veprën penale.<sup>57</sup> Sipas KPRSH ndihmës konsiderohet personi që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimeve për fshehjen e veprës, kryerësit, gjurmëve apo sendeve që rrjedhin nga vepra penale, do ta ndihmojë kryerësin.<sup>58</sup> Për dallim nga shtytja, ndihma mund të ekzistojë vetëm pasi personi tjetër ka vendosur të kryej veprën penale, në të kundërtën veprimet do të konsiderohen si shtytje.

Ndhima mund të kryhet në mënyrë fizike dhe psikike. Si ndihmë fizike mund të konsiderohet vënia apo dhënia në diskonim kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale apo mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale, kurse si ndihmë psikike konsiderohet dhënia e këshillave apo udhëzimeve si të kryhet vepra penale dhe premtimi se do ta fsheh veprën penale, kryerësin apo gjurmët e veprës penale.

Ndhima e pasuksesshme ekziston atëherë kur personi që i është dhënë ndihma nuk e ka kryer veprën penale ose nuk ka tentuar ta kryej, apo nuk i ka ndërmarrë veprimet përgatitore të cilat janë të ndëshkueshme. Ndhima e pasuksesshme do të ekzistojë edhe atëherë kur kryerësi nuk e ka shfrytëzuar ndihmën e tjetrit për kryerjen e veprës penale, por e ka kryer veprën pavarësisht nga veprimet e ndihmësit. Ndhima e pasuksesshme nuk ndëshkohet, ngase nuk paraqet kontribut kauzal në kryerjen e veprës penale. Mirëpo, ndihma e pasuksesshme mund të inkriminohet si veprën penale e posaçme, siç është rasti të vepra penale e ndihmës për vetëvrasje (neni 151 i KPK), ndihma gruas shtatzënë që ta ndërpres shtatzëninë (neni 152 i KPK), dhënia e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale (neni 305 i KPK) etj.

---

57 Po aty, fq.396;

58 I. Elezi, vep.cit. fq.185

## 2.4 Bashkimi kriminal

Bashkimi kriminal është forma e katërt dhe më e rëndë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale në kuptimin e ngushtë.<sup>59</sup>

Bashkimi kriminal si formë e bashkëpunimit dallohet shumë nga format tjera të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale. Në kodin penal të Kosovës me bashkim kriminal kuptohet organizata kriminale apo grupi personave që janë marrë vesh për të kryer veprë penale. Çështja e rrjeteve kriminale është aktualizuar veçmas pas Luftës së Dytë Botërore.

Kodi penal i Kosovës, nën ndikimin e modeleve të kodeve penale të disa shteteve të Evropës Perëndimore dhe konceptit anglo-amerikan, e ka futur bashkimin kriminal në pjesën e përgjithshme (neni 26). Sipas paragrafit 1 të këtij neni, personat hyjnë në zonën kriminale nëse janë marrë vesh për të kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me të paktën pesë vjet burgim dhe nëse kanë ndërmarrë veprimet përgatitore për realizimin e marrëveshjes. Tentativa për marrëveshje nuk ndëshkohet.

Bashkimi kriminal, sipas Kodit penal të Kosovës ekziston edhe si veprë penale e posaçme, siç është organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupe terroriste, organizimi i grupit për kryerjen e veprës penale të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, organizimi i personave apo pjesëmarrja në trafikimin e njerëzve, prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve etj.

## 3. PËRFUNDIMI

Vepra penale mund të kryhet nga një apo më shumë persona. Nëse vepra penale kryhet nga dy apo më shumë persona, përbën rrezikshmëri më të lartë shoqërore. Kur vepra penale kryhet nga dy apo më shumë persona, para së drejtës penale dhe praktikës gjyqësore shtrohet problemi i përcaktimit të rolit dhe kontributit të secilit bashkëpunues në kryerjen e veprës penale.

---


<sup>59</sup> I. Salihu, vep. cit, fq. 401.-

Për të ekzistuar bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale duhet të shprehet lidhja objektive dhe subjektive.

Ekziston bashkëpunimi në kuptimin e gjerë, ku numërohen bashkëkryerja, shtyrja, ndihma dhe bashkimi kriminal, si dhe bashkëpunimi në kuptimin e ngushtë, ku numërohen shtytja, ndihma dhe bashkimi kriminal.

#### **LITERATURA:**

- I. Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005,
- Petar Novoselac, Opći dio kaznenog prava, Zagreb, 2007,
- I. Elezi etj., Komentari i Kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006.



Qazim Xharra



Sanije Seferi

## MATJA E DËNIMIT, ZBATIMI DHE QËLLIMI I TIJ

### 1. MATJA E DËNIMIT

Me **matjen e dënimit** kuptojmë **caktimin e llojit dhe lartësisë** së dënimit për kryerësin e veprës penale, në mënyrë që ti caktohet ai lloj dhe masë e dënimit i cili do ti përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryesit dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi i dënimit.

Kodi Penal i Kosovës për çdo vepër penale të veçantë parashikon lartësinë e dënimit, pra kufirin me të lartë dhe më të ulët të llojit të dënimit që mund të jepet ndaj kryerësit të veprës penale. Për përcaktimin e lartësisë së dënimit ligjvënësi nisët nga rrezikshmëria shoqërore që paraqet vepra penale konkrete, për të parandaluar kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Neni 64 i KPK-së i njeh të drejtën gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese), sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, pranimin e fajësisë, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale.

Ligjvënësi përveç dënimit me burg e dënimit me burgim afatgjatë, ka parashikuar edhe mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë, në këtë rrastë gjykata për shqiptimin e këtij lloji të dënimit duhet të merr parasysh gjendjen pasurore të kryerësit dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale dhe të ardhurat tjera të tij, pasurinë dhe detyrimet e tij.

Kodi penal për vepra penale të njëjta parashikon edhe dënime alternative, midis të cilave gjykata ka mundësi të zgjedhjes për ti zbatuar ndaj një personi të caktuar, por për të cilat paraprakisht duhet të plotësohen kushtet ligjore të parashikuara me ligj. Gjithashtu kodi i njeh të drejtën gjykatës që ndaj kryerësve të veprave penale të caktoj edhe dënimet plotësuese. Për caktimin e dënimit karakteristike janë dobishmëria shoqërore e dënimit dhe individualizimi<sup>60</sup> i tij.

*Dobishmëria shoqërore e dënimit* ka të bëjë me efektin e dënimit në rastin konkret, nëse lloji i dënimit të dhënë është më i përshtatshmi për rastin konkret. Dobishmëria kërkon individualizim të drejtë të dënimit që gjykata do të caktojë për të pandehurin, me anën e të cilit<sup>61</sup> arrihen qëllimet e dënimit. Dënimi i përshtatshëm jo vetëm që parandalon veprimtarinë e mëtejshme kriminale të kryerësit të veprës penale, por i shtrin efektet edhe më gjerë në pjesët e tjera të shoqërisë, çka do të thotë se i përmban personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

*Individualizimi i dënimit* është zbatimi i dënimit në bazë të dispozitave që parashikohen për veprën penale, brenda kufijve të parashikuara në ligj dhe në përshtatje me karakterin dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit-kryerësit të saj, shkallën e fajësisë duke pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat në mënyrë më efektive do të ndikonin në riedukimin e kryerësit të veprës penale, çka do të thotë përshtatja e dënimit veprës penale dhe kryerësit të saj. Kërkesë themelore për individualizimin e dënimit është respektimi i parimit të ligjshmërisë, që do të thotë se gjykata ka detyrim që në caktimin e dënimit të ketë parasysh dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe pjesës së posaçme të KPK-së, duke u bazuar në parimin nullum crimen sine lege që do të thotë se një vepër nuk mund të konsiderohet vepër penale nëse më parë nuk është paraparë

60 Kodi penal i Kosovës neni 64

61 E drejta Penale-pjesa e përgjithshme, Dr. Ismet Salihu faqe 502

me ligj, si dhe në sintagmën nulla poena sine lege që do të thotë se nuk mund të shqiptohet dënimi nëse më parë nuk është paraparë me ligj.

Në nenin 65 të KP-së në paragrafin 1 thuhet shprehimisht se kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me kod që do të thotë se sipas këtij paragrafi parimi i ligjshmërisë nulla poena sine lege konsiston edhe në ndalesën e shqiptimit të dënimit më të butë apo më të rëndë, përpos nëse kjo mundësi parashihet me kodin penal.

Gjithashtu parimi i ligjshmërisë së shqiptimit të dënimit respektivisht caktimit të lartësisë së dënimit për shkak të specifikave të veta është rregulluar në mënyrë të posaçme sa i përket ndihmës në kryerjen e veprës penale, bashkimit kriminal, tentativës, për të cilat dënimi i shqiptuar nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për atë vepër penale.

Është e domosdoshme që për caktimin e dënimit nga gjykata të ekzistojë vepra penale. Pra që në veprimet e kryera nga personi të ekzistojnë elementet e figurës së veprës penale, që do të thotë caktimi i dënimit ndaj një personi në veprën e të cilit nuk përbëhen elementet objektive dhe subjektive që sipas ligjit formojnë figurën e veprës penale të caktuar është shkelje e ligjit dhe njëherit edhe shkelje e të drejtave të personit të akuzuar të cilat të drejta<sup>62</sup> janë të garantuara edhe me Konventat Evropiane.

Gjykata për caktimin e dënimit duhet të ketë parasysh kundërligjshmërinë e veprës konkrete po ashtu edhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës. Pra vepra për të qenë e dënueshme duhet të formohen apo ekzistojnë elementet e një figure të veprës penale të përcaktuara me ligj mirëpo kemi raste kur ekzistojnë elementet e figurës së veprës penale të përcaktuar me ligj, por për shkak të rëndësisë së vogël të saj, rrezikshmëria e saj nuk është e rëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës, mungesës së pasojave të dëmshme të parëndësishme, rrethanave në të cilat është kryer vepra, shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryerësit të veprës penale ose

---

62 Po aty faqe 503

për shkak të rrethanave personale të kryerësit, në rastin konkret edhe pse përmbajnë tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj, një vepër e tillë nuk është vepër penale.

Ka edhe raste kur personat që kryejnë vepra penale, në kushtet e parapara me ligj, e konkretisht veprimet e personave të cilët kryejnë vepra penale nga dispozitat ligjore sikurse rastet e mbrojtjes së nevojshme - neni 8, nevoja ekstreme - neni 9, personat e papërgjegjshëm<sup>63</sup> neni 11, do të konsiderohen se nuk kanë kryer vepër penale gjegjësisht veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale.

Në individualizimin e dënimit rëndësi ka parandalimi i posaçëm dhe parandalimi i përgjithshëm si qëllim i dënimit. Masa e dënimit e caktuar nga gjykata duhet të ketë aftësinë të rehabilitoj<sup>64</sup> dhe të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në të njëjtën kohë për të ndikuar edhe ndaj personave të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Përparësi në individualizimin e dënimit ka rrezikshmëria shoqërore e veprës e cila përcaktohet nga objekti, e që ka të bëjë me marrëdhëniet shoqërore të prekura prej saj, si dhe shkalla e asaj rrezikshmërie shoqërore e veprës penale konkrete. Çmuarja e këtyre rrethanave të ndodhura, gjatë ose pas kryerjes së veprës penale, mund të tregojnë një rrezikshmëri më të madhe ose më të vogël të sajë. Për të çmuar shkallën rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale konkrete duhen marrë parasysh edhe pasojat e veprës shoqërisht të rrezikshme. Dëmi i shkaktuar nga vepra penale ndikon mbi shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe si rrjedhim edhe në masën e dënimit.

Në veprat penale formale ku pasoja nuk është e nevojshme për ta quajtur veprën penale të kryer, merret parasysh rëndësia e dëmit të ardhur, përpjesëtimet e dëmit që mund të vinin si dhe mundësia më e madhe ose më e vogël e ardhjes së pasojave. Për përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës p.sh. kur vepra ka mbetur në fazën e përgatitjes dhe tentativës, ose kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, gjykata duhet të marrë në konsideratë shkallën e përgatitjes së veprës, afërsinë e ardhjes së pasojave dhe shkaqet

63 Kodi Penal i Kosovës neni 65

64 E drejta Penale-pjesa e përgjithshme, Dr. Ismet Salihu - faqe 503



për të cilat vepra nuk u krye. Sa më e madhe shkalla e përgatitjes aq më e madhe edhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe personit.

Tek bashkëpunimi duhet parë roli i secilit në veprën penale. Bashkëpunimi i dy ose më shumë personave mund të paraqitet si element i domosdoshëm, si element cilësues ose si rrethanë rënduese. Kemi elemente cilësues të veprës penale, për veprat për të cilat elementi i bashkëpunimit parashikohet shprehimisht në dispozitën përkatëse. Nëse elementi bashkëpunim do të shprehet në vetë dispozitën në këtë rast do kemi të bëjmë me rrethanë cilësuese – formë e kualifikuar p.sh neni 193 par.3 nën par 5, neni 195 par.3 nënpar. 5 të KPK-së etj.

Ndërsa do ta kemi si rrethanë rënduese kur ky element bashkëpunimi nuk përmendet në dispozitën përkatëse, por nëse vepra është kryer në bashkëpunim, personi do të cilësohet sipas veprës konkrete në lidhje me nenin 23 të KP-së- si bashkëkryerës.

Shtytësi ka përgjegjësi penale njësoj si kryerësi i veprës penale, të cilit mund ti shqiptohet dënim sikurse ai vetë të kishte kryer vepër penale, edhe ndihmësi ka përgjegjësi penale mirëpo kryerësve të tillë të veprave penale u shqiptohet dënim më i butë, gjegjësisht sipas KP-së nuk mund të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale.

Siç e dimë qëllim i dënimit është edhe parandalimi i personit që ka kryer një vepër penale nga kryerja e mëtejshme e veprave tjera penale. Për këtë është e rëndësishme që dënimi ti përshtatet personalitetit të fajtorit. Vepra penale konkrete e kryer nga fajtori nxjerr në pah në një farë mënyre rrezikshmërinë shoqërore të tij, por gjykata duhet të marrë parasysh edhe rrethana tjera që mund të jenë si mosha e të pandehurit, zhvillimi i tij mendor, intelektual e arsimor, gatishmëria për të mënjanuar-ndrequr pasojat, shkalla e pendesës që tregon për veprën e kryer,etj.

Vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale, motivi, mënyra, objekti apo vlera juridike ndaj të cilit është drejtuar veprimi i kryerjes influencojnë gjithashtu në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të krimit - veprës. Rrethi, zona ose qendra e veçantë ku është kryer vepra penale po ashtu kanë rëndësi

për rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Gjendja e kriminalitetit në një rreth ose një zonë të caktuar, përhapja më e madhe ose më e vogël e një kategorie veprash penale, si dhe koha, gjendje lufte, gjendje e jashtëzakonshme etj., tregojnë për shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

Gjykata deri në dhënien e vendimit për caktimin e dënimit duhet të marrë parasysh edhe qëndrimin e kryerësit të veprës penale, veprimet e tija për të riparuar pasojat, zhvillimin mendor dhe intelektual të tij etj.

Në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duhet të ketë parasysh edhe anën subjektive, faji, motivet, qëllimet. Gjithashtu gjykata ka parasysh edhe mënyrën se si reagon personi ndaj dënimit, ose ndikimin që mund të ketë dënimi mbi te. Moshë, profesioni, qenia përsëritës-recidivist bëjnë që personi i dënuar ta ndiejë më pak ose më shumë dënimin që i jepet nga gjykata.

### **1.1. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese**

Këto rrethana janë faktorë të ndryshëm objektiv dhe subjektiv, që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të lartë ose më të ulët të veprës dhe të kryerësit të cilat ndikojnë në masën e dënimit.

Rrethanat rënduese dëshmojnë për një shkallë më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer ose të kryerësit, ndërsa rrethanat lehtësuese dëshmojnë për një shkallë rrezikshmërie shoqërore më të ulët të krimit, veprës penale dhe të kryerësit. Këto rrethana ndikojnë në caktimin e lartësisë së dënimit si për dënim më të rëndë ashtu edhe për dënim më të lehtë ndaj kryerësit të veprës penale. Në përgjithësi për çdo rast konkret sikurse rrethanat rënduese po ashtu dhe ato lehtësuese gjykata duhet ti çmojë në tërësi, të përcaktojë rëndësinë dhe influencën e tyre në rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryerësit dhe pastaj të caktojë përfundimisht llojin dhe lartësinë e dënimit.

Ligjvënësi përveç rrethanave lehtësuese të parapara në nenin 64 të KP-së, gjykatës i lejon mundësinë që të marrë në konsideratë edhe rrethana tjera veçanërisht lehtësuese duke ndikuar kështu në zbutjen e masës së dënimit, e që janë moshë, gjendja shëndetësore, fatkeqësitë familjare, etj, që tregojnë

për një rrezikshmëri më të ulët të veprës dhe të kryerësit, të cilat edhe gjykata duhet ti ketë parasysh me rastin e caktimit të masës së dënimit ndaj kryerësit të veprës penale brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

## **1.2 Shkalla e përgjegjësisë penale**

Është rrethanë e cila varet nga shkalla e dy komponentëve kryesorë, një nga shkalla e përgjegjshmërisë, dhe dy nga shkalla e fajësisë. Përgjegjshmëria si gjendje psikike nënkupton shkallë të ndryshme të aftësisë intelektuale, e cila mund të jetë e plotë, me aftësi të zvogëluar mendore dhe me paaftësi mendore, të cilat rrethana tregojnë se kryerësi i veprës penale ka qenë plotësisht apo pjesërisht i përgjegjshëm, se a e ka kryer veprën penale me dashje direkte apo eventuale, nga pakujdesia me vetëdije apo pavetëdije.

Aftësia e zvogëluar gjithashtu e zvogëlon edhe shkallën e përgjegjësisë penale, të cilën edhe gjykata do ta merë si rrethanë lehtësuese me kusht që kryerësi të mos ketë sjellë veten vetë në atë gjendje.

## **1.3 Karakteristikat personale të kryerësit**

Janë rrethana që ndikojnë në përcaktimin e gjykatës se a do të shqiptojë dënim, e këto janë gjendja shëndetësore e kryerësit, gjendja statusore-familjare, mosha dhe gjendja shëndetësore, punësimi, profesioni etj.

## **1.4 Motivet nga të cilat është kryer vepra penale**

Janë shkaqet psikike të cilat e kanë shtytur personin të kryej vepër penale, ato në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë kryerjen e veprës penale, ato në të vërtetë në një mënyrë tregojnë arsyet e kryerjes së veprës dhe për këtë kanë karakter të veçantë me rastin e matjes së dënimit.

Motivet janë kategori etike dhe për nga karakteri i tyre mund të jenë pozitive dhe negative, gjegjësisht egoiste dhe altruiste dhe në këtë kuptim mund të merren si rrethana lehtësuese ose rënduese. Nëse një vepër është kryer nga motivet egoiste, zilisë, urrejtjes, shpirtligësisë ose hakmarrjes, fitimi i dobisë pasurore, urrejtja racore dhe fetare atëherë këto motive paraqesin rrethana rënduese, nëse në ligj nuk përmenden si elemente të figurës penale

përkatëse, si p.sh. Vrasja e rëndë neni 147 i KPK-së, ndërsa dhembshuria, dashuria, nderi ose ndjenja e obligimit etj, nëse p.sh. vepra kryhet për të ushqyer familjen, atëherë ato mund të merren si rrethana lehtësuese.

Kryerja e veprës penale kundër personave që për shkak të gjendjes së tyre, moshës së vjetër, çrregullimit fizik a mendorë, paaftësisë ose shtatzënisë nuk mund të mbrohen nga veprimet kriminale dëshmojnë për një rrezikshmëri të madhe të kryesit të veprës penale. Për zbatimin e kësaj rrethane rënduese duhet që autori i veprës penale të ketë pasur dijeni për gjendjen e posaçme të viktimës.

Në dispozitat e pjesës së posaçme kjo rrethanë parashikohet si element i veçante i veprës penale p.sh neni 193 - dhunimi, neni 195 - sulm seksual etj. Në këtë rast personi do të dënohet me atë lartësi dënimi që e parashikon dispozita konkrete dhe nuk do të merret parasysh kjo rrethanë rënduese.

### **1.5 Intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur**

Është rrethanë objektive nga e cila varet ajo se sa kjo e mirë është dëmtuar ose kërcënohet për dëmtim, gjithmonë duke pasur parasysh në natyrën e veprës, se për çka është fjala, për veprat kundër pasurisë, jetës dhe trupit, veprave kundër sigurisë së trafikut publik, tentativës apo veprës së kryer penale, për çka edhe me këtë rast duhet vlerësuar mënyrën dhe mjetet e kryerjes së veprës penale, ku më së shumti duhet dhënë rëndësi dëmit të shkaktuar me vepër penale.

### **1.6 Rrethanat në të cilat është kryer vepra**

Janë rrethana të cilat mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive të cilat i referohen veprës penale dhe kryerësit të sajë si janë koha, mjetet, mënyra dhe vendi i kryerjes së veprës penale, raportet mes kryerësit dhe viktimës si dhe gjendjes psikike mes tyre.

### **1.7 Sjellja e mëparshme e kryerësit**

Janë rrethana të rëndësishme për çmuarjen e personalitetit të kryerësit dhe rrezikshmërisë shoqërore të tij, sjelljet e tija në harmoni me normat pozitive

para kryerjes së veprës penale, a ka pasur sjellje korrekte në rrethin dhe ambientin ku jeton, recidivizmi, sjelljet jo të mira në rrethin ku jeton, bredhja, bixhozi etj, për të cilat rrethana gjykata në bazë të vlerësimit të sajë duhet të vijë deri te kuptimi se vepra e kryer a është pasojë e sjelljeve jo të rregullta të kryerësit apo si pasojë e rrethanave të padëshiruara të rastësishme të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprës, e të cilat do të merren si rrethana lehtësuese apo rënduese.

### **1.8 Pranimi i fajit**

Me këtë kryerësi i veprës penale tregon se është penduar dhe se premtion se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale që do të konsiderohen si rrethanë lehtësuese, ndërsa mos pranimi i fajit tregon se kryerësi nuk e ka kuptuar apo nuk dëshiron të kuptoj se ka kryer veprë të dëmshme e cila me ligj është e paraparë si veprë penale dhe njëherit jep indikacione se ai mund të përsërisë veprën e njëjtë apo edhe të kryejë vepra tjera penale, rrethanë e cila nga gjykata do të merret si rrethanë rënduese.

### **1.9 Rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljet e tija pas kryerjes së veprës penale**

Janë rrethana të cilat tregojnë qëndrimin e kryerësit ndaj veprës së kryer si dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës e po ashtu edhe pas kalimit të një kohe, qëndrimi i tij ndaj të dëmtuarit si dhe dëmit të shkaktuar, (dhënia e ndihmës të dëmtuarit dhe familjes së tij, riparimi apo kompensimi i dëmit të shkaktuar), si dhe qëndrimi i tij gjatë procedurës penale, e prej të cilave varet caktimi i lartësisë dhe llojit të dënimit.

### **1.10 Kryerja e veprës penale në bashkëpunim**

Ligji në këto raste bën fjalë për veprat penale që kryhen nga dy ose më shumë persona në marrëveshje mes tyre. Kjo konsiderohet si rrethanë rënduese për arsye se bashkëpunim i shumë personave në kryerjen e veprës penale lehtëson kryerjen e saj. Kjo rrethanë nuk mund të merret si rënduese në caktimin e lartësisë së dënimit kur kryerja e veprave në bashkëpunim është element kualifikues sipas dispozitës konkrete, p.sh neni 274 i KP-së Krimi i organizuar, që janë forma të posaçme të bashkëpunimit.

### **1.11 Paraqitja vullnetare në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale**

Kjo rrethanë lehtësuese aplikohet kur kryerësi i veprës penale kallëzon veprën penale para se të jetë zbuluar autori i kryerjes së tij. Përveç kësaj personi duhet të tregohet i sinqertë në shpjegimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale. Pranimi i kryerjes së veprës penale pas zbulimit të tij ose pasi është thirrur nga organet kompetente nuk e justifikon zbatimin e kësaj rrethane.

### **1.12 Kur kryerësi i veprës penale tregon pendim të thellë**

Kjo ka të bëjë me sjelljen e personit pas kryerjes së veprës penale, që do të thotë jo vetëm pranimi i plotë i veprës penale, por edhe shpjegimi i rrethanave, motiveve, qëllimeve, tregimi i bashkëpunëtorëve, kërkim falja publike etj.

### **1.13 Normalizimi i marrëdhënieve**

Mes të dëmtuarit dhe kryerësit të veprës penale merret si rrethanë lehtësuese nga gjykata. Pra kur janë pajtuar me njeri tjetrin dhe mes tyre janë vendosur marrëdhënie normale.

**Kodi Penal i Kosovës** parasheh rrethana lehtësuese edhe për rastet kur kemi të bëjmë me vepra penale të kryera nga **paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore** të cilat vepra edhe janë të cilësuar si të tilla.

**Kur personi e kryen veprën penale sipas një urdhri të eprorit të tij** - do të merret parasysh nga gjykata për caktimin e masës së dënimit neni 10 nënpar.1,2 e 3 të KP-së, pra në këto raste gjykata duhet të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese.

Karakteristikë e Kodit Penal të Kosovës është se parasheh edhe rastet e rënda të veprës penale e ato janë atëherë kur ato kryhen nga personat zyrtarë si dhe rastet kur kemi të bëjmë me rastet kur vepra penale është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të cilat janë edhe elemente kualifikues të veprës penale.

### **1.14 Rrethanat tjera të cilat kanë të bëjnë me karakterin e kryerësit të veprës penale**

Sipas kësaj kategorie të rrethanave ligji e obligon gjykatën që me rastin e matjes së dënimit të merr në dijeni dhe të vlerësoj edhe të gjitha rrethanat tjera të cilat kanë të bëjnë me karakterin e kryerësit të veprës, të cilat natyrisht nuk mund të ndërlidhen me rrethanat e lartcekura. Me këtë ligji në të vërtetë veçanërisht thekson rëndësinë e rrethanave subjektive, megjithatë nuk duhet të anashkalohej mundësia që ato mund të jenë edhe ndonjë nga rrethanat tjera për të cilat gjykata mendon se janë të rëndësishme me rastin e matjes së dënimit. Në të vërtetë në bazë të kësaj edhe ranglista e këtyre rrethanave bëhet mjaft e gjerë, gjë që varet nga secili rast konkret në vete, p.sh. gjykatat tona shpesh si rrethanë rënduese marrin faktin se disa vepra penale janë në rritje e sipër siç janë veprat penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, kontrabandimi me migrantë, trafikimi me njerëz, blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, ose si rrethanë lehtësuese marrin faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, me një përjashtim se nëse për këtë vet kryerësi të mos ketë kontribuar, atëherë kjo nuk mund të merret si rrethanë lehtësuese.

### **1.15 Rregullat e përgjithshme të matjes së dënimit**

Ligji para së gjithash parasheh rrethanat më të rëndësishme të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh me rastin e matjes së dënimit, ku parasë gjithash asnjë rrethanë nuk theksohet si rrethanë lehtësuese apo rënduese. Sipas karakterit të tyre ato janë të karakterit ambivalent, pasi që secila prej tyre duke pasur parasysh se si janë krijuar në rrethana konkrete të caktuara, mund të kenë karakter të rrethanave lehtësues apo rënduese. Pra nuk mund të ndikojnë në atë që dënimi të jetë më i lartë apo më i ultë, por në kufijtë e dënimit të paraparë për veprë penale të kryer. Në bazë të kësaj duhet të bëjmë dallimin nga rrethanat kualifikuese dhe ato privilegjuese, të cilat edhe e ndryshojnë kualifikimin e veprës penale në më të rëndë apo më të lehtë, e me këtë edhe masën e dënimit.

Cilat rrethana një veprë e cilësojnë si të kualifikuar dhe të privilegjuar e përcakton vet ligji, për çka te disa vepra penale e njëjta rrethanë mund të

jetë si rrethanë kualifikuese, anë tjetrën rënduese ose te njëra e privilegjuar a tek tjetra vetëm lehtësuese.

## **2. ZBUTJA E DËNIMIT**

Përveç rrethanave lehtësuese që janë faktorë që e ndihmojnë gjykatën për të kuptuar rrezikshmërinë shoqërore të ulët të personit, kryerësit të veprës penale dhe për caktimin e një<sup>65</sup> dënimi më të butë KP i Kosovës njeh edhe uljen- zbutjen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Neni 66 i KP-së i njeh të drejtën gjykatës kur e çmon se vepra penale dhe kryerësi i saj kanë rrezikshmëri shoqërore të ulët dhe ekzistojnë disa rrethana posaçërisht lehtësuese, ka të drejtë të caktoj një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse për atë vepër penale. Gjykata kur shikon ekzistencën e disa rrethanave lehtësuese mundet që në vend të dënimit me burgim efektiv të shqiptojë dënim me kusht, në rastet kur zbatohen dispozitat e zbutjes për veprat penale për të cilat është paraparë dënim deri në dhjetë vjet. Përveç kësaj gjykata kur shikon ekzistencën e disa rrethanave lehtësuese mund të bëjë edhe zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë, por vetëm nëse ekzistojnë disa rrethana veçanërisht lehtësuese.

### **2.1 Lirimi nga dënimi**

Gjykata përveç zbutjes së dënimit pa marr parasysh kufizimet e parapara për zbutjen e dënimit, mund edhe ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale, mirëpo vetëm në rastet kur shprehimisht parashihet me ligj, e të cilat janë të parapara me nenin 68 i KP-së, në këto raste gjykata konstaton se është kryer vepra penale dhe kryesi i sajë është penalisht i përgjegjshëm, por shqiptimi i dënimit nuk do të ishte i arsyeshëm për shkak të intensitetit të vogël të veprës apo për shkaqe kriminalo-politike. Në rastet e këtilla gjykata është e autorizuar me ligj që kryesin e tillë ta shpallë fajtorë për veprën penale të kryer, por njëherit edhe mund ta lirojë nga dënimi sipas bindjes së vet të lirë.

---

65 Kodi Penal i Bosnje dhe Hercegovinës faqe 272



Në Kodin Penal të Kosovës njihen dy grupe të rasteve kur kryerësi mund të lirohet nga dënimi dhe atë të parapara sipas dispozitave të pjesës së përgjithshme dhe posaçme të kodit penal.

Sipas dispozitave të pjesës së përgjithshme mundësia e lirimit është paraparë për veprat penale si p.sh tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, tejkalimi i kufijve të nevojës ekstreme në rastet e tentativës së papërshtatshme, në rastet e heqjes dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, heqjes dorë vullnetarisht nga bashkimi kriminal, në rastet e lajthimit juridik etj.

Ndërsa sipas dispozitave të pjesës së posaçme të kodit penal, lirimi nga dënimi është i paraparë për rastet si p.sh kur eksperti, përkthyesi, dëshmitari apo interpreti e revokon deklaratën e rreme para se të jetë nxjerrë vendimi përfundimtar, nëse personi i privuar nga liria heq dorë vullnetarisht nga rebelimi para se të ketë përdorë dhunën apo kanosjen serioze, nëse sulmuesi ndaj personit zyrtarë ka qenë i provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal.

Këto dispozita si në pjesën e përgjithshme ashtu edhe në pjesën e posaçme të kodit penal kanë karakter fakultativ, pasi që i është lënë në kompetencë gjykatës që të vendos nëse kryerësin e veprës do ta lirojë nga dënimi apo jo.

Kemi edhe rastet e lirimit obligativ nga dënimi i cili është i paraparë për rastet e tentativës së dënueshme të veprës penale nëse personi i tillë vullnetarisht heq orë nga kryerja e veprës penale të cilën e ka filluar apo nëse pas kryerjes së veprës së tillë penale, ai parandalon shkaktimin e pasojave.

Po ashtu sipas Kodit Penal të Kosovës janë të parapara **bazat e posaçme të lirimit** nga dënimi për veprat e kryera nga pakujdesia, e të cilat janë të parapara me nenin 69 të KPK-së. Sipas kësaj dispozite kjo vjen në shprehje për ato vepra penale në të cilat për shkak të natyrës së tyre, lirimi nga dënimi mund të shfrytëzohet paraprakisht për veprat penale të rrezikimit të trafikut publik, në të cilat parasë gjithash dëmi i shkaktuar nga kryerësi, reflekton pasojat ndaj të afërmit të tij, bashkëshortit ose ndaj kushëririt të afërm.

Arsyetimi për lirim nga dënimi në raste të tilla qëndron në atë se kryerësin pasojat e shkaktuara aq rëndë e kanë goditur, e që sipas përmbajtjes së vetë edhe i tejkalojnë lëshimet e tija për të cilat edhe duhet të ishte dënuar, për çka në këtë rast arsyet e drejtësisë e po ashtu edhe arsyet gjenerale dhe ato speciale nuk kërkojnë dënueshmëri. Këtu tragjedia personale e cila është dënimi më i rëndë për kryerësin, shqiptimin e dënimit e bënë krejtësisht të parëndësishëm dhe të pavlerë.

Ligji për zbatimin e këtij rregulli lidhur me lirimin nga dënimi ka paraparë dy kushte të lidhura mes veti dhe të përcaktuara në mënyrë kumulative. I pari qëndron në atë se vepra penale duhet të jetë kryer nga pakujdesia, e dyta është që pasoja e veprës kryerësin aq rëndë ta ketë goditur me çka edhe shqiptimi i dënimit në këso raste nuk do ta kishte arsyetuar qëllimin e dënimit. Sipas këtij rregulli ligjvënësi ka paraparë lirimin nga dënimi edhe për rastet kur kryerësi pas kryerjes së veprës penale në tërësi apo pjesërisht kompenson dëmin e shkaktuar.<sup>66</sup>

Për këto raste mundësia e lirit nga dënimi është fakultative, pasi që më parë nga gjykata duhet të konstatohet nëse janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

## **2.2 Ashpërsimi i dënimit**

Gjithashtu gjykata përveç zbutjes së dënimit apo lirit nga dënimi, ajo ka autorizim ligjorë edhe të ashpërsimit të dënimit, e kjo ka të bëjë në rastet kur kemi të bëjmë me recidivizëm të shumëfishtë, neni 70 i KP-së, duke marrë parasysh faktin se dënimi i mëparshëm nuk ka ushtruar ndikim efikas në përmirësimin e kryerësit të veprës penale. Edhe në këto raste mundësia e ashpërsimit të dënimit është fakultative.

## **2.3 Alternativat e dënimit me burg**

Në KP të Kosovës ekziston një kapitull i veçantë me alternativa të cilat jepen ndaj kryesit të veprës penale. Kjo tregon edhe një herë për karakterin human të KP të Kosovës. Zakonisht këto alternativa të dënimit me burgim

---

66 Kodi Penal i Bosnje dhe Hercegovinës faqe 282-284

jepen kur nga gjykata vlerësohet se rrezikshmëria shoqërore e kryerësit dhe e veprës penale është e vogël, si edhe kur kjo gjykatë mendon se me aplikimin e masave të tilla do të arrihet më së miri qëllimi i dënimit.

Alternativat e dënimit nuk janë lloje të veçanta dënimesh por janë një mënyrë e ekzekutimit të tyre. Në këtë rast gjykata e cakton më parë masën e dënimit ndaj autorit të veprës penale dhe nëse shikon se plotësohen kushtet përkatëse ajo vendos për aplikimin e një prej alternativave të dënimit.

### 2.3.1 Gjysmëliria

Një nga masat alternative të parashikuara në nenin 53 të KP-së është edhe gjysmëliria.

Kjo alternativë dënimi aplikohet ndaj kryerësve të veprave penale vetëm në ato raste kur gjykata e ka dhenë më parë dënimin për të, i cili duhet patjetër të jetë dënim me burgim dhe të mos jetë më shumë se një vit. Në këtë rast dënimi ekzekutohet ashtu që personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata. Aplikimi i kësaj alternative të dënimit bëhet siç e thamë kur personi është dënuar deri në një vit burgim dhe vetëm për rastet kur ai ka detyrime lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo me nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësorë. Aplikimi i dënimit me burgim ndaj një personi të tillë nuk do të kishte<sup>67</sup> ndonjë efekt shumë të madh nëse nuk do ti jepej mundësia e vuajtjes në gjysmëliri. Në çdo rast gjykata do të aplikojë dënim me gjysmëliri kur ekzistojnë këto kushte, si edhe kur ajo është e bindur se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me gjysmëliri, bile mund të arrihet edhe më mirë.

Sidoqoftë KPK parashikon edhe mundësinë e revokimit të ekzekutimit të dënimit me burg në gjysmëliri për rastet kur personi që ka përfituar nga gjysmëliria nuk përmbush detyrimet e caktuara me vendimin e gjykatës. Në këtë rast personi do ta vuajë pjesën e mbetur të dënimit me burg.

<sup>67</sup> Kodi Penal i Kosovës neni 53

### 2.3.2 Dënimi me kusht

Përveç gjysmëlirisë gjykata mund të bëjë edhe kushtëzimin e ekzekutimit të dënimit të dhënë për kryerësin nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit të caktuar nga gjykata, e cila kohë nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit e as më e gjatë se pesë vite. Në këto raste të parashikuara me nenin 42 të KP kemi të bëjmë me **kushtëzimin e ekzekutimit të dënimit me burgim** për një kohë të caktuar nga gjykata, me kushtin që personi të mos kryejë një vepër penale tjetër gjatë kohës së verifikimit. Vuajtja efektive e dënimit nuk është në çdo rast e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të dënimit, dhe pikërisht mbi këtë parim mbështet edhe kjo alternative e dënimit. Në këtë rast gjykata e cakton dënimin me burgim për personin por ekzekutimi i këtij dënimi në të ardhmen varet nga qëndrimi i kryerësit gjatë kohës së verifikimit të cilën e cakton gjykata.

Kushtëzimi i ekzekutimit të dënimit jepet nga gjykata kur ajo e çmon se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe e kryerësit është e tillë sa ndaj tij nuk është i nevojshëm aplikimi i dënimit me burgim efektiv. Pra për aplikimin e dënimit me kusht duhet parë në radhë të parë rrezikshmëria shoqërore e kryerësit të veprës si dhe e veprës konkrete. Sa më pak të paraqet rrezikshmëri shoqërore vepra dhe kryerësi aq më e prirur do të jetë gjykata në aplikimin - shqiptimin e këtij lloji të dënimit alternativ. Nëse vepra nuk do të jetë me rrezikshmëri shoqërore dhe kryerësi të ketë mbajtur një qëndrim korrekt para gjykatës si dhe pendues, si dhe ajo - gjykata të ketë arritur në përfundimin se me aplikimin e kushtëzimit të ekzekutimit të dënimit do të arrihet më së miri qëllimi i dënimit, atëherë mund të aplikohet kushtëzimi - pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim efektiv.

Kushtëzimi - pezullimi i ekzekutimit të dënimit ka të bëjë me një dënim në vetvete dhe duhet të synojë të arrijë ato qëllime që ka dënimi me burg efektiv. Nëse me aplikimin e kushtëzimit të dënimit nuk arrihen qëllimet e parandalimit të posaçëm dhe të përgjithshëm të dënimit atëherë është e pavend që ky lloj dënimi të zbatohet ndaj të dënuarit.

Gjithashtu në aplikimin e dënimit me kusht duhet të merren parasysh edhe rrethanat lehtësuese të kryerjes së veprës penale, p.sh rrethanat e kryerjes

së veprës penale, qëndrimin e të dënuarit pas kryerjes së veprës, pendimin që tregon personi, vetitë e tij personale, etj.

Në çdo rast për tu shqiptuar dënimi me kusht duhet që të plotësohen disa kushte ligjore, me kusht që kryerësi të jetë ngarkuar për vepra penale të dënueshme deri në pesë vjet burgim, si dhe për vepra penale të dënueshme deri në dhjetë vjet me dënim me burg nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit.

Sipas Kodit Penal të Kosovës gjykata mund edhe ta revokon dënimin me kusht në çdo rast që i dënuari kryen një apo më shumë vepra penale tjera për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej së paku dy apo më shumë vite brenda kohës së verifikimit, po ashtu dënimi me kusht mund të revokohet edhe nëse i dënuari kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim me më pak se dy vite ose dënim me gjobë pasi të ketë vlerësuar rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmërinë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale, po ashtu edhe nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me vendim të formës së prerë konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër.

Në rastet kur vie deri te revokimi i dënimit me kusht, gjykata shqipton dënim unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, duke i konsideruar dënimet e revokuara me kusht si të përcaktuara.

Afati gjatë të cilit gjykata mund ta vërë në provë personin varion nga një vit e deri në pesë vjet dhe caktohet duke marrë parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës konkrete penale, e cila varet nga rrezikshmëria e objektit të cenuar prej saj, rrezikshmëria shoqërore e personit, e që varet nga personaliteti i tij, nga qëndrimi që mban ndaj veprës së kryer, nga shkalla e pendimit të tij, qëndrimin para gjykatës dhe nga prania e rrethanave lehtësuese. Gjatë këtij afati të verifikimit personi nuk duhet të kryejë një apo më shumë vepër penale të njëjta apo tjera.

Gjykata ka të drejtë që me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht dhe gjatë kohës së verifikimit ndaj të dënuarit të vendosë edhe detyrime të caktuara

ndaj tij, si kthimi i përfitimit pasurorë të fituar me kryerjen e veprës penale, kompensimi i dëmit të shkaktuar me vepër penale si dhe detyrime tjera të parapara me dispozitat ligjore, të cilat tregojnë se me aplikimin e këtyre masave personit i jepet mundësia e riintegritit dhe e riaftësimit si dhe mundësia për tu përfshirë edhe njëherë në shoqëri dhe për të ndikuar pozitivisht në mbarëvajtjen e saj. Në rast se personi ndaj të cilit janë aplikuar detyrimet për shkaqe të paarsyeshme nuk i plotëson ato, atëherë gjykata vendos revokimin e vendimit të dënimit me kusht. Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 43 par.2 të KP-së.

### **2.3.3 Zëvendësimi i dënimit me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme**

Kodi ynë penal i jep autorizim gjykatës që të vendosë që me pëlqimin e personit të dënuar të **zëvendësimin e dënimit me burgim** deri në tre muaj ose dënimit me gjobë **me urdhër për punë në dobi të përgjithshme**. Kjo parashikohet në nenin 40 të KP-së. Puna në dobi të përgjithshme është ajo që për nga karakteri dhe përmbajtja është në interes publik si mirëmbajtje, shërbim komunal, në ndërtim etj. Puna në dobi të përgjithshme nuk jepet nëse personi nuk do që ta kryejë atë. Gjykata nuk mund të vendosë asnjëherë kundër dëshirës së personit të dënuar. Zëvendësimi i dënimit me punë të dobishme mund të jepet kur rrezikshmëria e personit dhe e veprës është e vogël, dhe kur nga rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale, gjykata çmon se ajo do t'ia arrijë qëllimit të dënimit. Kjo punë në dobi të përgjithshme jepet për një kohë të caktuar dhe atë prej 30 deri në 240 orë dhe duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata, kohë e cila nuk duhet të kalojë 1 vit, duhet theksuar se kjo punë është pa shpërblim.

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose vetëm pjesërisht e ka kryer punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata mund të revokojë vendimin e tillë dhe të caktojë një afat të burgimit në proporcion me kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që nuk është kryer. Afat i burgimit nuk duhet të tejkalojë afatin e parë të burgimit në rastin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të lëshuar sipas nenit 38 par.3 ose nuk duhet të tejkalojë gjashtë muaj në rastin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të lëshuar sipas nenit 39 par.3 të KP-së, e në rastet kur i dënuari nuk pajtohet me zëvendësimin e

dënimit me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 3 të nenit 39 të KP-së, gjykata cakton një ditë burgim për çdo 15 euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos tejkalojë gjashtë muaj. Për llojin e punës në dobi të përgjithshme, ditët e javës, organizatën e veçantë në të cilën do të kryhet puna në dobi të përgjithshme dhe mbikëqyrjen e saj e bën Shërbimi Sprovues.

### **2.3.4 Vërejtja e gjykatës**

Qëllimi i vërejtjes së gjykatës është që t'i jepet kryerësit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryerësin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit. Me vërejtje të gjykatës, kryerësit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale për të cilën nëse ai sërish kryen vepër të tillë gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal. Vërejtja shqiptohet për vepra penale për të cilat me ligj është paraparë dënim me burgim deri në një vit ose dënim me gjobë, mirëpo me ligj është paraparë që vërejtja mund të shqiptohet edhe për veprat penale për të cilat ligji parasheh deri në tri vite dënim me burg, kur veprat e tilla janë kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese. Ligji po ashtu parasheh mundësinë e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore edhe për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim.

## **3. ZBATIMI I DËNIMIT**

### **3.1 Bashkimi i dënimeve**

Kushti themelor për bashkimin e dënimeve është nëse kryesi me një apo më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë. Kur ato nuk gjykohen në të njëjtën kohë dhe po nga ajo gjykatë, ka raste kur vendimet e dënimit të personit të caktuar takohen gjatë ekzekutimit të tyre, po ashtu edhe me këtë rast bëhet bashkimi i dënimeve. Që të kemi bashkim dënimesh duhet të jenë kryer dy ose më shumë vepra penale. Neni 71 i KP-së parashikon bashkimin e dënimeve, gjykata së pari shpallë dënimin për secilën vepër, e më pastaj për të gjitha këto vepra shqipton dënim unik.

Kushtet për bashkimin e dënimeve janë:

- Nëse për ndonjërin prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim afatgjatë, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim;
- Nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim, dënimi unik duhet <sup>68</sup> të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh;
- Nëse gjykata e ka shpallur dënimin me burgim deri në tri vjet për secilën prej veprave penale, dënimi unik me burgim nuk mund të jetë më i madh se tetë vjet;
- Nëse gjykata ka caktuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë nuk duhet të tejkalojë shumën prej 25.000 euro, përkatësisht 50.000 euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit material;
- Nëse gjykata për disa vepra penale ka shpallur dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shpallur dënimin me gjobë, ajo shqipton dënim unik me burgim dhe një dënim me gjobë në pajtim me pikat 2 deri 4 të të paragrafit 2 të këtij neni.
- Dënimin plotësues gjykata e shqipton nëse është paraparë së paku për një nga veprat penale ose nëse gjykata ka shpallur dënime me gjobë për shumë vepra penale, atëherë ajo e shqipton një dënim unik me gjobë sipas pikës 4 të paragrafit 2 të këtij neni.

### **3. 2 Llogaritja e dënimit personave të dënuar**

Nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm, apo për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim apo burgim afatgjatë, gjykata shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale (neni 71 të këtij Kodi), duke marrë parasysh dënimin e mëparshëm të shqiptuar.

---

68 Kodi Penal i Kosovës neni 71 i KPK-së.



Dënimi ose pjesa e dënimit të cilën i dënuari e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik.

Për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë, gjykata ia cakton dënimin kryerësit pavarësisht nga dënimi i shqiptuar më herët nëse zbatimi i dispozitave të nenit 71 të këtij kodit nuk do ta arrinte qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pjesës së pa mbajtur të dënimit të shqiptuar më parë.

### **3.3 Lirimi me Kusht**

Neni 80 i KPK-së parashikon se për cilat raste personi i dënuar mund të bëjë kërkesë për lirim para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit.

Personi që ka bërë kërkesën për lirimin me kusht duhet që të ketë vuajtur të paktën gjysmën e dënimit të caktuar nga gjykata dhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të ketë mbajtur një qëndrim të mirë dhe me sjelljen e tij të ketë treguar se vërtet ky dënim i ka arritur qëllimet e tij, për riedukimin e këtij personi. Kërkesë për lirim me kusht mund të bëjë edhe personi i dënuar i cili ka mbajtur 1/3 e dënimit me burgim përjashtimisht mund të lirohet me kusht kur rrethanat e veçanta që lidhen me personin e dënuar tregojnë se ai nuk do të kryej vepër të re penale, po ashtu edhe i dënuari i cili ka mbajtur 3/4 e dënimit me burgim afatgjatë mund të lirohet me kusht, për këtë lirim me kusht vendosë trupi gjykues i themeluar nga organi kompetent publik në fushën e çështjeve gjyqësore në pajtim me ligjin.

Nëse personi gjatë kohës së lirimit me kusht kryen një apo me shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me më tepër se një vit burgim gjykata e revokon lirimin me kusht, gjykata po ashtu mund të revokoj lirimin me kusht edhe në rastet kur personi i dënuar gjatë lirimit me kusht kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim deri në një vit duke marr parasysh ngjashmërinë e veprave penale të kryera si dhe motivin.

Në rastet kur gjykata revokon vendimin për lirim me kusht, zbaton dispozitat për bashkimin e dënimeve, me ç'rast pjesa e mbetur e dënimit pa u vuajtur nga vepra e parë do ti bashkohet dënimit që do të jepet për veprën e dytë.

Në rastet kur personi i liruar me kusht dënohet me jo më shumë se një vit burgim, gjykata mund të mos urdhëroj revokimin e lirimit me kusht, me ç'rast edhe lirimi me kusht vazhdohet për aq kohë sa i dënuari e ka mbajtur dënimin e tillë me burgim.

#### **4. QËLLIMI I DËNIMIT**

Qëllimi i përgjithshëm i sanksionit penal është caktimi dhe njëherit shqiptimi i dënimit me qëllim të eliminimit të veprimtarive të dëmshme shoqërore me të cilat cenohen ose rrezikohen vlerat shoqërore të mbrojtura me legjislacionin penal, ndërsa qëllimi i dënueshmërisë është pengimi i kryerësit që në të ardhmen të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij (preventiva speciale), ndikimi edukues në të tjerët që të mos kryejnë vepra penale (preventiva gjenerale) dhe forcimi i moralit shoqërorë si dhe ndikimi në zhvillimin e përgjegjësisë shoqërore dhe disiplinës qytetare.

#### **5. PËRMBLEDHJE E SHKURTË LIDHUR ME TEMËN**

Caktimi i dënimit nga gjykata është si një ndër momentet më të rëndësishme, për të mos thënë finalizuese, të procesit penal. Duke i caktuar veprat penale, ligji vërteton edhe kufijtë e dënueshmërisë për çdo veprë, duke caktuar llojin dhe lartësinë e dënimit me anë të caktimit të kufirit më të ultë dhe më të lartë të dënimit, kështu që edhe në këtë mënyrë vërtetohen shkallë të ndryshme të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe kryerësit. Gjykata pasi që vërteton kryerjen e veprës, në kufijtë e kushteve që i cakton ligji, në kuadër të dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësit cakton dënimin adekuat, që do të thotë se caktimi i dënimit i takon ekskluzivisht kompetencës së gjykatës. Ligji po ashtu në dispozitat e tija të përgjithshme parasheh edhe mundësin për ndryshimin e kufijve të dënueshmërisë, e pos kësaj parasheh edhe mundësin e lirimit nga dënimi, po ashtu sipas kodit tonë është paraparë edhe mundësia e ndryshimit të dënimit përjashtimisht me një lloj më të butë të sanksionit penal si është dënimi me kusht, vërejtja gjyqësore ose puna në dobi të përgjithshme shoqërore, e për të cilin ndryshim të tillë të dënimit, gjykata, ka autorizim të plotë nga ligji.

Në bazë të kësaj gjykata kryerësit të veprës penale do t'ia matë dënimin në kufijtë të cilët janë të caktuar me ligj për atë vepër penale, duke pasur parasysh qëllimin e dënueshmërisë dhe duke i marr për bazë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i lartë apo më i vogël.

Në bazë të gjithë kësaj rrjedh se kemi matje Ligjore të dënimit, e që bëhet nga organi që nxjerr ligjin (ligjvënësi), i cili me rastin e parashikimit të veprës penale e ka caktuar edhe llojin dhe lartësinë e dënimit, gjithashtu kemi edhe **matjen Gjyqësore** të dënimit, të cilën e bënë vet gjykata paraprakisht kur në procedurën penale kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës për veprën e kryer.

*Gjysmëliria* –është një lloj i dënimit alternativ i cili konsiston në atë që personit të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim, i mundësohet që çdo ditë, brenda orëve të caktuara (gjashtë, tetë apo dhjetë orë), të mund të qëndrojë në liri për të vazhduar punën profesionale të cilën e ka kryer edhe para kryerjes së veprës penale, apo që të kryej punët familjare, të vijojë shkollimin, të vazhdojë mjekimin etj, dhe pasi ti kryej punët brenda orëve të lejuara për të qëndruar në liri, i dënuari është i detyruar që të kthehet në entin për vuajtjen e burgut.

*Dënimi me kusht*- në një farë mënyre është masë paralajmëruese e cila i shqiptohet kryerësit të veprës penale, kur arsyeshëm mund të pritët se me paralajmërim nën kërcënim të dënimit, të cilën në vete e përmban dënimi me kusht, pra me mos ekzekutim të dënimit mund të arrihet deri te qëllimi i dënimit. Në bazë të kësaj dënimi me kusht është zëvendësim për dënim me burg efektiv. Me këtë kryerësi qortohet dhe në të njëjtën kohë i bëhet me dije se në kohën e verifikimit të caktuar nga ana e gjykatës nëse kryen vepër të re penale ose nuk i përmbushë detyrimet e caktuara me dënim me kusht, dënimi i shqiptuar me kusht ka për tu ekzekutuar.

*Vepra e rëndësisë së vogël* - Për me qenë një vepër e rëndësisë së vogël duhet që në mënyrë kumulative të përmbushen dy kushte, e që në bazë të kësaj rrezikshmëria shoqërore e veprës të jetë e parëndësishme si dhe pasojat të jenë të parëndësishme ose pasojat e dëmshme në përgjithësi të mos jenë shkaktuar.

*Vërejtja gjyqësore* - është sanksion i posaçëm e cili sipas brendisë dhe qëllimit të saj, nuk është dënim por në fakt është një masë jo ndëshkuese, e cila sipas natyrës së sajë është masë për zëvendësimin e dënimit, veçanërisht të dënimit me burgim afatshkurtër, e cila për kryerësin e veprës penale paraqet qortim serioz dhe publik që bëhet nga gjykata kryerësit të veprës dhe njëherit i tërhiqet vërejtja që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, sepse në të kundërtën për to do të dënohet me një sanksion penal më të rëndë.

*Lirimi nga dënimi*- ka të bëjë në një farë mënyre me ikje nga rregulli që kryesit penalisht të përgjegjshëm gjithmonë duhet shqiptuar dënim. Fjala është për mundësinë ligjore të jashtëzakonshme, e cila më së miri tregon se sa të mëdha janë autorizimet e gjykatës me rastin e matje së dënimit, gjë që në njëfarë mënyre mund ta quajmë edhe një lloj të faljes ligjore dhe gjyqësore, me ç'rast vërtetohet ekzistimi i veprës penale, përgjegjësisë penale të kryerësit të veprës, mirëpo dënimi nuk shqiptohet, pra hiqet dorë nga shqiptimi i dënimit për arsye të caktuara. Në të vërtetë kryerësi i veprës penale dënohet pa dënim.

Arsyetimi për këtë institut qëndron në atë se në situata të caktuara, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, shkalla e rrezikshmërisë së veprës dhe e kryerësit të sajë ndjeshëm e zvogëluar, apo për shkak se ekzistojnë arsye të caktuara të cilat tregojnë se kryerësit nuk duhet shqiptuar dënimi.

## 7. MATJA E DËNIMIT PËR VEPRAT PENALE NË BASHKIM

Në shkencën e së drejtës penale, po ashtu edhe në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore njihen tri lloje sistemesh të matjes së dënimit unik për veprat penale në bashkim, si **sistemi i absorbicionit**, **sistemi i asperacionit** dhe **sistemi i kumulacionit**, të cilat sisteme i njeh edhe Kodi Penal i Kosovës, në të cilin sistemi i asperacionit është më i theksuari ngase në praktikë më së shumti aplikohet, ndërsa sistemi i absorbicionit dhe sistemi i kumulacionit janë si të themi sisteme plotësuese.

**SISTEMI I ABSORBCIONIT** - është sistem i rregullt në ato sisteme penale të cilat e njohin dënimin më të rëndë, si dënimin me vdekje apo

dënimin me burg të përjetshëm, për arsye se ato sipas natyrës së tyre janë si dënime më të rënda dhe i absorbojnë dënimet tjera, përveç dënimit me gjobë në rastet e dënimit me burg të përjetshëm.

Këtë sistem edhe kodi ynë e parasheh në ato raste kur kemi të bëjmë me ndonjë vepër në bashkim, në këto raste gjykata e vërteton dënimin me burgim afatgjatë, i cili dënim i absorbon të gjitha dënimet tjera.

Në literaturë juridike mund të hasen mendime se një zgjidhje e tillë nuk është adekuate, për arsye se ekzistojnë situata kur aplikimi i këtij sistemi politiko kriminal është i diskutueshëm, respektivisht se ai nuk i përshtatet arsyeve të drejtësisë dhe kërkesave të politikës kriminale.

Edhe pse ligji ka lëshuar që të rregullojë, deri te aplikimi i sistemit t absorbimit vie edhe atëherë kur për një vepër është vërtetuar dënimi me burg deri në 20 vite si maksimum ligjorë i dënimit. Sipas këtij sistemi dënimi unik do të përcaktohet edhe në rastet në të cilat për një vepër është vërtetuar dënimi me burg prej 6 muajsh ose më shumë, e për vepër tjetër penale dënim me burg prej 20 ditësh, edhe pse bëhet fjalë për dënim me burgim, këtu sistemi i asperacionit nuk mund të vijë në shprehje, pasi që dënimi mbi 6 muaj burgim nuk mund të shqiptohet në ditë, e në bazë të sistemit të asperacionit dënimi unik nuk mund të arrijë shumën e të gjitha dënimeve.

**SISTEMI I ASPERACIONIT** - ky sistem në të drejtën tonë penale është themelorë dhe më i rëndësishmi. Këtë e vërteton edhe praktika gjyqësore e cila këtë sistem më së shumti e përdorë me rastin e shqiptimit të dënimit unik. Fillimisht sistemi i asperacionit përbëhet në atë se deri te dënimi unik vihet ashtu që gjykata për secilin vepër penale shqipton dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund të arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej 20 vitesh. Duhet theksuar se ky qëndrim është i arsyetuar, pasi që në këto situata të dy sistemet tjera janë të pajustificueshëm pasi që do të kishin sjellë deri te pajustificueshmëria e dënueshmërisë më të lehtë apo më të rëndë për veprat penale në bashkim. Me aplikimin e sistemit të kumulacionit ndonjëherë do të kishim dënime shumë të larta, për të cilat nuk do të ishte i mundshëm edhe ekzekutimi i tyre pasi që do të tejkalonin edhe jetëgjatësinë e kryerësit të veprës penale.

Gjithashtu sipas këtij sistemi të matjes së dënimit për veprat penale relativisht lehtësuese të kryera në bashkim, për të cilat gjykata shqipton dënim me burg deri në 3 vjet për secilën prej veprave, dënimi unik nuk mund të jetë më i madh se tetë vjet.

**SISTEMI I KUMULACIONIT**- është sistem në bazë të cilit dënimi unik vërtetohet ashtu që për të gjitha dënimet të cilat gjykata i ka vërtetuar për të gjitha veprat në bashkim mbledhen. Ky sistem përdoret rrallë, kryesisht te dënimet me gjobë, me ç'rast dënimi me gjobë i caktuar për secilën nga veprat penale nuk do të tejkalojë shumën e përgjithshme të dënimit me gjobë të përcaktuar si maksimumi i përgjithshëm i përcaktuar me ligj. Te dënimet me burg kryesisht ky lloj sistemi shmanget për arsye se konsiderohet i padrejtë, për arsye se me akumulimin mekanik të dënimit shumë theksohet efekti i përgjithshëm, dhe në këtë mënyrë në përgjithësi fitohet dënim më i rëndë nga ai që e kërkon dhe e justifikon gjendja kriminale e dhënë-theksuar.

## **PËRFUNDIM**

Në punim jemi munduar që të trajtojmë në mënyrë të hollësishme mënyrën - metodologjinë e matjes së dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal si dhe zbatimin e tyre si dhe qëllimin e dënimit. Jemi ndalur në to, duke pasur parasysh faktin se është detyrim ligjor i gjykatës të marrë në konsideratë këto rrethana, të cilat e ndihmojnë atë në vlerësimin sa më objektiv të rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit dhe të veprës penale. Vetëm duke bërë këtë vlerësim gjykata do të mund të ndihmohet në caktimin e një dënimi të drejtë, i cili do të ketë efektin e duhur edukativ e parandalues.

Në këtë punim po ashtu jemi munduar që të trajtojmë edhe bashkimin e dënimeve, gjithashtu në punim kemi trajtuar edhe alternativat e dënimit me burgim, punën në dobi të përgjithshme, vërejtjen gjyqësore si dhe lirimin me kusht si dhe sistemin e matjes së dënimit për veprat penale në bashkim.

## **LITERATURA:**

- Kodi Penal i Kosovës – 6 prill 2004
- E Drejta Penale –Pjesa e përgjithshme, Dr. Ismet Salihu 2008
- Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës



Valdet Gashi



Mr.sc. Visar Musa

## KËQYRJA E VENDIT TË NGJARJES

### Hyrje

Kuptimi dhe rëndësia e vendit të ngjarjes, është një theks i posaçëm që duhet treguar vëmendje organet e hetuesisë.

Vendi i ngjarjes në procedurën hetimore nuk është diçka e re, por një veprim kriminalistik mjaft i hershëm, kur dihet fakti që veprimet kriminale nga kriminelet ishin preokupim që nga lindja e shteteve, andaj me qëllim të mbrojtjes nga veprimet e tilla kriminale mjaft të modifikuara, domosdo lindë nevoja e përparimit të kësaj procedure kriminale. Jo rrallë ndodh që veprimet paraprake të krimineleve, para se të ndërmarrin veprime kriminale i modifikojnë mjaft mirë dhe në mënyrë strukturore edhe me vendin e ngjarjes në atë mënyrë që alibia e tyre ju humb hetimeve kahun në tërësi, apo më mirë të themi se vështirëson në një masë të madhe hetimin, ashtu që edhe hetuesit më të përgatitur profesionalisht, jo rrallëherë ndodh që të mos vie deri tek e vërteta apo zbardhja e rastit kriminal. Andaj vendi i ngjarjes është vend i rëndësisë së posaçme për veprimet hetimore të organeve hetuese sepse çdo veprim i pakujdesshëm mundë të shkaktoj pasoja të pa riparueshme në këtë stad të procedurës.

### 1. KUPTIMI

Këqyrja i vendit të ngjarjes është veprim hetimor procesual i nxjerrjes së provave materiale, ku bazë primare e organeve proceduese për këqyrjen e

vendi të ngjarjes është neni 254 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Në dispozitat normative të KPPK-së nuk rregullohet materia e këqyrjes së vendit të ngjarjes, por vetëm përcaktohet baza juridike e këqyrjes.

Me këqyrjen e vendit të ngjarjes organi procedues percepton mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, fikson, mbledhë prova materiale dhe sqaron rrethanat që kanë rëndësi për çështjen penale.<sup>69</sup>

Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprimi i parë hetimor me anën e të cilit organi procedues fillon të ngrejë themelet e hetimit të ardhshëm. Sa më të forta dhe të fuqishme të jenë këto themele, aq më i shëndoshë, i plotë dhe i shpejtë do të jetë hetimi.

Këqyrja e vendit të ngjarjes, për dallim nga veprimet tjera, si rregull, konsiderohet veprim hetimor i pazëvendësueshëm dhe i papërsëritshëm. Konsiderohet kështu, për arsye se organi i procedurës përmes këtij veprimi percepton drejtpërdrejtë gjurmët dhe sendet që kanë lënë veprat penale dhe kryesi i saj, si dhe studion lidhjen objektive dhe shkakore të tyre me çështjen.

Në këtë kuptim vendi i ngjarjes mund të jetë një territor ose lokal i caktuar që në një çast të dhënë në krahasim me gjendjen e tij të mëparshme, ka pësuar ndryshime të cilat mund të jenë rrjedhojë e veprimeve të njerëzve të kryera me vetëdije ose më pavetëdije të tyre apo si rrjedhojë e mosfunksionimit normal të mekanizmave e të pajisjeve, avarive në prodhim, në ndërtim e në transport ose e dukurive të natyrës.<sup>70</sup>

Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprim hetimor, me anë të cilit organi procedues percepton drejtpërdrejtë mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson gjurmë e prova materiale dhe sqaron rrethanat që kanë rëndësi për çështjen.

Në aspektin kriminalistik vendi i ngjarjes është vend ku kryesi ka ndërmarr veprime aktive për kryerjen e veprës penale apo ku ka qenë i detyruar të

---

69 Çështjapenale (causa criminalis) është ngjarje e cila me përmbajtjen e saj tregon për veprën e caktuar penale dhe kryesin e saj dhe se që për shkak të tij zhvillohet procedura penale.

70 Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, faqe.171



ndërmerr veprime të caktuara, këtu bënë pjesë edhe vendi ku pasoja ka ardhur apo është dashur të vij sipas planifikimit të kryesit.

Sa i përket nocionit vend i ngjarjes, duhet kuptuar se vend i ngjarjes është jo vetëm vendi ku ka ndodhur vepra penale, por edhe vendi ku janë zbuluar rrethanat që lidhen me të dhe pasojat e tij, pavarësisht nga largësia midis këtyre vendeve.

Vendi i ngjarjes është vendi më i rëndësishëm i informatave relevante sidomos të atyre të karakterit traseologjik, kurse këqyrja e vendit të ngjarjes përbën thelbin mbi të cilën ndërtohet hetimi dhe gjykimi i drejt i veprës penale.

Detyrë kryesore e këqyrjes së vendit të ngjarjes është studimi i mjedisit ku ka ndodhur vepra penale, i mekanizmit dhe i rrethanave të saj, zbulimi, mbledhje dhe fiksimi i gjurmëve sendeve - provave materiale dhe fiksimi i rezultateve që ka dalë nga kjo këqyrje.

Pikësypnim në këqyrjen e vendit të ngjarjes është mbledhja e sa më shumë të dhënave që kanë të bëjnë me objektin e të provuarit.

Këqyrja e vendit të ngjarjes, megjithëse është një mjet i fuqishëm për mbledhjen e gjurmëve, nuk ka për detyrë t'i japë zgjedhje përfundimtare problemit se çfarë ngjarje ka ndodhur. Problemi se çfarë vepre penale është kryer dhe cilët janë faktorët kryesorë zgjidhet vetëm pasi të kryhen të gjitha veprimet tjera hetimore e gjyqësore dhe pasi të bëhet vlerësimi në tersi i provave të mbledhura me anë të këtyre veprimeve.

## **2. ELEMENTET THEMELORE TË KËQYRJES SË VENDIT TË NGJARJES**

### **2.1 Vrojtimi i subjekteve dhe operimet logjike**

Vrojtimi i subjekteve dhe operimet logjike janë elemente themelore të këqyrjes së vendit të ngjarjes për shkak se çdo rast kriminal kërkon forma të ndryshme të veprimit dhe përgjegjësi por edhe detyrime. Detyrë kryesore

gjatë vrojtimit të subjekteve në vendin e ngjarjes është mbrojtja e jetës së subjekteve të cilët takohen në vendin e ngjarjes dhe para se të futet në vendin e ngjarjes organi i procedurës duhet të ketë parasysh sigurinë e tij personale, sigurinë e të tjerëve të cilët arrin në vendin e ngjarjes, mbrojtjen e jetës, sigurimin e vendit të ngjarjes dhe mbrojtjen e provave materiale. Mbrojtja e jetës nuk përfshin vetëm mbrojtjen e jetës së viktimës por natyrisht edhe të dyshuarit si dhe vet policin.

Gjatë praktikës në ditët e sotme tek rastet e rënda kriminale (vrasjet) shpesh herë organet proceduese arrin shumë më herët në vendin e ngjarjes se sa ndihma mjekësore, andaj mendoj se ndihma e shpejt mjekësore duhet të jetë e organizuar në atë mënyrë që të jetë e gatshme që të reagoj në kohë sa më të shkurtër me të marrë lajmin për ndihmën, por për shkak të arsyes që shpesh herë ai që paraqet rastin së pari lajmëron policin duke menduar se viktima është gjallë.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka vendi i ngjarjes për veprën penale dhe për rrjedhën e përpunimit të mëtejme kriminalistik, policët duhet të operojnë në mënyrë logjike me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së personelit mjekësor që në rastin e ofrimit të ndihmës të kenë kujdes ruajtjen e gjurmëve të veprës penale, mirëpo edhe krahas kësaj ata duhet të përcjellin intervenimin mjekësor me qëllim t'i evidentojnë ndryshimet e krijuara në vendin e ngjarjes. Kjo vlen edhe për organet tjera të cilët mund të jenë të angazhuar në rastin konkret.

### **3. FAZAT E KËQYRJES SË VENDIT TË NGJARJES**

Lidhur me fazat e këqyrjes së vendit të ngjarjes në shkencën kriminalistike nuk ekziston një unitet. Disa mendojnë se këqyrja e vendit të ngjarjes zhvillohet në dy fazë (statike dhe dinamike), një numër i madhe i autorëve përmendin tre faza (faza e sigurimit, statike dhe dinamika), kurse sipas Dushko Modly këqyrja zhvillohet në pesë faza (faza informative, statike, dinamika, kontrolluese, finale apo përfundimtare).

Fazat e këqyrjes së vendit të ngjarjes:

### **3.1. Faza informative – organizuese**

Faza informative është faza e parë kur organet policore njoftohen për rastin. Punonjësit operativ pranojnë thirrje telefonike apo përmes vet paraqitjes së palëve ankuese në polici ose përmes persona tjerë të cilët njoftojnë për rastin. Në këtë fazë punonjësit operativ duhet të sigurojnë sa më shumë informata për rastin. Kjo bëhet për atë qëllim që organet policore të arrin sa më shpejt që është e mundur në vendin e ngjarjes, si dhe të jenë të përgatitur për natyrën e rastit. Në këtë fazë punonjësi operativë duhet ti sugjeroj palët, rreth sigurimit të përkohshëm të vendit të ngjarjes derisa të arrin policia në vendin e ngjarjes.

Pas arritjes në vendin e ngjarjes organet policore (hetuese) në këtë fazë pranojnë informata nga policia apo nga personat tjerë të cilët e kanë siguruar vendin e ngjarjes ose kanë njohuri për ngjarjen.

Sipas Nedza Korajlici, territori i vendit të ngjarjes varësisht nga vlerësimi i organit të shikimit dhe anëtarëve të ekipit mund të rritët dhe të zvogëlohet.<sup>71</sup>

Unë mendoj që vendi i ngjarjes nuk mund të rritët për shkak se qytetarët mund të lëvizin lirshëm jashtë shiritit siguries të vendit të ngjarjes dhe gjatë lëvizjes mund të prishin dëshmitë, apo prej personave nga kureshtja të cilën afrohen afër shiritit siguries. Për këtë arsye sigurimi i vendit të ngjarjes duhet të bëhet në një hapësirë të madhe dhe varësisht nga rasti të zvogëlohet. Në këtë fazë vëmendje të posaçme i kushtohet marrjes së njohurive për ndryshimet e mundshme në vendin e ngjarjes pas kryerjes së veprës.

Në këtë fazë organet e këqyrjes nxjerrin vendim se si duhet të kryet këqyrja, varësisht nga situata në vendin e ngjarjes. Në rastet kur ngjarja është e ndërlikuar duhet përpilohet planë me shkrim. Në këtë fazë mund të merret vendimi për zgjerimin eventual të ekipit ose për pjesëmarrjen e personave të tjerë profesional apo të ekspertëve.

### **3.2. Faza statike**

Faza statike është faza e dytë në të cilën organi procedues studion dhe shënon shenjat grupore dhe individuale të objekteve që ndodhen në vendin

e ngjarjes, përmasat e tij, pozicionin, largësitë, largësinë e saktë lidhur me dy pika fikse, porosinë të bëhet fotografimi i mjedisit dhe i objekteve veç e veç.<sup>72</sup>

Kjo fazë pason pas fazës informative dhe ka të bëjë me kontrollin e vendin të ngjarjes.

Gjurmët dhe objektet e gjetura në vendin e ngjarjes shënohen në proces verbal me numra dhe fjalë, maten, konstatohet largësia midis tyre (skicohet), analizohen, interpretohen, fotografohen në tërësi dhe në detaje, por sipas renditjes së caktuar logjike. Nuk guxon që numrat dhe fjalët të shkruhen në mënyra të ndryshme.

Është e rrugës që procedura e identifikimit dhe e shënimit të gjurmëve në vendin e ngjarjes të bëhet njëkohësisht në mënyrë që dëmtimi ose shkatërrimi i objekteve të mos ndodhë nga pakujdesia.

Rezultatet duhet të përshkruhen me një saktësi dhe qartësi të madhe në mënyrë që ma lehtë pastaj të dallohen nga konstatimet në fazën dinamike të këqyrjes. Në këtë fazë krijohet një plan i punës për fazën dinamike që pason.

### **3.3. Faza Dinamike apo aktive**

Në fazën dinamike organi procedues e lëviz objektin, po të jetë e nevojshme, e studion atë dhe shënon shenjën që zbulohet në pjesën që nuk shihet nga këqyrja statike.<sup>73</sup>

Kjo fazë është pjesa qendrore e këqyrjes së vendit të ngjarjes, e cila imponohet si nga dimensionet ashtu edhe nga konfiguracioni i terrenit.

Në këtë fazë organi procedues është më dinamik, më aktiv, kërkon, zbulon dhe fikson gjurmë dhe objekte për të cilat konsiderohet se kanë lidhje me ngjarjen dhe marrëdhëniet midis tyre. Lejohet të bëhen ndryshimet e nevojshme dhe të zhvillohet hulumtimi i disa gjurmëve dhe objekteve duke

---

71 N. Korajlic, Kriminlistika, Prishtinë, 2009, fq. 208.

72 V. Latifi, Kriminlistika, Prishtinë, 2009, fq.177.

73 V. Latifi, Kriminlistika, Prishtinë, 2009, fq.177.

pasur kujdes që të mos shkatërrohen, kontaminohen ose të dëmtohen gjurmët ekzistuese, gjegjësisht të mos formohen gjurmë të reja.<sup>74</sup>

Në fazën dinamike grupi hetimor vëzhgon, krahason, eksperimenton dhe ngre versione. Metodologjike të vëzhgimit, të krahasimit, të eksperimentimit dhe sidomos metoda e ngritjes dhe verifikimit të versioneve hetimore e ndihmojnë atë për të gjetur lidhjen e rrethanave që kanë rëndësi për çështjen dhe për të sqaruar mekanizmin e ngjarjes.<sup>75</sup>

Vlen të ceket se faza statike dhe dinamike e këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk mund të ndahen mekanikisht sepse në praktikë jo radhë gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes këto dy faza gërshetohen siç e kërkon gjendja traseologjike në vendin e ngjarjes.

Përcaktimi i drejt i vendit të ngjarjes dhe fiksimi adekuat i gjendjes faktike mundësojnë krijimin e pasqyrës apo shfaqjes së gjallë mbi ngjarjen.

Për zbulimin dhe fiksimin e gjurmëve dhe të sendeve - provave materiale përdoren metodat e mjetet teknike-shkencore që rekomandohen nga teknika kriminalistike për të gjitha llojet e gjurmëve.

Vlen të ceket se këqyrja statike dhe dinamike e këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk është një ndarje topografike por ka kuptimin logjik, por shërben për ta njohur më mirë vendin ku ka ndodhur vepra penale, për të mbledhur gjurmët, sendet - provat materiale, për t'i studiuar e për t'i vlerësuar ato dhe për ti sqaruar ato, po ashtu për të sqaruar mekanizmin e vendit të ngjarjes.

### **3.4. Faza kontrolluese**

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes lëshimet gjithmonë janë të mundshme e sidomos kur është fjala për këqyrjet komplekse ku në vendin e ngjarjes ka viktimën dhe ku shpesh herë duhet shmangur nga metodologjia e standardizuara. Esenca e fazës kontrolluese qëndron në atë se të gjithë anëtarët e ekipit i rezumojnë rezultatet e shikimit dhe kërkojnë lëshimet eventuale të cilat patjetër duhet të korrigjohen duke i përsëritur masat dhe

74 N. Korajlic, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, fq. 213.

75 V. Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, fq.177.

aktivitetet e caktuara taktike-teknike. Atëherë kur shihet qartë që gjatë këqyrjes janë bërë lëshime të ndryshme të njëjtat mund të eliminohen vetëm para përfundimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Gjatë kësaj faze rishikohet rrjedhja e deritanishme e këqyrjes, bëhet analizë e punës së kryer dhe në bazë të rrethanave bëhet ndërmarrja e ndonjë mase dhe aktiviteti tjetër, kur paraqitet nevoja për përsëritjen e ndonjë aktiviteti kjo bëhet në këtë fazë. Është e rrugës që të planifikohet në mënyrë të saktë tërë rrjedha e këqyrjes së vendit të ngjarjes por duhet pasur parasysh që ky plan duhet të jetë orientues dhe fleksibil dhe vërtetohet se është krejt e arsyeshme, dhe pasi të kryhet punë e madhe mund të vlerësohet se a mund të punohet edhe diçka që nuk është planifikuar apo që nuk është mundur të parashikohet. Në këtë mënyrë shmangen lëshimet e shumta gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes.

### **3.5 Faza finale apo përfundimtare**

Faza finale është faza e fundit e këqyrjes së vendit të ngjarjes, në këtë fazë duhet të shkruhet procesverbali i cili mbahet gjatë tërë këqyrjes, vendoset për **“corpora-deliktit”** në kuptim të ruajtjes së tyre, dërgimit në ekspertizë e tjera. Në këtë fazë organet orientuese kanë për detyrë përpilimin e procesverbale mbi këqyrjen në bazë të shënimeve apo vërejtjeve gjatë këqyrjes. Çdo vonesë e kësaj pune është e papranueshme në aspektin kriminalistik.

Në bazë të kushteve materiale është mirë që procesverbali të shtypet po në këtë fazë, por praktika e deritanishme tregon se procesverbali shtypet në zyre, madje edhe pas disa ditësh dhe javësh, gjë që nuk është e mirë dhe këtë praktikë duhet ndryshuar.

Në zyre bëhet zhvillimi i filmit, punohen fotografit, gjithashtu për gjurmët e gjetura dhe objektet e caktuara bëhet kërkesa për ekspertizë. Siç po shihet në fazën përfundimtare kryhen disa aktivitete pa të cilat nuk është e mundur kryerja e drejt e këqyrjes së vendit të ngjarjes.

## **4. PËRGATITJA PËR KËQYRJEN E VENDIT TË NGJARJES**

Për tu kryer me sukses këqyrja e vendit të ngjarjes rëndësi themelore ka përgatitja për këqyrjen e vendit të ngjarjes. Vendi i ngjarjes në çdo lloj vepre

penale, ka të papritura, objekte të shumëllojta, që nuk mund të merren me mend. Këtë del se nevoja për organizimin dhe parashikimin e masave përgatitore për të kapërcyer çdo vështirësi që mund të dal në vendin e ngjarjes.

#### **4.1. Masat përgatitore kur organi njoftohet për veprën penale**

##### **4.1.1. Marrja e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes**

Ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e provave materiale dhe gjurmëve. Sigurimi i vendit të ngjarjes është tërësi aktivitetesh që zhvillohen prej fazës së daljes së parë të zyrtarëve policor në vendin e ngjarjes dhe vazhdon edhe gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, ndërsa në raste të caktuara edhe pas përfundimit të tij. Sigurimin e vendit të ngjarjes mund ta bëjnë edhe persona tjerë, mirëpo duhet pasur kujdes se për ruajtjen e vendit të ngjarjes nuk duhet të angazhuar personat që kanë lidhje apo interes të caktuar ndaj kryesve të veprës penale ose të dëmtuarve, sepse këta mund të prishin vendin e ngjarjes, i fshehin ose dëmtojnë gjurmët e provave materiale dhe kështu ta drejtojnë hetimin në rrugë të gabuar.<sup>76</sup>

Detyra e parë e zyrtarëve policor patrullues pas dhënies së ndihmës së parë viktimës dhe pas sigurimit të vendit të ngjarjes është njoftimi i organit procedues që do ta zhvillojë këqyrjen.

„Koha e cila kalon është e vërtet që ik”, kjo ide franceze më së miri ilustron rëndësinë e vonesës në aspektin e sigurimit të vendit të ngjarjes.<sup>77</sup>

Situatat në vendin e ngjarjes parashtrojnë kërkesa dhe prioritete të cilat janë në kundërshtim me arsyet traseologjike p.sh. ofrimi i ndihmës viktimës etj. Arsyet traseologjike jo rrallë kërkojnë që zyrtarët policor të hynë në vendin e ngjarjes para ekipit hetues për arsye të mbrojtjes së gjurmëve dhe ofrimit të ndihmës viktimave. Suksesi i këqyrjes së vendit të ngjarjes si dhe aktiviteteve tjera hetimore varet nga ajo që vendi i ngjarjes të jetë sa më pak i ndryshuar. Sigurimi i vendit të ngjarjes përfshin edhe ndërmarrjen e të gjitha masave për identifikimin e menjëhershëm të personave, ndarjen e dëshmitarëve dhe të fajtorëve, si dhe futjen e tyre nën mbikëqyrjen e sigurt

76 V. Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, fq.173.

77 N. Korjlic, Kriminalistik, Prishtinë, 2009, fq.192.

dhe efektive, bëhet edhe largimi i personave të paftuar dhe kureshtarëve, bëhet mbledhja e informatave të gjitha llojeve etj. Vendit të ngjarjes duhet të sigurohet me mjete të dukshme fizike, më kone, me shirit të verdhë të policisë (stop policia), me automjete të policisë, me zyrtarë policorë të uniformuar.

Organi procedues cakton qartë kufirin e vendit të ngjarjes si dhe vendosjen e perimetrit të caktuar. Ky perimetër definohet si perimetër i brendshëm – një zonë që përfshin tërë sipërfaqen, ku mund të gjinden provat e veprës penale apo aksidentit, kurse perimetër i jashtëm – është zona afër perimetrit të brendshëm të vendit të ngjarjes, e cila ka pak gjasa të jetë direkt e përfshirë me veprën penale apo aksidentin. Ky është një vend ku mund të mblidhen media që të raportojnë në lidhje me veprën penale, ky është vend ku mund të vendoset edhe qendra komanduese që të koordinoj përpjekjet e të gjitha agjencive tjera relevante, po që se kemi të bëjmë me ndonjë incident të përmasave të mëdha.

Gjatë praktikës është vërejtur se detyra më e vështirë për policin e parë në vendin e ngjarjes, është ruajtja e vendit të ngjarjes nga policët shtesë dhe nga njerëzit që punojnë me ndihmën e shpejt, dhe të cilët paraqiten në vendin e ngjarjes. Është e qartë se disa njerëz duhet të futen në vendin e ngjarjes por detyrë e policit të parë është që ti identifikoj të gjithë personat tjerë me qëllim që të parandaloj futjen e personave të paautorizuar në vendin e ngjarjes. Duhet pasur kujdes se të gjitha ndryshimet në vendin e ngjarjes para ardhjes se organit proceduarës duhet të regjistrohen, asgjë nuk guxon të preket e as të lëvizet deri në fazën dinamike.

Nga zyrtari policor i cili siguron vendin e ngjarjes kërkohet njohuri profesionale nga sfera traseologjike.

Vendi i ngjarjes jo vetëm që duhet siguruar por dhe mbrojtur. Gjatë sigurimit të vendit të ngjarjes është e nevojshme që zyrtari policor të zhvilloj Procedurat Standarde të Operimit.

#### **4.1.2. Verifikimi i mjeteve teknike**

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes rolë shumë të rëndësishëm luajnë edhe mjetet teknike, nga përdorimi i të cilave varet cilësia e këqyrjes së vendit



të ngjarjes. Të gjitha mjetet e domosdoshme të cilat nevojiten për zbulimin e gjurmëve, të provave materiale dhe për fiksimin e mjedisit të vendit të ngjarjes dhe të rezultateve të këqyrjes ndodhen në valixhet hetimore. Varësisht nga rasti konkret organi procedues mund të përdor edhe mjete tjera më të përsosura që nuk ndodhen në valixhet hetimore si p.sh. mikroskopi binokular, llamba kuarc, metalkërkuesit, mjete ndriçimi etj.

Mjetet teknike shkencore organi procedues i mban në gatishmëri, pa këto mjete ai do ta këtë shumë të vështirë të zbuloj, fiksoj dhe të marre gjurmë e prova materiale, për shkak se në vendin e ngjarjes shpesh ka më shumë gjurmë të padukshme ose pak të dukshme se sa gjurmë që i sheh syri i njeriut.

#### **4.1.3. Caktimi i personave që do të marrin pjesë në vendin e ngjarjes**

Këqyrja e vendit të ngjarjes, si veprim hetimor, nuk mund të kryhet nga një individ i vetëm nga se ky veprim kërkon punë ekipore e cila, për të rezultuar me sukses duhet të jetë e koordinuar me përcaktimin paraprak të detyrave konkrete të çdo pjesëmarrësi.

Në këtë veprim hetimor, pa mëdyshje roli parësor i takon hetuesit si kryesues i grupit hetimor i cili ka përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës së grupit hetimor nga se ai është bartësi i vetëm i përpilimit të procesverbalit nga vendi i ngjarjes i cili akt do të shërbej si udhërrëfyes gjatë fazës së hetuesisë dhe do të administrohet si provë në procedurën penale.

Në këqyrjen e vendit të ngjarjes marrin pjesë dy kategori personash:

- Persona të autorizuar me ligj gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues, prokurori publik ose policia, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe viktimat.
- Persona që caktohet nga organi procedues, ekspertët, specialistët e mjekësisë ligjore, njëkohësisht, në vendin e ngjarjes mund të marrin pjesë edhe personat me njohuri të ndryshme profesionale varësisht nga ngjarja e ndodhur e me kërkesë të organit hetimor.

Eksperti merr pjesë pothuajse në gjithë këqyrjen e vendit të ngjarjes sipas natyrës së veprës penale që është kryer. Ai ndihmon organin procedurës për t'u orientuar në dukurit që burojnë nga vepra penale e që hyjnë në sferën e njohurive të tij special, në këtë mënyrë ai ndihmon për organizimin e këqyrjes, për funksionimin e mekanizmave dhe aparateve për këqyrje, tërheq vëmendjen për rrethana të pakuptueshme.

Ndihma e specialistit kërkohet brenda disa kufijve të caktuar, ai nuk mund të marrë drejtimin e këqyrjes, organi procedues nuk mund të ndërpres iniciativën e tij p.sh. kur është fjala për zbulimin e gjurmëve e të provave materiale ose për përdorimin e mjeteve tekniko shkencore si për fotografimin, përgatitjen e kallpëve dhe të shenjave tjera.<sup>78</sup>

Gjatë praktikës ndihmësit më të shpeshtë të organit procedurës janë ekspertët e krim teknikës. Pjesëmarrja e tyre gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes është e domosdoshme për arsye se shumica e gjurmëve që lihen në vendin e ngjarjes nga vepra penale apo nga kryesi i saj, kërkohen, zbulohen, fiksohen dhe eksperimentohen me metoda dhe mjete teknike kriminalistike.

I pandehuri i arrestuari ose i ndaluari, dëshmitari ose i dëmtuari marrin pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes kur tregojnë vendin ku janë gjurmët dhe provat materiale dhe për të sqaruar mjedisin dhe rrethanat e veprës penale.

Këqyrjen e vendit të ngjarjes e udhëheq organi procedurës, personat që marrin pjesë i përmbahen udhëzimeve të tij dhe asnjë person cilido qoftë ia nuk ka të drejt të ndërhyjë në punën e organit procedurës.

Mirëpo në praktikë fatkeqësisht prokurori del në vendin e ngjarjes vetëm për raste të rënda penale në vrasje kurse për raste më të lehta për vjedhje, vjedhje të rënda, nuk merë pjesë asnjëherë gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, mendoj se kjo praktik e gabuar duhet të ndryshoj, për shkak se prokurori që në fazën e parë të hetimit si mbikëqyrës i hetimeve duhet të ketë njohuri për natyrën e rastit.

---

78 S. Begeja, Kriminalistika, Tiranë, 2004, Fq.344.

Unë, konsideroj që vet kryerja e veprimit procedural këqyrja e vendit të ngjarjes ose rikonstruimit duhet të merret seriozisht nga Prokurori, sepse nëse vet personalisht prokurori del në vendin e ngjarjes do të njoftohet më për së afërmi dhe do të ketë një pasqyre më të qartë për vendin e ngjarjes apo se si ka mundur të ndodh ngjarja dhe e gjithë kjo do ti mundësonte Prokurorit që të mund ta bëj më bindës dhe më të fuqishëm gjatë përfaqësimit/mbrojtjes së akuzës së tij. Kjo sigurisht do t'i ndihmoj edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor gjatë shtruarjes së pyetjeve. Po ashtu fakt që nuk duhet nënçmuar gjatë procesit gjyqësor është edhe krijimi i përcepçionit mbi njohuritë profesionale lidhur me ngjarjen, dhe nëse si prokuror krijon bindjen të palët se me të vërtet ka njohuri mbi ngjarjen jo vetëm nga informacionet e ardhura nga dora e dytë ( nga policia, shkresat e lëndës etj) por nga vet informacionet e mbledhura nga prokurori atëherë konsideroj, përfaqësuesi i akuzës – prokurori është në avantazh ndaj palës tjetër.

## **5. MASAT KUR ORGANI PROCEDUES MBËRRIN NË VENDIN E NGJARJES**

### **5.1 Kontakti i parë me organet e policisë**

Në momentin kur organi procedues mbërrin në vendin e ngjarjes kontakti i parë i tyre është me zyrtarët patrullues të cilët kanë qenë të ngarkuar për sigurimin e vendit të ngjarjes, mirëpo ndonjëherë në praktik ndodhë që të parët në vendin e ngjarjes të shkojnë zyrtarët hetues të cilët menjëherë duhet të bëjnë sigurimin e vendit të ngjarjes.

Kontakti i parë është shumë me rëndësi për shkak se hetuesi para se të ndërmarr veprime për këqyrjen e vendit të ngjarjes ai duhet që edhe vetes ti parashtrij pyetje se sa ka njohuri për ngjarjen e ndodhur dhe pastaj të shërbehet me pyetjet e arta të kriminalistikës (Çka, Kur, Ku, Kush, Si, Me çka, Me kë, Pse dhe Kë).

Sa i përket kontaktit të parë organi i procedurës duhet të siguroj sa më shumë informata për ngjarjen duke parashtruar pyetjet e lartë cekura, se për çfarë bëhet fjalë dhe nga përgjigjet që do ti merr nga policët e parë nga vendi i ngjarjes do të varet rrjedha e mëtejme e veprimit hetimor të këqyrjes

do të vlerësohet se a ka nevojë organi hetimor të bëj këqyrjen e vendit të ngjarjes apo jo.

## **5.2 Njoftimi për dhënien e ndihmës personave**

Po në kontaktin e parë organi procedues njoftohet nëse i ishte dhënë ndihma e nevojshme viktimave në rast se ka viktima në rastin konkret.

Kur i dëmtuari gjendet në vendin e ngjarjes, organi procedues me lejen dhe në prani të mjekut i bënë pyetje për ngjarjen dhe personat e dyshuar kur ai është në gjendje ti përgjigjet pyetjeve. Vështirësi paraqet pyetja paraprake e personit të dëmtuar rëndë.

Duhet njoftuar personelin mjekësor për provat materiale dhe ti udhëzoj që të zvogëloj kontaktin me to, si dhe mos të pastroj vendin e ngjarjes.

Në praktik mund të ndodhë që personeli mjekësor të arrin i pari në vendin e ngjarjes atëherë duhet të sigurohen të dhënat e tyre.

Nëse viktima bartet në spital, detyrë e policisë e cila e siguron vendin e ngjarjes është që ti marre shënimet e personelit mjekësor dhe targat e regjistrimit të automjetit si dhe emrin e institucionit shëndetësor ku do të bartet viktima. Policia duhet ta përcjellë viktimën deri në institucionin shëndetësor.

Edhe në rastet kur paraqitet nevoja e transportit të personit i cilit është i dyshuar për veprë penale është e nevojshme përcjellja e policisë, për shkak të mbrojtjes fizike të drejtpërdrejt të personelit mjekësor ashtu edhe për shkak të sulmit eventual nga të afërmit e viktimës, si dhe të bëhet sigurimi i gjurmëve të kryesit që të mos vije deri te asgjësimi apo dëmtimi nga kryesi i veprës.

## **5.3 Njoftimi për ngjarjen**

Një nga veprimet shumë të rëndësishme përgatitore kur organi mbërrin në vendin e ngjarjes është njoftimi për ngjarjen i cili njoftim mund të rrjedhë nga dëshmitarët që kanë parë ose kanë zbuluar të parët ngjarjen. Pyetjet që ju parashtrihen këtyre personave kanë karakter informativ për të mbledhur

sa më shumë të dhëna për ngjarjen që ndihmojnë për të organizuar ndjekjen e kryesve ose ndalimin e tyre. Pyetjet për ngjarjen bëhen menjëherë pas vështrimit të parë në vendin ku ka ndodhur vepra, pyetja në këtë vend është në dobi sepse dëshmitarët që kanë parë ngjarjen, dëgjuar dhe zbuluar të parët e riprodhojnë atë me saktësi dhe pa u ndikuar nga faktorët tjerë.

#### 5.4 Verifikimi për arritjen e personave të duhur

Organi procedues pas ndërmarrjes së veprimeve paraprake kur mbërrin në vendin e ngjarjes varësisht prej informatave të cilët ai i siguron në vendin e ngjarjes bën verifikimin e pjesëmarrësve të cilët do të marrin pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes.

Se cilët persona do të marrin pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes kjo varet nga natyra dhe lloji i veprës penale, mënyra e kryerjes dhe mjetet me të cilat është kryer vepra penale.

## 6. PROCESVERBALI NË VENDIN E NGJARJES

Këqyrja e vendit të ngjarjes, pa procesverbal nuk do të paraqiste vlerë të provuarit. Për hetuesit dhe për hartimin e procesverbalit vlejné rregullat themelore “asgjëje mos ti ndryshohet pozita“, pra mos lëvizja e sendeve gjurmëve, mos prekja e tyre para se ato të jenë përshkruar plotësisht në procesverbal.

Nga kjo rezulton se procesverballi është dokumenti kryesor ku pasqyrohet vendi i ngjarjes. Një procesverbal përpilohet për të pasqyruar ngjarjen e ndodhur dhe gjendjen e gjetur në fillim të shikimit duke përfshirë përshkrimin e gjurmëve dhe të provave materiale, shenjave grupore dhe individuale, madhësinë e tyre, largësinë dhe çdo gjë që i ndihmon si grupit hetimor në fazën e hetuesisë ashtu edhe gjykatës gjatë procedurës për të pas një përfytyrim të plotë dhe objektiv të rezultateve që dalin nga këqyrja e vendit të ngjarjes.

Kushti themelor për pasqyrimin e plotë dhe objektiv të rezultateve që dalin nga këqyrja është mbajtja e procesverbalit në vendin ku zhvillohet këqyrja.

Mbajtja e tij në bazë të shënimeve dhe në zyrën e policisë ose në prokurori duhet konsideruar si një praktikë që sjell pasoja të dëmshme për hartimin, veçanërisht rrezikun e pasqyrimin në procesverbal të asaj që i duket më e vlefshme.<sup>79</sup>

Përshkrimi me fjalë i raportit objektiv, të punuar me metoda të drejtpërdrejta gjatë vëzhgimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe hartimi i procesverbalit është mënyra më themelore e fiksimit të gjendjes faktike, të konstatuar me anë të shikimit të vendit të ngjarjes.

Për këtë arsye lëshimet e bëra me rastin e hartimit të procesverbalit nga vendi i ngjarjes mund të kenë pasoja afatgjate për rrjedhën e procedurës, sidomos për procedurën e ardhme penale.

Për procesverbalin mbi vendin e ngjarjes vlejné dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale mbi procesverbalet të cilat hartohen me rastin e ndërmarrjes së aktiviteteve procedurale.

Për shkak të pasaktësisë së dispozitave të Kodit, përmbajtjet e procesverbaleve mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes ndryshojnë prej një organi te tjetri, gjë që shprehet negativisht në punën e organeve të procedurës. Procesverbalet shpesh janë jo të plota dhe të pasakta, kështu që nganjëherë ato sjellin në pyetje edhe vlefshmërinë procedurale, më tepër për shkak të mangësive të karakterit përmbajtjesor se sa për shkak të mangësive të karakterit formal / ligjor.

Sipas karakterit të tij ligjor dhe rëndësisë procedurale procesverbali mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes është dokument i shkruar në të cilin organi përkatës i këqyrjes së vendit të ngjarjes reprodukon një përmbajtje të caktuar kuptimore lidhur me konstatimin e gjendjes faktike gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Në aspektin e argumentimit, procesverbali mbi vendin e ngjarjes është dokument argumentues, i cili duhet të përmbajë përshkrime të sakta mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe nuk guxon që në te të pasqyrohen mendime ose thënie dëshmitarësh mbi ngjarjen, në procesverbal nuk guxon

---

79 V. Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, fq.178.

të ketë hipoteza të organit i cili e bënë këqyrjen ose të anëtarëve të tij. Në procesverbal nuk futen as versionet as dyshimet ndaj të dyshuarve dhe kontributi i tyre në vepër as fajësia e tyre.

Karakteri i procesverbalit të vendit të ngjarjes supozon përmbajtjen e tillë që e bën atë të pamohueshëm, i cili si i tillë me një siguri të madhe argumenton atë që është shkruar në përmbajtjen e tij, me ç'rast rol të madh luan përmbajtja kriminalistike.

Me rastin e ndërmarrjes së këqyrjes së vendit ku është kryer vepra penale hartohet procesverbali ku shënohen të dhëna me rëndësi për këqyrjen dhe për vërtetimin e identitetit të sendeve (përshkrimi, përmasat dhe madhësia e objekteve ose e gjurmëve etj) dhe bëhen skica, vizatime, plane fotografi, incizime filmime ose incizime tjera teknike, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.<sup>80</sup> Bazë e organeve proceduese për hartimin e procesverbalit me rastin e këqyrjes së vendit të ngjarjes është neni 87 par.5 i KPPK-së.

Përmbajtja e procesverbalit e drejton mënyrën e hulumtimit, të shpjegimit të llojit të caktuar të veprës dhe dikton përmbajtjen e kallëzimit penal.

Procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes përbëhet prej tri pjesëve:

1. Hyrja,
2. Përshkrimi,
3. Përfundimi.

## 6.1. Hyrja

Hyrja e procesverbalit paraqet pjesën fillestare ku shënohet emri i organit që ka kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes, emrin e proces mbajtësit në qoftë se ai e mban procesverbalin kohën (muaji, viti, data) dhe vendi i zhvillimit të këqyrjes, përshkrimin e përgjithshëm të vendit dhe objekteve më të rëndësishme në te, kush ka marrë pjesë në këqyrje duke konstatuar emrat e tyre dhe në çfarë roli gjenden ata në vendin e ngjarjes, kushtet e zhvillimit të këqyrjes, ndriçimin, nëse këqyrja është bërë në vendin e hapur, atëherë kushtet meteorologjike në bazë të cilave zhvillohet këqyrja si dhe ngjarjen

---

80 E. Sahiti, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq.178.

penale pa kualifikim juridik, në mënyrë që të mos prejjudikohet esenca e çështjes, e cila deri në atë moment është e panjohur.

Përkundër kësaj në qoftë se vërtetohet me siguri se bëhet fjalë për një veprë të caktuar penale, atëherë mund të jepet edhe kualifikimi juridik. Të dhënat se a ka qenë i siguruar vendi i ngjarjes, si dhe emrin e policit apo ndonjë personi tjetër që ka qenë i ngarkuar për sigurimin e vendit të ngjarjes.

## 6.2. Përshkrimi

Pjesa përshkuese e procesverbalit paraqet pasqyrimin e gjendjes faktike të vërtetuar në vendin e ngjarjes. Kjo mund të trajtohet si pjesë më e rëndësishme e përpilimit të procesverbalit nga se organi hetimor në të përshkruan në tërësi gjendjen e gjetur në vendin e ngjarjes sipas rregullave dhe metodave kriminalistike.

Në këtë pjesë tregohet gjithçka që është zbulua nga këqyrja: karakteristika e përgjithshme e vendit të ngjarjes; gjendja e vendit të ngjarjes; objekti i veprës penale.<sup>81</sup>

Është e rëndësishme që, para përshkrimit të masave dhe veprimeve kriminalistike, të përshkruhet në mënyrë të detajuar dhe fiksohet gjendja objektive e gjetur dhe të përshkruhen ndryshimet e shfaqura prej kryerjes së veprës penale deri në fillimin këqyrjes.

Meqenëse këqyrja bëhet me rastin e veprave të ndryshme penale, atëherë edhe përmbajtja e pjesës përshkuese varet nga vepra penale konkrete, megjithatë përshkrimi duhet të jetë i përpiluar drejt gramatikisht, fjalët duhet të shprehin kuptimin tyre të vërtet, e nëse është nevoja jepet shpjegimi i tyre, por ajo që duhet ti përmbahemi gjithmonë është përshkrimi sistematik i gjendjes së gjetur. Çdo mos respektim i kësaj metodologjie mund të shkaktoj konfuzion, madje edhe pasaktësinë e vet procesverbalit, gjë që to të vështirësonte punën e mëvonshme në ndriçimin e veprës penale konkrete.

Me rastin e përshkrimit të gjurmëve dhe mjeteve, duhet të konstatohet se çka është gjetur e çka nuk është gjetur në vendin e ngjarjes. Gjatë

---

81 V. Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2009, fq.179.



përshkrimit, gjithmonë duhet të merren parasysh sidomos karakteristikat dalluese që i bëjnë ato të dallohen nga mjetet dhe gjurmë të njëjta, që më vonë mos të shfaqet dyshimi në autenticitetin e tyre. Procesverbali i këqyrjes nuk duhet të përmbaj kurrfarë konkluzionesh, mendimesh dhe versionesh, por vetëm konstatime objektive.

Në rastet kur gjatë këqyrjes dëmtohen gjurmët e padukshme, bashkë me përshkrimin e tyre duhet të tregohet se çfarë mjetesh janë përdorur dhe çfarë metodash janë aplikuar, si dhe cili person e ka bërë këtë. Pavarësisht se për çfarë gjurmësh e mjetesh bëhet fjalë, gjatë përshkrimit duhet të përmenden edhe fotografitë dhe skicat, në mënyrë që të krijohet përshtypje sa më e plotë për gjendjen reale.

Në këtë pjesë të procesverbalit duhet të jetë e dukshme se si është arritur deri te dëshmia e vërtet, si dhe mënyrat dhe mjetet me të cilat janë fiksuar ato.

### **6.3. Pjesa përfundimtare**

Në këtë pjesë shënohet edhe koha e fillimit dhe përfundimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, sendet dhe gjurmët e marra në këqyrje, fotografimi i bërë, kino e video – regjistrimi, përgatitja e kallëpeve, marrja e gjurmëve të duarve, e gjurmëve të këmbëve, automjeteve, të veglave të thyerjes më kallëpe, planet e përpiluara si dhe vërejtjet e pjesëmarrësve gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes.

### **Përfundimi**

Në këtë punim u trajtua tema këqyrja e vendit të ngjarjes, me theks të veçantë kuptimi se këqyrja e vendit të ngjarjes është veprim hetimor, me anë të cilit organi procedues percepton drejtpërdrejt mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson gjurmë e prova materiale dhe sqaron rrethanat që kanë rëndësi për çështjen, rëndësia në procedurën parapenale dhe penale, elementet themelore të këqyrjes së vendit të ngjarjes, fazat e këqyrjes së vendit të ngjarjes, përgatitja për këqyrjen e vendit të ngjarjes, masat që duhet ndërmarrë organi procedues kur mbërrin në vendin e ngjarjes dhe procesverbali në vendin e ngjarjes i cili në fazat e mëvonshme të procedurës paraqitet si mjet i të provuarit.

